



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe

**Jurisprudenca e Gjykatës
Evropiane të të Drejtave të
Njeriut gjatë 2018:
Shqipëria, Kroacia,
Bosnja dhe Hercegovina,
Mali i Zi, Maqedonia e
Veriut dhe Serbia**

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave
të Njeriut gjatë 2018: Shqipëria, Kroacia,
Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi,
Maqedonia e Veriut dhe Serbia

Përgatitur nga Qendra AIRE

Ne do të dëshironim të falënderonim Velimir Delovski – këshilltar ligjor për jurisprudencën e GJEDNJ në Gjykatën e Lartë të Maqedonisë së Veriut, Valentina Pavličić – Avokate e Shtetit e Malit të Zi në GJEDNJ, Ralitsa Peykova – Oficere Projekti dhe konsulente ligjore për programin e Shtetit të së Drejtës në Ballkanin Perëndimor Qendra AIRE, Nataša Plavšić - Avokate e Republikës së Serbisë në GJEDNJ, Elma Veledar Arifagić – Avokate, si edhe Ina Xhepa – Drejtore e Qendrës Europiane, për kontributin e tyre.

PËRMBAJTJA

2018 në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut – përmbledhja vjetore	5
REPUBLIKA E SHQIPËRISË	11
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	18
REPUBLIKA E KROACISË	24
MALI I ZI	36
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT	43
REPUBLIKA E SERBISË.....	53

2018 në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut – përmbledhja vjetore

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata ose GJEDNJ) ka vazhduar punën në mbrojtje të të drejtave të njeriut në Evropë gjatë vitit 2018. Ky publikim paraqet një shqyrtim të jurisprudencës së GJEDNJ-së në vitin 2018, duke parë së pari tendencat e përgjithshme të çështjeve kundër vendeve në rajon të dhëna gjatë vitit 2018.

Numri i aplikimeve në pritje para GJEDNJ-së ka mbetur mjaft i qëndrueshëm në rreth 56,000. Është interesante që pothuajse 72% e çështjeve në pritje kanë të bëjnë me gjashtë vende: numri më i madh i çështjeve është paraqitur kundër Rusisë, pasuar nga Rumania, Ukraina, Turqia, Italia dhe Azerbajxhani. Analiza e kërkesave në pritje nga këto vende të ndryshme tregon se është situata sistemike në disa shtete që me të vërtetë rrit ngarkesën e punës së Gjykatës, duke shkaktuar një vëllim të madh aplikimesh.

Si është siguruar GJEDNJ-ja që çështjet në pritje përpara saj të trajtohen me efikasitet në vitin 2018?

Çështjet në GJEDNJ vendosen nga katër lloje të ndryshme formacionesh:¹

Vendimet e një gjyqtari të vetëm:

Gjyqtari i vetëm përcakton pranueshmërinë e çështjeve individuale që përfshijnë raste qartë të papranueshme. Ky sistem u krijua për të ndihmuar në uljen e numrit të çështjeve.

Komitetet:

Përbëhen nga tre gjyqtarë dhe vendosin për pranueshmërinë dhe themelin kur çështja përfshihet në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës (vendimi duhet të jetë unanimit).

Dhomat:

Përbëhen nga shtatë gjyqtarë dhe vendosin së pari mbi pranueshmërinë dhe themelin e çështjeve, që ngrenë problematika për të cilat nuk është vendosur shpesh (vendimi merret nga shumica). Çdo dhomë ka Presidentin e saj dhe “gjyqtarin kombëtar” (gjyqtari me shtetësinë e shtetit kundër të cilit është paraqitur kërkesa).

Dhoma e Madhe:

Përbëhet nga 17 gjyqtarë. Dhoma e Madhe dëgjon një numër të vogël dhe të përzgjedhur, të cilat janë referuar, ose për të cilat Dhoma ka hequr dorë nga shqyrtimi, zakonisht kur çështja përfshin një pyetje të rëndësishme ose të re. Në formacionin e Dhomës së Madhe përfshihen gjithmonë Presidenti dhe Zëvendës Presidenti i Gjykatës, Presidentët e pesë Dhomave dhe gjyqtari kombëtar.

¹ Neni 26 (1) i KEDNJ “Gjykata shqyrton çështjet e sjella para saj në një trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, në komitete me tre gjyqtarë, në Dhoma me shtatë gjyqtarë dhe në Dhomën e Madhe me shtatëmbëdhjetë gjyqtarë. Dhomat e Gjykatës formojnë komitete për një periudhë të caktuar kohe.”

Sfida më e madhe me të cilën ballafaqohet Gjykata është padyshim numri i 26,000 çështjeve në pritje përpara Dhomave, të cilat nuk mund të trajtohen nga një Komitet për shkak të kompleksitetit të tyre, ose për faktin se ato ngrenë çështje të reja ligjore.

Me qëllim që të sigurojë trajtimin e të gjitha kërkesave në pritje me efikasitet, GJEDNJ ka miratuar një politikë prioritare në vitin 2009, për të përshpejtuar procesimin dhe gjykimin e rasteve më të rëndësishme, serioze dhe urgjente. Kjo politikë krijoi shtatë kategori, duke filluar nga çështjet urgjente në lidhje me kërkesat vulnerabël (Kategoria I), në çështjet e papranueshme të trajtuara nga një gjyqtar i vetëm (Kategoria VII).² 20,600 nga 26,000 çështje kanë status prioritar. Shumica dërmuese e këtyre të ashtuquajturave raste prioritare janë në fakt të **përsëritura**, pasi ato kanë të bëjnë me individë që ankohen për mbipopullimin e burgjeve. Megjithatë, meqë ato ngrenë çështje në kuadër të nenit 3 të Konventës (ndalimi i torturës, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose poshtëruës), ato marrin përparësi.³

Trendi i vendimeve të dhëna

Në fillim të vitit 2017, përpara GJEDNJ ishin 80,000 aplikime në pritje, të cilat u reduktuan ndjeshëm në rreth 56,000 deri në fillim të vitit 2018. Megjithatë, gjatë dymbëdhjetë muajve të ardhshëm, numri i kërkesave në pritje mbeti relativisht i qëndrueshëm, duke qenë në fund të vitit vetëm njëqind më pak se në fillim.

Në praktikë, shumica e kërkesave para Gjykatës u zgjidhën me vendim mbi pranueshmërinë. Një kërkesë u refuzua nga Dhoma e Madhe. Përafërsisht 200 aplikime u shpallën të papranueshme ose u nxorën nga lista e çështjeve për gjykim nga Dhomat dhe rreth 6,650 nga Komitetet. Për më tepër, rreth 33,200 kërkesa u shpallën të papranueshme ose u nxorën nga lista nga gjyqtarët e vetëm (krahasuar me 66,150 në vitin 2017). Numri i çështjeve të shqyrtuara me vendim ra me 82% nga viti 2017 në vitin 2018, konkretisht me 2,738 vendime të dhëna në vitin e fundit. Numri i vendimeve mbi pranueshmërinë gjithashtu ra në mënyrë të ndjeshme me 43%, nga afërsisht 70,000 në 2017 në 40,000 në vitin 2018. Ky trend është në kontrast me atë të vitit 2017, i cili pati një trend të konsiderueshëm në rritje të numrit të çështjeve të gjykuara, krahasuar me 2016.

Në 2018, Gjykata dha 1,014 vendime⁴, krahasuar me 1,068 të tillë dhënë në 2017. Dhoma e Madhe ka dhënë 14 vendime dhe një vendim mbi pranueshmërinë gjatë vitit 2018. Ndërkohë, në fund të vitit, 21 çështje mbetën ende të pazgjidhura përpara saj. Dhomat dhanë 463 vendime në vitin 2018, në lidhje me 712 kërkesa. Ndërkohë, Komitetet dhanë 537 vendime, në lidhje me 2,000 kërkesa. Në fund të vitit përpara Gjykatës kishte 51,600 kërkesa në pritje për t'u gjykuar nga një Dhomë ose Komitet.

Gjyqtarët e vetëm deklaruan 33,200 kërkesa të papranueshme ose i nxorën ato nga lista, me 4,750 kërkesa në pritje.

Nevoja për të ulur numrin e çështjeve të pazgjidhura në pritje përpara Gjykatës, frymëzoi procesin e reformës, i cili filloi me hartimin dhe miratimin e Protokollit 14 dhe vazhdon deri më sot. Prioriteti i

2 Lexoni më shumë për Politikën e Përparësisë së GJEDNJ në këtë website: https://www.echr.coe.int/Documents/Priority_policy_ENG.pdf

3 Kategoria III parashikon se kërkesat që në pamje të parë paraqesin ankime që lidhen me nenet 2, 3, 4 ose 5 § 1 të Konventës ("të drejtat themelore"), pavarësisht nëse ato janë të përsëritura, apo kanë shkaktuar kërcënime direkte ndaj integritetit fizik dhe dinjitetit të qenieve njerëzore, duhet të konsiderohen si çështje prioritare.

4 Sikurse u përmend më lart këto vendime u takonin 2,738 kërkesave individuale, një pjesë e të cilave u shqyrtuan të bashkuara.

procesit të reformës ka qenë të gjejë mënyra për të përmirësuar metodat e punës së Gjykatës me qëllim rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit të saj. Në të vërtetë, rënia e numrit të kërkesave në pritje gjatë vitit 2017 ndoshta nuk duhet të merret si provë e ndonjë progresi të madh drejt qëllimeve të reformës së Gjykatës, por i detyrohet refuzimit sistematik të çështjeve në shkallë të gjerë, në lidhje me disa vende, për shkak të pamundësisë për t'iu përmbajtur kriterëve të pranueshmërisë, p.sh. dështimi i kërkuësve për të shteruar mjetet juridike të brendshme.

Protokolli nr. 14, i cili hyri në fuqi në vitin 2010 pas Konferencës së Interlakenit, paraqiti formacione të reja gjyqësore për çështjet më të thjeshta, krijoi një kriter të ri të pranueshmërisë (ekzistenca e një “disavantazhi të rëndësishëm” për kërkuësin) dhe zgjati mandatin e gjyqtarëve në 9 vjet pa të drejtë rikandidimi. Kjo përpjekje për të zvogëluar numrin e çështjeve në pritje është ndjekur nga disa konferenca të mëtejshme të fokusuara në reforma, më e fundit është ajo e Kopenhagenit në 2018. Kjo konferencë prodhoi Deklaratën e Kopenhagenit, e cila ka njohur suksese të mëparshme të reformës, por përmban një marrëveshje sipas së cilës deri në fund të vitit 2019 Komiteti i Ministrave duhet të vendosë nëse janë të nevojshme ndryshime të tjera më të thella në mekanizmat e Konventës, duke nënkuptuar se procesi i reformës nuk është aspak i tejkaluar.

Procedura

Një zhvillim i rëndësishëm në procedurën e Gjykatës ka ndodhur me hyrjen në fuqi të Protokollit nr. 16 të Konventës, më 1 gusht 2018. Protokollin nr. 16 lejon gjykatat dhe tribunatet më të larta të një Shteti Palë të bëjnë kërkesë në Gjykatë për të dhënë mendime këshillimore mbi çështjet parimi në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës. Protokollin ka hyrë në fuqi vetëm në lidhje me dhjetë vende, të cilat e kanë ratifikuar atë.⁵

Pavarësisht se u prezantua në vitin 2010, përdorimi i parë i procedurës së shkeljes sipas nenit 46 § 4 të Konventës nuk ka ndodhur deri në fund të 2017. Ky parashikim i lejon Komitetit të Ministrave, i cili ka përgjegjësinë sipas Konventës të mbikqyrë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës, për t'i referuar një pyetje GJEDNJ-së nëse një Shtet Palë ka refuzuar qëllimisht t'i përmbahet një vendimi përfundimtar të dhënë nga vetë Gjykata. Komiteti i Ministrave vendosi më 5 dhjetor 2017 të nisë këtë proces kundër Azerbajxhanit për shkak të refuzimit të vazhdueshëm të autoriteteve për të siguruar lirimin e pakushtëzuar të një politikani opozitar, pas vendimit të GJEDNJ-së për vitin 2014 se kishte pasur shkelje të Konventës, specifikisht të neneve 5 dhe 18 marrë së bashku.⁶ Çështja është ende në pritje përpara Dhomës së Madhe, e cila do të shqyrtojë rastin.

Gjykata ka parë zgjerimin e Rrjetit të Gjykatave të Larta (SCN) si një mjet të rëndësishëm në sjelljen e gjykatave të brendshme më pranë Strasburgut dhe diseminimin e jurisprudencës së saj. Rrjeti siguron një kornizë komunikimi midis gjykatave të brendshme dhe GJEDNJ, si dhe ndërmjet vetë gjykatave vendase. Tani ka shtatëdhjetë e një gjykata anëtare nga tridhjetë e pesë vende, duke përfshirë më shumë se njëzet Gjykata Kushtetuese dhe të njëjtin numër Gjykatash të Larta.

5 Shqipëria, Armenia, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Lituania, San Marino, Sllovenia, dhe Ukraina.

6 *Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit*, vendim i 22 majit 2014.

Jurisprudenca

Neni 6 (e drejta për një proces të rregullt) mbeti dispozita më e cenuar e Konventës për të cilën u gjetën në vitin 2018, 24% e të gjitha shkeljeve që bien nën këtë titull. I dyti pas nenit 6 ishte neni 3 (ndalimi i torturës) me afërsisht 18% të të gjitha shkeljeve. Kategoria e tretë substanciale ishte neni 5 (e drejta për liri dhe siguri) që përbënte afërsisht 16% të të gjitha shkeljeve të evidentuara.

Në 2018 u dhanë 248 vendime kundër Rusisë, numër ky më i larti krahasuar me të gjithë vendet e tjera. Nga këto, 238 vendime përfshinë të paktën një shkelje. Rusia u pasua nga Turqia e cila ishte shteti i paditur në 146 vendime, nga të cilat 140 përfshinë të paktën një shkelje. Këto shifra përafërsisht ndjekin të njëjtën prirje të Turqisë, që është shteti i përfshirë në numrin më të madh të vendimeve që nga viti 1959, ku nga 3,532 u gjet shkelje në 3,128, ndjekur nga Rusia në vendin e dytë me 2,501 vendime prej të cilave në 2,365 u gjet të paktën një shkelje.

Në vitin 2018 u dha një numër i konsiderueshëm vendimesh me influencë që ndikojnë si thelbin e jurisprudencës së Konventës, ashtu edhe procedurën e GJEDNJ. Më poshtë, kemi shtjelluar më tej një përmbledhje të tyre. Raporti Vjetor i Gjykatës për vitin 2018, i cili është burimi kryesor i statistikave në këtë seksion, përmban një përmbledhje të çështjeve kryesore nga 2018, të identifikuara nga departamenti i Jurisconsult.⁷ Më poshtë, ne kemi përzgjedhur për të shtjelluar disa prej tyre si ilustrim i fushave të gjera të jurisprudencës, të cilat Gjykata Evropiane ka gjykuar kohët e fundit.

Përzgjedhje e çështjeve

*Hadzhieva k. Bullgarisë*⁸: në këtë çështje kërkuesja ishte 14 vjeç në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet, kur më 4 dhjetor 2002 policia arrestoi prindërit e saj dhe i mori në paraburgim. Kërkuesja mbeti vetëm në banesë derisa ajo u ribashkua me prindërit e saj më 17 dhjetor. Ajo argumentoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) pasi kishte mbetur vetëm në moshën 14 vjeç për një periudhë prej 13 ditësh, pasi të dy prindërit e saj ishin paraburgosur. Çështja thelbësore në këtë rast ishte të përcaktohej nëse shteti i paditur kishte përmbushur detyrimet e tij pozitive sipas këtij neni për të siguruar mbrojtjen e të drejtës së kërkueses për respektimin e integritetit të saj psikologjik. Gjykata u dakordësua me kërkuesen, por vetëm për periudhën e parë dy ditore ndërmjet arrestimit të prindërve të saj dhe seancës gjyqësore për vlerësimin e masës së sigurisë, e cila u zhvillua më 6 dhjetor 2002, gjatë së cilës nëna kishte njoftuar policinë se kishte dikë për t'u kujdesur për vajzën. Për sa i përket periudhës dy ditore, Gjykata u shpreh se autoritetet nuk kishin respektuar detyrimin e tyre pozitiv sipas nenit 8 për të vepruar, në mënyrë që të sigurohej mbrojtja dhe garantimi i kërkueses, e cila ishte e mitur.

*Lozovyye k. Rusisë*⁹: kërkuesit u ankuan se autoritetet vendase kishin shkelur detyrimet e tyre sipas nenit 8 të Konventës, kur nuk ishin njoftuar se djali i tyre ishte vrarë. Ky rast ishte hera e parë që Gjykata e konsideronte nenin 8 në lidhje me detyrën e shtetit për të informuar të afërmit e viktimës për vdekjen e një anëtari të ngushtë të familjes. Gjykata vendosi që detyrimi pozitiv i shtetit sipas nenit 8 në këto situata ishte "të paktën të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar që anëtarët e familjes të

7 Raporti Vjetor 2018 – Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Kapitulli 2 (version provizor). Për listën e çështjeve kryesore nga 2018, shih f. 159.

8 *Hadzhieva k. Bullgarisë*, vendim i 1 shkurtit 2018.

9 *Lozovyye k. Rusisë*, vendim i 24 prillit 2018.

informohen.” Gjykata e kufizoi veten në një gjykim mbi rrethanat e rastit, duke nënvizuar se detyrimi në këtë fushë do të ndryshojë në varësi të fakteve. Për sa kohë autoritetet e dinin identitetin e birit të kërkuësve, kishte mënyra të shumta për të gjetur identitetin e të afërmeve të tij.

*Baydar k. Holandës*¹⁰: kërkuësi u dënua për një numër krimesh përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore. Pas parashtrimit të ankesës në Gjykatën e Lartë, ai kërkoi që Gjykata të merrte një vendim të ndërmjetëm nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropianë (GJDBE). Gjykata e Lartë e hodhi poshtë këtë kërkesë pa arsytim, aspekt procedural që lejohet nga legjislacioni i brendshëm. Kërkuësi u ankua në Gjykatë se ky vendim i paarsyetuar shkeli nenin 6 § 1 të Konventës. Ky është rasti i parë ku Gjykata ka adresuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien mes pranimit nga GJEDNJ të faktit se një gjykatë e lartë vendase mund të hedhë poshtë një ankim mbi bazën e një arsytimi të përmbledhur dhe kërkesën që gjykatat vendase të japin arsytimin përkatës për refuzimin e referimit të një pyetjeje në GJDBE.

*Beuze k. Belgjikës*¹¹: kjo çështje ka të bëjë me kufizimet ligjore në lidhje me të drejtën e një të dyshuari për të pasur një avokat, sipas nenit 6. Kërkuësi nuk kishte pasur mundësinë të këshillohej me një avokat deri në momentin që i ishte komunikuar zyrtarisht akuza dhe pas këtij momenti avokati i tij nuk ishte lejuar të merrte pjesë në seancat e tjera të marrjes në pyetje, në kuadër të hetimit. Gjykata ishte në gjendje që të nënvizonte edhe një herë thelbin e së drejtës për të pasur një avokat dhe asistencë ligjore, si edhe të qartësojë testet që vërtetojnë nëse shteti ka vepruar në përputhje me nenin 6, si dhe çfarë duhet të konsiderohet si një deklaratë ‘vetë-inkriminuese’. Ndërsa Gjykata vuri në dukje se pajtueshmëria me nenin 6 gjykohet duke e shqyrtuar procesin në tërësi. Fakti i mosnjohimit të një të dyshuari për të drejtat e tij dhe duke mos ia mundësuar atij këto të drejta, merr një rëndësi të veçantë në gjykimin e procesit në tërësi.

*Vizgirda k. Sllovenisë*¹²: kjo çështje sqaroi të drejtat e garantuara në nenin 6 § 3 (a) dhe (e), në veçanti në lidhje me detyrën e shtetit për të verifikuar nevojat gjuhësore të të pandehurve të huaj dhe për t’i mundësuar atyre pasjen e një përkthyesi. Kërkuësi në këtë rast ishte një shtetas lituanëz. Ai u arrestua me dyshimin se kishte plaçkitur një bankë në Slloveni pak pasi kishte mbërritur në vend. Pas arrestimit të tij, atij iu sigurova një përkthyes i gjuhës ruse, e cila nuk ishte gjuha e tij amtare. Ndërkohë që shërbimet e përkthimit vazhduan gjatë fazës së hetimit dhe gjykimin, si dhe apelit të tij kundër dënimit, vetëm në kohën kur kërkuësi apeloj vendimin, duke u shprehur se gjatë gjithë kohës kishte hasur vështirësi për shkak të ndjekjes së procesit në gjuhën ruse. Në thelb kërkuësi u ankua se nuk kishte qenë në gjendje të mbrohej në mënyrë efektive gjatë procesit penal sepse seancat dëgjimore dhe aktet nuk ishin përkthyer në gjuhën lituanëze. Gjykata vendosi në favor të kërkuësit dhe gjeti një shkelje të nenit 6 § 1 dhe 3 të Konventës.

*Molla Sali k. Greqisë*¹³: kjo çështje kishte të bënte me ndërlidhjen e nenit 14 (ndalimin e diskriminimit) dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës), në lidhje me faktin se kërkuësja kishte humbur tre të katërtat e trashëgimisë së saj përfituar pas humbjes së jetës së bashkëshortit të saj, pasi një gjykatë greke kishte vendosur mbi këtë trashëgimi në bazë të Traktatit të Athinës në vitin 1913, i cili regullonte çështjet e trashëgimisë midis komunitetit mysliman grek, duke përcaktuar se këto çështje

10 *Baydar k. Holandës*, vendim i 24 prillit 2018.

11 *Beuze k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 9 nëntorit 2018.

12 *Vizgirda k. Sllovenisë*, vendim i 28 gushtit 2018.

13 *Molla Sali k. Greqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2018.

zgjidheshin sipas ligjit të Sheriatit dhe se shprehja e vullnetit përmes akteve noteriale të noterizuara për shtetasit grekë të besimit mysliman ishte e paefektshme. Ky ishte rasti i parë i dëgjuar para Gjykatës, që përfshinte në objekt zbatimin e ligjit të Sheriatit nga një gjykatë vendase kundër vullnetit të kërkuesit. Gjithashtu, ky ishte vendimi i parë i Dhomës së Madhe që ngrinte çështje të diskriminimit nga një shoqatë, duke qenë se fokusi i rastit ishte trajtimi ndryshe i kërkueses për shkak të besimit mysliman të trashëgimlënësit (burrit të saj të vdekur). Dhoma e Madhe konfirmoi se në nenin 14 të Konventës përfshihen rastet kur një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme në bazë të statusit të një personi tjetër, ose karakteristikave të mbrojtura. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë justifikim të arsyeshëm për trajtimin ndryshe të pakicave dhe gjeti një shkelje të Konventës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Hyrje

Ky dokument përmbledh vendimet e marra nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në lidhje me Republikën e Shqipërisë, që nga koha e ratifikimit të Konventës Evropiane më 2 tetor 1996.

Deri më 31 dhjetor 2018, Gjykata ka vendosur kundër Shqipërisë për 79 çështje – ndër të cilat 59 janë dhënë nga Dhoma me 7 gjyqtarë dhe 20 vendime nga një Komitet prej 3 gjyqtarësh. Gjithashtu, Gjykata ka dhënë 71 vendime mbi pranueshmërinë/nxjerrje jashtë nga lista e gjykimit, ndër të cilat 33 janë vendosur nga Dhoma dhe 38 nga një Komitet. Gjatë 2018 u dhanë 8 vendime nga Dhoma, 1 vendim nga Komiteti, si edhe një vendim mbi pranueshmërinë, të cilat do t'i sqarojmë në mënyrë të detajuar më poshtë. Gjithashtu, Komiteti i Ministrave, i cili monitoron ekzekutimin e vendimeve që jep Gjykata, miratoi një rezolutë në llogari të Shqipërisë, në lidhje me grupin e çështjeve *Manushaqe Puto*, duke mbyllur kështu ekzaminimin e ekzekutimit, pasi sipas Komitetit, Shqipëria kishte bërë progres në lidhje me miratimin dhe zbatimin e mekanizmave vendas të kompensimit të pronës.¹⁴

Nuk u dha asnjë vendim themeli dhe pranueshmërie në lidhjen e Shqipërinë.

Më poshtë gjendet një përmbledhje e shkurtër e llojeve të çështjeve në të cilat është përfshirë Shqipëria.

Në lidhje me nenin 2 të Konventës, e drejta e jetës, janë dy vendime kryesore: *Ceka*; çështja u çregjistrua, pasi Gjykata vendosi se kërkuesi kishte marrë zgjidhjen e plotë sipas së drejtës së brendshme, duke qenë se Shteti kishte pranuar qartazi shkeljen dhe kishte ofruar dëmshpërblimin e përshtatshëm.¹⁵ *Rrapo*¹⁶ kishte të bënte me ekstradimin e kërkuesit, ku nuk u konstatua shkelje, pasi në notën diplomatike dhënë nga SHBA-të jepeshin garanci të mjaftueshme se nuk do të kishte cenim të së drejtës së jetës pas ekstradimit.

Shtatë vendime janë dhënë në lidhje me nenin 3, ndalimi i torturës. Në pesë prej tyre është gjetur shkelje e këtij neni. Çështjet kishin të bënin me kushtet e ndalimit¹⁷, mungesa e trajtimit të duhur mjekësor në burg¹⁸, dhunimi i një kërkuesi, që gjendet në kontrollin e policisë¹⁹, dështimi i autoriteteve publike në përmbushjen e detyrimeve të tyre pozitive në kuadër të Konventës në lidhje me ankimet e një kërkueseje për kanosje²⁰, si edhe moszhvillimi nga ana e autoriteteve i një hetimi efektiv për një rast keqtrajtimi²¹. Në këto vendime, Gjykata vërejti se: papajtueshmëria e kushteve të ndalimit me gjendjen shëndetësore të individit, duke vendosur një të burgosur me probleme të shëndetit mendor në të njëjtin ambient me të burgosur të shëndetshëm, si edhe mungesa e një trajtimi mjekësor të për-

14 Rezoluta e Komitetit të Ministrave CM/ResDH(2018)349.

15 *Ceka k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012.

16 *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012.

17 *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009.

18 *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009; *Dybeku k. Shqipërisë*, vendim i 18 dhjetorit 2007.

19 *Kaciu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012.

20 *Pulfer k. Albania*, vendim i 20 nëntorit 2018.

21 *Pihoni k. Albania*, vendim i 13 shkurtit 2018.

shtatshëm²², si dhe ashpërsia e dhunës subjekt i së cilës kishte qenë kërkuesi, nuk ishin të tilla që të derivonin torturë, në kuptim të nenit 3.²³

Tre vendime janë dhënë në lidhje me nenin 5, e drejta për liri dhe siguri, ku në dy prej tyre është gjetur shkelje. Në vendimin *Delijorgji*²⁴, Gjykata Evropiane gjeti shkelje të neneve 5 § 1 dhe 5 § 4, për shkak të kohëzgjatjes së paraburgimit “në pritje të vendimit”, periudhës së gjatë që u desh autoriteteve për të shqyrtuar një kërkesë për lirim, si edhe mungesës së arsytimit që iu dha kërkuesit kur u vendos ndaj tij masa e sigurisë arrest shtëpie.

Në total janë dhënë 62 vendime në lidhje me nenin 6, nga të cilat u konstatua shkelje në 57 prej tyre. Pjesa më e madhe e çështjeve kanë pasur në objekt ankim për proces të parregullt dhe mungesën të aksesit në gjykatë. Për shembull, në çështjen *Caka*²⁵, dështimi i autoriteteve për të siguruar dëshmitarë në gjyqin kundër kërkuesit, si edhe mosmarrja parasysh nga Gjykata e Shkallës së Parë e dëshmisë së katër dëshmitarëve në favor të kërkuesit solli shkelje e nenit 6 § 1 i marrë së bashku me nenin 6 § 3(d). Në çështjen *Laska dhe Lika*²⁶, dështimi i autoriteteve për të korrigjuar parregullsitë procedurale në fazën e hetimit në lidhje me identifikimin e të dyshuarve, pas solli shkelje të nenit 6 § 1. Në vendimin *Cani*²⁷ - refuzimi për t’i dhënë kërkuesit të drejtën të mbronte veten e tij në një seancë publike para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, shkeli nenit 6 § 1. Në çështjen *Dauti*²⁸, Gjykata vërejti se pamundësia e kërkuesit për të apeluar vendimin administrativ të Komisionit të Apelit, në lidhje me një përfitim financiar ishte shkelje e së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës. Për më tepër, Gjykata vlerësoi se Komisioni i Apelit nuk mund të konsiderohej si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, siç kërkohet nga neni 6 § 1 i Konventës, ndërkohë që vendimet e tij, sipas ligjit në fuqi në atë kohë, nuk mund të kundërshtoheshin para një gjykate vendase. Në rastin *Qufaj*²⁹, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të së drejtës së kompanisë kërkuese për një gjykim të drejtë, për shkak të moszbatimit të një vendimi përfundimtar gjyqësor (shkelje e nenit 6§1). Çështja *Luli*³⁰ kishte të bënte me zgjatjen e tepruar të proceseve civile para organeve të ndryshme prej vitit 1996 deri në kohën që u gjykua çështja. Gjykata Evropiane kritikoi në veçanti dështimin e sistemit gjyqësor për të menaxhuar siç duhej një sërë procesesh, që lidheshin me të njëjtën problematikë.

Një çështje tjetër tepër e rëndësishme është *Bici*³¹, i cili ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave para Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Durrësit lidhur me njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin e pronës. Gjykata Evropiane gjeti shkelje të nenit 6 § 1 për arsye se këto procedura kishin zgjatur për 11 vjet, 9 muaj dhe 18 ditë para një niveli të vetëm juridiksioni.

22 *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009.

23 *Kaciu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012.

24 *Delijorgji k. Shqipërisë*, vendim i 28 prillit 2015.

25 *Balliu k. Shqipërisë*, vendim i 16 qershorit 2005; *Caka k. Shqipërisë*, vendim i 8 dhjetorit 2009.

26 *Laska dhe Lika k. Shqipërisë*, vendim i 20 prillit 2010.

27 *Cani k. Shqipërisë*, vendim i 6 marsit 2011.

28 *Dauti k. Shqipërisë*, vendim i 3 shkurtit 2009; *Driza k. Shqipërisë*, vendim i 13 nëntorit 2007.

29 *Qufaj k. Shqipërisë*, vendim i 18 nëntorit 2004

30 *Luli dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 1 prillit 2014

31 *Bici k. Shqipërisë*, vendim i 3 dhjetorit 2015.

Në një grup çështjesh, Gjykata ngriti shqetësimin e problemit sistemik për dështimin e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare gjyqësore dhe administrative. Gjykata Evropiane dha në llogari të Shqipërisë një vendim pilot, *Manushaqe Puto dhe të Tjerët*³². Gjykata konstatoi se kuadri i brendshëm ligjor nuk ofronte zgjidhje efektive për të bërë të mundur dëmshpërblimin e përshtatshëm dhe të mjaftueshëm në lidhje me moszbatimin e vendimeve të komisionit, që njihnin të drejtën e kërkuarve për kompensim. Sipas nenit 46, Shqipëria duhej të ndërmerre me urgjencë masa të përgjithshme, me qëllim që të sigurohej në mënyrë efektive e drejta e kompensimit.

Në lidhje me nenin 7 është dhënë vetëm një vendim. Në çështjen *Alimuçaj*, Gjykata konstatoi shkelje të parimit të ligjshmërisë së veprave penale dhe dënimeve, pasi kërkuarët i ishte dhënë një dënim më i rëndë sesa ai që parashikohej në kohën e kryerjes së veprës penale³³.

Ka pasur tri raste lidhur me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare sipas nenit 8³⁴. Në çështjen *Bajrami*³⁵ që kishte të bënte me dështimit të autoriteteve shqiptare për të ndërmarrë masat e nevojshme për ribashkimin me vajzën e tij e cila ishte dërguar në Greqi pa pëlqimin e kërkuarit, u konstatua shkelje e nenit 8. Në një çështje tjetër, e cila përsëri kishte të bënte me detyrimet pozitive të shtetit për të facilituar bashkimin mes fëmijës dhe prindërve.³⁶ Në *Sharxhi dhe të Tjerët*³⁷, autoritetet shqiptare nuk respektuan të drejtën e kërkuarve për të gëzuar në mënyrë të qetë banesën e tyre sa i takon konfiskimit dhe rrethimit të banesave me shirit.

24 vendime janë dhënë në lidhje me nenin 13, të gjitha në lidhje me nenin 6, nenin 8 dhe/ose të nenit 1 të Protokollit nr.1. Një vendim është dhënë në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 7, e drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë. Gjykata nuk konstatoi shkelje për shkak të përsëritjes së proceseve penale, që kanë përfunduar me një vendim të formës së prerë, i cili ka marrë fuqi si i tillë.³⁸

Janë dhënë 23 vendime në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Disa prej tyre kanë përfshirë probleme të mosekzekutimit të vendimeve të brendshme, si dhe një shpërblim i përfituar me vendim gjykatë mund të konsiderohet pronë për qëllime të Konventës (shih p.sh., *Manushaqe Puto dhe të Tjerët* përmendur më lart tek neni 6). Në çështjen *Sharxhi dhe të Tjerët*³⁹, u gjet shkelje sa i takon shpronësimit, mohimit të aksesit dhe shkatërrimit të banesave të kërkuarve nga ana e autoriteteve publike.

32 *Manushaqe Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 31 korrikut 2012

33 *Alimuçaj k. Shqipërisë*, vendim i 7 shkurtit 2012.

34 *Qama k. Shqipërisë dhe Italisë*, vendim i 8 janarit 2013; *Bajrami k. Shqipërisë*, vendim i 12 dhjetorit 2006.

35 *Bajrami k. Shqipërisë*, vendim i 12 dhjetorit 2006.

36 *Qama k. Shqipërisë dhe Italisë*, vendim i 8 janarit 2013.

37 *Sharxhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 11 janarit 2018.

38 *Xheraj k. Shqipërisë*, vendim i 29 korrikut 2008.

39 *Sharxhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 11 janarit 2018.

Vendime 2018

Nga 9 vendime në total të dhëna gjatë vitit 2018, 8 prej tyre⁴⁰ u gjykuan nga një Dhomë prej 7 gjyqtarësh dhe një⁴¹ nga një Komitet prej 3 gjyqtarësh. Në një çështje Gjykata gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës si edhe shkelje të nenit 8⁴². Shkelje e nenit 3 u vendos në dy çështje⁴³, ndërkohë 5 çështje përfshinë një shkelje të nenit 6⁴⁴, një prej të cilave në lidhje me nenin 13 të Konventës⁴⁵.

Sharxhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë, vendim i 11 janarit 2018, shkelje e nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) dhe neni 6 (1) (e drejta për një proces të rregullt ligjor) dhe nenit 8 (e drejta për një jetë të qetë private dhe familjare) dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës (mbrojtja e pronës).

Çështja *Sharxhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, e ka origjinën në një kërkesë të bazuar në ankesat e kërkuësve për prishjen e paligjshme të banesave dhe bizneseve të tyre në një qytet bregdetar shqiptar. Në veçanti, kërkuësit u ankuan për rrethimin, shpronësimin dhe shkatërrimin e pronave të tyre brenda një muaji në vitin 2013, pavarësisht nga ekzistenca e një mase sigurimi padie dhënë nga gjykatat vendase për llogari të autoriteteve, me qëllim që të mos ndërmerreshin veprime që mund të shkelin të drejtat e tyre pronësore.

Gjykata përsëriti se në përputhje me nenin 13 të Konventës, Shtetet Palë duhet të ofrojnë një mjet efektiv ligjor në nivel të brendshëm për të adresuar themelin e një ankese sipas Konventës. Megjithatë, Gjykata solli në vëmendje se autoritetet kombëtare gëzojnë një hapësirë vlerësimi. Për më tepër, Gjykata theksoi se në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, autoritetet shtetërore të çdo shteti palë në Konventë kanë për detyrë të sigurojnë ekzekutimin e mjeteve juridike kur ato janë dhënë nga gjykatat vendase. Kështu, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës dhe hodhi poshtë kundërshtimin paraprak të qeverisë për mosshkrim të mjeteve juridike vendase nga ana e kërkuësve. Për më tepër, Gjykata theksoi se vendimi i ndërmjetëm ishte dhënë pikërisht për të parandaluar shkatërrimin e ndërtesës dhe për të mbrojtur kërkuësit nga veprimet e mëtejshme të autoriteteve shtetërore. Dështimi i autoriteteve vendase për ta ekzekutuar këtë masë në praktikë i privonte kërkuësit nga e drejta e aksesit në një gjykatë vendase, në kundërshtim me garancinë e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

Gjykata vërejtë se ndalimi i kërkuësve për të hyrë në shtëpitë e tyre përbënte një shkelje të nenit 8 të Konventës.

Duke marrë parasysh rrëzimin banesave me shirit të verdhë dhe shkatërrimi i tyre ka shkaktuar një ndërhyrje të pajustificuar në gëzimin paqësor të pronës dhe një shpronësim *de facto* të kërkuësve. Për rrjedhojë, Gjykata gjeti një shkelje të së drejtës së kërkuësve sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1.

40 *Sharxhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë* 11 janar 2018, *Pihoni k. Shqipërisë*, vendim i 13 shkurtit 2018, *Hysi k. Shqipërisë*, *Malo k. Shqipërisë*, *Muca k. Shqipërisë* dhe *Topi k. Shqipërisë*, vendime të 22 majit 2018, *Frroku k. Shqipërisë*, vendim i 18 shtatorit 2018 dhe *Pulfer k. Shqipërisë*, vendim i 20 nëntorit 2018.

41 *Karemani k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2018.

42 *Sharxhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 11 janarit 2018.

43 *Pihoni k. Shqipërisë*, vendim i 13 shkurtit 2018, *Pulfer k. Shqipërisë*, vendim i 20 nëntorit 2018.

44 *Sharxhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 11 janarit 2018, *Hysi k. Shqipërisë*, *Malo k. Shqipërisë*, *Muca k. Shqipërisë* dhe *Topi k. Shqipërisë*, vendime të 22 majit 2018

45 *Sharxhi dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 11 janarit 2018.

Pihoni k. Shqipërisë, vendim i 13 shkurtit 2018 shkelje e nenit 3 të Konventës (ndalimi i torturës)

Çështja kishte të bënte me pretendimin e kërkuesit se ai kishte pësuar një dëmtim në kokë kur policia kishte ndërhyrë në një grindje të ndodhur në publik. Z. Pihoni pohoi se policia kishte përdorur forcë të tepërt kundër tij dhe se autoritetet kishin dështuar të zhvillonin një hetim efektiv për incidentin. Për më tepër, ai pretendoi se gjatë ngjarjes nuk ishte përdorur armë nga ai vetë ose nga njerëzit e tjerë të përfshirë në incident.

Gjykata nënvizoi se vendimi i prokurorit deklaroi se kishin lindur dyshime nëse ishte konsumuar vepra penale e shpërdorimit të detyrës, me arsyetimin se dëmtimet e paraqitura nga kërkuesi mund të ishin shkaktuar gjatë kohës që ai shoqërohej në stacionin policor. Megjithatë, Gjykata solli në vëmendje se, në pretendimet e tij me shkrim, kërkuesi nuk paraqiti asnjë pretendim lidhur me ndonjë keqtrajtim të supozuar në kohën që ndodhën ngjarjet dhe se ai pohoi fuqimisht se policët e kishin rrahur atë në publik në rrugën kryesore të qytetit. Në këto rrethana, Gjykata konsideroi se nuk ishte e qartë nëse kërkuesi gëzonte shëndet të mirë kur autoritetet arritën në vendin e ngjarjes. Kështu, Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të aspektit substancial të nenit 3 të Konventës.

Më tej, në lidhje me ankimin e kërkuesit, Gjykata vërejti se autoritetet vendase kryen një hetim të pretendimeve të tij për keqtrajtim. Një numër hapash proceduralë u ndërmorën nga autoritetet në lidhje me vërtetimin e këtyre pretendimeve. Megjithatë, Gjykata nuk ishte e bindur se përgjigja e autoriteteve ndaj pretendimeve të kërkuesit kishte qenë mjaftueshmërisht e plotë ose “efektive” për të përmbushur kërkesat e nenit 3. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se vendimi përfundimtar në këtë rast nuk dha ndonjë përgjigje të përcaktuar në lidhje me mënyrën e paraqitjes së kërkesës, se nga ishin shkaktuar dëmtimet e kërkuesit. Konsideratat e mësipërme ishin të mjaftueshme për t’i mundësuar Gjykatës të konkludonte se kishte pasur shkelje të aspektit procedural të nenit 3 të Konventës.

Hysi k. Shqipërisë, Malo k. Shqipërisë, Muca k. Shqipërisë dhe Topi k. Shqipërisë, vendime të 22 majit 2018 shkelje e nenit 6 (1) të Konventës (e drejta për një proces të rregullt ligjor)

Të katër çështjet kanë të bëjnë me procese penale të zhvilluara në mungesë të të akuzuarit. Të gjithë kërkuesit tani janë duke vuajtur dënime me burg nga 13 deri në 25 vjet. Tre nga kërkuesit jetonin jashtë vendit dhe mësuuan për dënimet e tyre kur u ekstraduan në Shqipëri në vitin 2006/7. Z. Topi paraqiti një ankim kushtetues kundër dënimit të tij në mungesë, i cili në vitin 2007 u deklarua se ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Ankimet kushtetuese të tre kërkuesve u hodhën poshtë. Të gjithë kërkuesit pretendonin se procedimet kundër tyre ishin të padrejta, sepse ato ishin zhvilluar në mungesë, pa dijeninë e tyre dhe se ata asnjëherë nuk kishin hequr dorë nga e drejta e tyre për t’u paraqitur në gjykatë. Gjithashtu, z. Topi pretendoi se refuzimi i ankimit të tij kushtetues kishte shkelur të drejtën e tij për akses në gjykatë.

Në çështjen *Hysi*, Gjykata vuri në dukje se një mohim i drejtësisë padyshim ndodh kur personi i dënuar në mungesë nuk mund të marrë më vonë një vlerësim të ri mbi themelin e çështjes nga gjykata e cila e ka dhënë vendimin ndaj tij, në lidhje me ligjin dhe faktin, kur nuk është vërtetuar se ai ose ajo ka hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur dhe për të mbrojtur veten.

Nuk ishte provuar se kërkuesi kishte njohuri të mjaftueshme për procesin penal kundër tij. As nuk ishte provuar se ai në mënyrë eksplicite apo të nënkuptuar i autorizonte veprimet e familjarëve së

tij gjatë procesit në apel, ose hoqi dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë duke shmangur kështu qëllimisht drejtësinë. Gjykata konstatoi se kërkuesi nuk kishte patur mundësi të merrte një vendim të ri për themelin e akuzave kundër tij nga një gjykatë, që do ta kishte dëgjuar atë në një proces të zhvilluar në pajtim me garancitë e nenit 6 § 1. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Në çështjen *Malo*, në dritën e arsyeve të sipërpërmendura, kërkuesi nuk kishte pasur realisht mundësi të kishte një shqyrtim të ri për themelin e akuzave kundër tij, në një proces që përmbush garancitë e nenit 6. Rrjedhimisht, edhe në këtë çështje Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Në çështjen e tretë *Muca*, Gjykata vërejti se frika e kërkuetit në lidhje me anshmërinë e Gjykatës së Shkallës së Parë nuk mund të konsiderohej se ishte objektivi dhe i justifikuar. Ndërkohë, në lidhje me dënimin e kërkuetit në mungesë, Gjykata gjeti se nuk ishte provuar se ai kishte njohuri të mjaftueshme për procesin e parë ose rivendosjen në afat të çështjes së tij. Për më tepër, në dosjen e çështjes nuk kishte asnjë indikacion se autoritetet ndërmorën ndonjë përpjekje për ta njoftuar kërkuetin. Për më tepër, kërkuesi paraqiti një kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit por pa sukses. Prandaj ky mjet ligjor rezultoi se nuk ishte efektiv. Kështu, Gjykata vendosi se në këtë rast kishte pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

Në vendimin e katërt të kësaj natyre, çështja *Topi*, Gjykata vërejti të njëjtat gjetje në kuadër të dënimin *in absentia*, duke gjetur kështu një shkelje të nenit 6 të Konventës. Gjykata nënvizoi se, duke mbajtur në vëmendje afatin kohor gjatë të cilit kërkuesi mund të bënte një ankim kushtetues filloi të ecte nga 1 marsi 2006, moment në të cilin ai nuk ishte në dijeni për ekzistencën e vendimit të Gjykatës së Lartë vendase. Gjykata Kushtetuese e kishte bërë të pamundur të drejtën e kërkuetit për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e tij për të paraqitur një ankim kushtetues. Kështu, vendimi i kundërshtuar përbënte një mohim të pajustificuar të së drejtës së kërkuetit për të aksesuar Gjykatën Kushtetuese. Rrjedhimisht, në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Frroku k. Shqipërisë, vendim i 18 shtatorit 2018 nuk pati shkelje të nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri)

Kjo çështje ka të bëjë me një ish-deputet i cili u paraburgos. Kishte tri sete procedimesh penale kundër tij, të cilat ai akuzohej në veçanti për dëshmi të rreme, vrasje me paramendim dhe pastrim të të ardhurave nga vepra penale. Parlamenti shqiptar e autorizoi arrestimin dhe ndalimin e tij në kontekstin e setit të parë dhe të dytë të procedimit. Për shkak se policia nuk ishte në gjendje të zbatonte masën e sigurisë arrest në shtëpi, Parlamenti autorizoi vendosjen e tij në paraburgim në lidhje me setin e dytë dhe të tretë të procedimeve, të cilat ndërkohë ishin bashkuar. Në procedurat gjyqësore të mëvonshme, Gjykata e Lartë vërtetoi ligjshmërinë e paraburgimit të tij, duke vërejtur se ekzistonte rreziku i prishjes dhe manipulimit të provave. Kërkuesi u ankua se ai ishte vendosur në paraburgim në mënyrë të paligjshme, pa autorizimin përkatës, në lidhje me setin e tretë të procedimit penal kundër tij.

Në këtë vendim, Gjykata nënvizoi se çështja kryesore që duhet të shqyrtohej, ishte fakti nëse arrestimi i kërkuetit në lidhje me këtë set procedimi ishte i "ligjshëm" në kuptim të nenit 5 § 1, duke përfshirë këtu edhe faktin nëse ky ndalim ishte ekzekutuar në përputhje e procedurën e parashikuar në ligj". Gjykata vlerësoi se, megjithëse autoritetet dështuan t'i kërkonin Parlamentit autorizim specifikisht për arrestimin në lidhje me setin e tretë të procedimeve, ky dështim nuk e bën të paligjshëm arrestimin e kërkuetit. Për rrjedhojë, në çështjen konkrete nuk ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

Pulfer k. Shqipërisë, vendim i 20 nëntorit 2018 shkelje e nenit 3 (ndalimi i torturës)

Çështja ka të bëjë me trajtimin e akuzave të kërkuases ndaj autoriteteve shqiptare, në të cilat pretendonte se një individ kishte blerë shtëpinë e saj, më pas e kishte sulmuar dhe kishte bërë përpjekje të paligjshme për ta nxjerrë kërkuosen nga shtëpia.

Në dhjetor të vitit 2011, znj. Pulfer dhe bashkëshorti i saj hynë në shtëpinë e blerë nga shtetasi S.N. në qytetin e Vlorës. Shtëpia ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme, por statusi i saj u rregullua në bazë të procedurave të legalizimit. Në janar të vitit 2012, S.N. u përpoq ta dëbonte znj. Pulfer nga prona. Më vonë po atë vit, në shtator, ai bëri një përpjekje të dytë për ta dëbuar, duke e lidhur atë me litar dhe duke e tërhequr atë nëpër dhomë dhe përplasur nëpër mure. Dy ditë më vonë, znj. Pulfer shkoi për të qëndruar në shtëpinë e nënës së saj. Në maj të vitit 2012, S.N. u akuzua për veprën penale të vetëgjyqësisë. Në dhjetor të atij viti kjo veprë penale u amnistua. Pas sulmit të znj. Pulfer të ndodhur në shtator 2012, një hetim tjetër u hap kundër S.N., i cili u akuzua për plagosje me dashje. Ky hetim u bashkua me një të tretë, në lidhje me kërcënimin përmes telefonit, që shtetasi S.N. kishte bërë ndaj kërkuases. Në shkurt 2013 ky hetim u ndërpre, përsëri në kuadër të amnistisë.

Në këtë vendim Gjykata vërejt se, sa i përket mekanizmave penale të parashikuara nga sistemi ligjor shqiptar, në lidhje me detyrimet e Shtetit sipas nenit 3 të Konventës, Kodi Penal përcakton si vepra penale specifike plagosjet e rënda trupore dhe veprat e tjera për të cilat znj. Pulfer e kishte akuzuar S.N., vepra të cilat shkaktojnë dëmtime tek subjekti i veprës penale. Gjykata vlerësoi se ligji shqiptar siguroi një kuadër rregullator të mjaftueshëm për të ndjekur penalisht krimet e atribuara nga kërkuësja për S.N.

Më tej, Gjykata vlerësoi se rrethanat e rastit në fjalë nuk u vërtetuan asnjëherë nga një gjykatë kompetente. Gjykata më parë ka konstatuar se në çështje që kanë të bëjnë me torturën ose trajtimin çnjerëzor, amnistitë dhe faljet nuk duhet të aplikohen. Në këtë kuptim, Gjykata arriti në përfundimin se, megjithëse kuadri ligjor në fuqi mund të ketë pasur një efekt të mjaftueshëm parandalues, ky i fundit humbi efektin nga ligji i amnistisë.

Në vlerësim të Gjykatës mënyra në të cilën janë zbatuar mekanizmat penale në çështjen në fjalë, konkretisht zbatimi i amnistisë, që rezultoi në ndërprerjen e tre hetimeve penale kundër personit të dyshuar, ishin të mangëta në pikën që përbënte një shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit të paditur në kuadër Konventës, në lidhje me pretendimet e kërkuases për sulmet. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kishte pasur një shkelje të nenit 3 të Konventës.

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Hyrje

Bosnja dhe Hercegovina (“BiH”) ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat Themelore (tani e tutje: “*Konventa ose KEDNJ*”) më 12 korrik të 2002 dhe që nga ajo datë, ajo është palë e Konventës dhe qytetarët e saj kanë mundësi të paraqesin çështje përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tani e tutje: “*GJEDNJ ose Gjykata*”).

Deri më 31 dhjetor 2018, Gjykata ka dhënë 62 vendime në lidhje me Bosnjë dhe Hercegovinën, nga të cilat katër janë dhënë nga Dhoma e Madhe, 38 nga një Dhomë dhe 20 nga një Komitet. Gjykata ka dhënë 99 vendime pranueshmërie, nga të cilat 46 janë dhënë nga një Dhomë dhe 53 nga një Komitet.

Ashtu siç u përmend, katër vendime kundër BiH u dhanë nga Dhoma e Madhe. Vendimi i parë i Dhomës së Madhe u dha në rastin e *Sejdić dhe Finci*⁴⁶, në të cilën Gjykata për herë të parë zbatoi nenin 1 të Protokollit nr. 12, ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit, në lidhje me dispozitat kushtetuese diskriminuese në gëzimin e të drejtave zgjedhore, në bazë të origjinës Judaiste apo Rome të kërkuesve. Një shkelje u gjet në bazë të nenit 14 marrë së bashku me nenin 3 të Protokollit nr. 1 dhe sipas nenit 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës.

Në vendimin e Dhomës së Madhe në vijim, *Maktouf dhe Damjanović k. BiH*⁴⁷, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 7 në lidhje me zbatimin e ligjit penal me fuqi prapavepruese, i cili parashikonte dënime më të rënda për krimet e luftës, sesa ligji në fuqi kur ishin kryer veprat penale. Në këtë rast, kërkuesve nuk u është ofruar mbrojtje efektive kundrejt caktimit të një dënimi më të rëndë.

Një problem sistematik u gjet në vendimin e Dhomës së Madhe të *Ališić dhe Tërjet k. Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*⁴⁸ sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe nenit 13 të Konventës, të cilat kanë të bëjnë me pamundësinë e kërkuesve për të tërhequr kursimet “e vjetra” nga llogaritë e tyre në bankë që nga shpërbërja e Republikës Socialiste të Federatës Jugosllave. Shkelje janë gjetur në llogari të Serbisë dhe Sllovenisë.

Sipas nenit 10 të Konventës, liria e shprehjes, u dha vetëm një vendim në rastin *Medžlis Islamske zajednice Brčko dhe Tërjet k. BiH*⁴⁹. Në këtë vendim të Dhomës së Madhe u shqyrtua kërkesa e kërkuesve lidhur me urdhrin e dhënë për pagimin e dëmeve në kuadër të proceseve civile për shpifje, ku Gjykata konstatoi se ndërhyrja ishte proporcionale dhe për rrjedhojë, nuk u gjet asnjë shkelje.

Numri më i madh i vendimeve të dhëna ndaj BiH janë ato që lidhen me të drejtat e pronës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe të drejtës për një proces të rregullt sipas nenit 6 të Konventës, për shkak të mosekzekutimit nga ana e autoriteteve shtetërore të vendimeve të formës së prerë të dhëna nga gjykatat vendase. Deri më 31 dhjetor 2018, Gjykata ka dhënë 34 vendime në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Gjithashtu, Gjykata ka dhënë 37 vendime në lidhje me nenin 6, nga të cilat në 36 raste janë konstatuar shkelje.

46 *Sejdić dhe Finci k. BiH*, vendim i DHM i 22 dhjetorit 2009.

47 *Maktouf dhe Damjanović k. BiH*, vendim i DHM i 18 korrikut 2013.

48 *Ališić dhe Tërjet k. Bosnjë dhe Hercegovinës*, vendim i DHM i 16 korrikut 2014 (vendim i Dhomës i 6 nëntorit 2012).

49 *Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe Tërjet k. Bosnjë dhe Hercegovinës*, vendim i Dhomës së Madhe 27 qershor 2017 (vendim i Dhomës i 13 tetorit 2015).

Sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata dha një vendim të rëndësishëm në të cilin u gjet një problem sistemik në rastin e *Đokić k. BiH*⁵⁰ lidhur me mbrojtjen e pronës mbi të drejtën e riposedimit të një banese “ushtarake” të paraluftës. Çështja lidhur me riposedimin e banesave “ushtarake”, u trajtua gjithashtu edhe në një vendim tjetër.⁵¹ Në lidhje me problemin sistemik të depozitave të “vjetra” në monedhë të huaj, u gjet shkelje e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ në vendimin e parë pilot ndaj BiH në rastin *Suljagić k. BiH*⁵². Gjykata konstatoi se të drejtat në lidhje me nenin 14 marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës ishin shkelur për shkak të diskriminimit të kërkuesve, të cilët ishin persona të larguar me detyrim nga banesat e tyre.⁵³

Në lidhje me të drejtën për t’u dëgjuar drejtësisht brenda një afati të arsyeshëm, referuar nenit 6 dhe e drejta e mbrojtjes së pronës, referuar nenit 1 të Protokollit nr.1, Gjykata ka dhënë vendime të rëndësishme si në rastin e parë kundër BiH, *Jeličić k. BiH*⁵⁴ (mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë), *Čolić dhe Të Tjerët*⁵⁵ (pezullimi ligjor i ekzekutimit të një kategorie të tërë vendimesh të formës së prerë për shkak të borxhit të madh publik që rrjedh nga vendimet gjyqësore), *Runić dhe Të Tjerët*⁵⁶ (vonesa të paarsyeshme në ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë), *Đurić dhe Të Tjerët k. BiH*⁵⁷ (mosekzekutimi i tejjgatur i vendimeve të brendshme të formës së prerë dhe të ekzekutueshme) dhe vendimeve të tjera në të cilat nuk janë marrë masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë brenda një periudhe të konsiderueshme⁵⁸. Shkeljet për shkak të tejjgjatjes së paarsyeshme të proceseve ose ekzekutimit me vonesë të vendimeve vendase, u përforcuan më vonë në disa raste të përsëritura.⁵⁹

Lidhur me nenin 6, u konstatua shkelje e së drejtës për akses në gjykatë në një rast në të cilin nuk kishte “përcaktim” real të të drejtave dhe detyrimeve civile para Gjykatës Kushtetuese të BiH.⁶⁰ Gjithashtu, Gjykata theksoi se në rastet e ndalimit, kur një kërkues është ende në paraburgim në kohën e shqyrtimit të kërkesave nga gjykatat e brendshme, një kërkesë e tillë lidhur me aksesin në gjykatë duhet të shqyrtohet sipas nenit 5 § 4 të Konventës.⁶¹

50 *Đokić k. BiH*, vendim i 27 majit 2010.

51 *Mago dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 3 majit 2012.

52 Edhe pse të dyja vendimet kanë të bëjnë me pamundësinë e kërkuesve për të tërhequr kursimet “e vjetra” në monedhë të huaj, dallimi kryesor midis *Suljagić k. BiH* dhe *Jeličić k. BiH* qëndronin në faktin se ndaj kërkuesit *Jeličić* u dha një vendim i formës së prerë i cili i akordonte asaj depozitën në valutë të huaj ndërkohë ndaj kërkuesit *Suljagić* nuk u dha një vendim i tillë, por ai sfidoi ligjshmërinë e ligjit të brendshëm, i cili parashikon skemën e përgjithshme të shlyerjes së depozitave në monedhë të huaj me anë të obligacioneve qeveritare.

53 *Šekerović dhe Pašalić k. BiH*, vendim i 8 marsit i 2011.

54 *Jeličić k. BiH*, vendim i 31 tetorit 2006.

55 *Čolić k. BiH*, vendim i 10 nëntorit 2011.

56 *Runić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 15 nëntorit 2011.

57 *Đurić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 20 janarit 2015.

58 *Kunić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 14 nëntorit 2017; *Spahić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 14 nëntorit 2017.

59 *Dorić k. BiH*, vendim i 7 nëntorit 2017; *Prazina k. BiH*, vendim i 5 dhjetorit 2017; *Mandić dhe Popović k. BiH*, vendim i 19 dhjetorit 2017.

60 *Avdić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 19 nëntorit 2013.

61 *Čović k. BiH*, vendim i 3 tetorit 2017.

Konstatimi i mospërbushjes së detyrimit pozitiv nga ana e autoriteteve shtetërore në lidhje me nenin 3 të Konventës për të hetuar fatin e një personi të zhdukur gjatë të luftës në BiH në periudhën 1992-1995.⁶² Në lidhje me të njëjtën problematikë janë marrë një sërë vendimesh.⁶³

Rasti nëse do të ekzistonte një rrezik real që kërkuesit, si azilkërkues, në rast deportimi, do t'i nënshtroheshin keqtrajtimit në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, u ngrit në 3 vendime.⁶⁴ Shqyrtimi sipas nenit 3 të Konventës, i një rasti të rëndësishëm në lidhje me integritetin fizik të kërkuesve pas burgosjes së tyre.⁶⁵

Në lidhje me nenin 5 vendimi më i rëndësishëm bazohej në sigurinë e të pandehurve me sëmundje të shëndetit mendor⁶⁶ dhe ndalimin e azilkërkuesve në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në rastet e azilkërkuesve, Gjykata ripërsëriti se ndalimi për arsye sigurie nuk është legjitim në kuptim të nenit 5 § 1 të Konventës.⁶⁷

Në lidhje me nenin 8, është marrë një vendim në të cilin Gjykata shqyrtoi detyrimin pozitiv të autoriteteve për të lehtësuar bashkimin e prindërve me fëmijët.⁶⁸

Në një vendim lidhur me nenin 9 të Konventës⁶⁹, në kuadër të ankesës për kufizimin e manifestimit të besimit të tij fetar, Gjykata vendosi mbi justifikimin dhe proporcionalitetin e dënimit të dhënë ndaj kërkuesit për mbajtjen e kapelës fetare në sallën e gjyqit.

Në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës, Gjykata gjeti shkelje të së drejtës së kërkuesit për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë (si në procedurat për kundravajtje ashtu dhe ato për krimet) për të njëjtën shkelje në kundërshtim me parimin *ne bis in idem*.⁷⁰

Vendime 2018

Midis janarit dhe dhjetorit 2018, GJEDNJ ka dhënë gjashtë vendime themeli dhe gjashtë vendime pranueshmërie në lidhje me BiH. Gjashtë nga vendimet e themelit u dhanë nga një Komitet i përbërë prej tre gjyqtarësh. Gjykata shqyrtoi raste në lidhje me të drejtat e parashikuara në nenin 6 (*e drejta për një proces të rregullt*), neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës (*e drejta e gëzimit paqësor të pronës*), dhe neni 5 i Konventës (*e drejta për liri dhe siguri*). Duke pasur në vëmendje rastet e mëparshme kundër BiH, mund të konkludojmë se ato vazhdojnë të përfshijnë çështje që mbulohen nga neni 6.

62 *Palić k. BiH*, vendim i 15 shkurtit 2011.

63 *Mujkanović dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 3 qershorit 2014; *Fazlić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 3 qershorit 2014; *Šeremet k. BiH*, vendim i 8 korrikut 2014; *Zuban dhe Hamidović k. BiH*, vendim i 2 shtatorit 2014; *Žerajić dhe Gojković k. BiH*, vendim i 13 nëntorit 2014.

64 *Al Husin k. BiH*, vendim i 7 shkurtit 2012; *Al Hanchi k. BiH*, vendim i 15 nëntorit 2011, *Al Hamdani k. BiH*, vendim i 7 shkurtit 2012.

65 *Rodić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 27 majit 2008.

66 *Tokić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 8 korrikut 2008.

67 *Al Hamdani k. BiH*, vendim i 7 shkurtit 2012; *Al Husin k. BiH*, vendim i 7 shkurtit 2012.

68 *Šobota-Gajić k. BiH*, vendim i 6 nëntorit 2007.

69 *Hamidović k. BiH*, vendim i 5 dhjetorit 2017.

70 *Muslija k. BiH*, vendim i 14 janarit 2014.

Ky seksion do të trajtohet më me detaje në vendimet e themelit dhe vendimet e pranueshmërisë të dhëna në lidhje me BiH në 2018, duke sjellë përmbledhje të shkurtra të fakteve dhe vendimeve të Gjykatës.

Vendime themeli

Neni 6 i Konventës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës

Rasti i Kryepeshkopatës Katolike Romane të *Vrhbosnas k. BiH*⁷¹ kishte të bënte me mosekzekutimin e vendimit të brendshëm të dhënë në favor të kërkuarit.

Në këtë rast, Kryepeshkopata e Bosnjës (“*Vrhbosanskanadbiskupija*”) bëri një kërkesë për t’ju rikthyer në posedim dhe përdorim pjesa e mbetur e ndërtesës së Shkollës së Mesme të Kryepeshkopatës dhe tokës përreth në Travnik të BiH. Duke filluar nga viti 1990, Kryepeshkopata e Bosnjës kishte kërkuar që Komuna e Travnikut t’i kthejë pronën që i ishte konfiskuar në vitin 1946 gjatë procesit të shtetëzimit. Në vitin 1998, Kryepeshkopata u rivendos në një pjesë të ndërtesës së Shkollës së Mesme të Kryepeshkopatës, ndërsa pjesa tjetër mbeti në kontrollin e komunës. Kërkuari e kundërshtoi këtë dhe gjithashtu ngriti pretendime se trajtimi i saj kishte qenë i diferencuar, çka përbënte diskriminim në gëzimin e të drejtave të tij të mbrojtura sipas Shtojcës 6 të Marrëveshjes së Përgjithshme në Kuadër të Paqes në BiH, pasi në vitin 1997 Komuna e Travnikit i ktheu Bashkësisë Islame të gjitha pronat e saj të mëparshme, të cilat i ishin konfiskuar në të njëjtën mënyrë si pasuria e konfiskuar e Kryepeshkopatës. Me një vendim të 9 majit 2003, Dhoma e të Drejtave të Njeriut për BiH vendosi që Federata e BiH kishte diskriminuar kërkuarin në gëzimin e të drejtës së lirisë së fesë, të garantuar në nenin 9 të Konventës. Me qëllim korrigjimin e situatës, ajo urdhëroi Federatën e BiH të sigurote zhvendosjen e shkollave publike të vendosura në ndërtesën e Shkollës së Mesme të Kryepeshkopatës në Travnik dhe ta rivendosnin kërkuarin në ambientet e tij brenda një viti. Më 30 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës vendosi që Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës ende nuk e kishte ekzekutuar plotësisht vendimin e 9 majit 2003. Shkolla publike nuk ishte zhvendosur ende që nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës.

Gjykata deklaroi parimet e përgjithshme në lidhje me mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme duke vënë në dukje se në raste të mëparshme kishte gjetur shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës lidhur me çështje të ngjashme me ato në rastin në fjalë. Duke pasur parasysh jurisprudencën dhe faktin se vendimi përfundimtar nuk ishte ekzekutuar për më tepër se katërmëdhjetë vjet, Gjykata, në përputhje me rrethanat, konsideroi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Në rastin *Martinović k. BiH*⁷², kërkuari ankohej se vonesa në ekzekutimin e vendimeve të brendshme të formës së prerë dhe të ekzekutueshme të dhëna në favor të saj, përbënin shkelje të të drejtave të saj sipas nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Gjykata parashtroi parimet e përgjithshme lidhur me mosekzekutimin ose vonesat në ekzekutimin e vendimeve të brendshme të formës së prerë, duke konstatuar shkelje të përsëritur të nenit 6 dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, lidhur me raste të tjera të ngjashme me ato të rastit në fjalë. Duke pasur parasysh faktin se vendimet e formës

⁷¹ *Roman Catholic Archdiocese of Vrhbosna k. BiH*, vendim i 5 qershor 2018.

⁷² *Martinović k. BiH*, vendim i 25 shtatorit 2018.

së prerë në fjalë nuk ishin ekzekutuar për më tepër se gjashtë vjet, Gjykata konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Vendime të tjera për të cilat Gjykata konstatoi shkelje për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të brendshme të formës së prerë ishin *Josić k. BiH*⁷³ dhe *Kaltak k. BiH*⁷⁴. Përveç kësaj, tek *Zahirović dhe Të Tjerët*⁷⁵, Gjykata theksoi se nuk pranon justifikimin e autoriteteve të cilët përmendin se kanë mungesë fondesh për të paguar detyrimin e vendimit të dhënë nga Gjykata, duke përsëritur se pamundësia për të ekzekutuar një vendim përfundimtar të dhënë në favor të kërkuarit, përbënte ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë.

Neni 5 - E drejta për liri dhe siguri

Në rastin *Salihović k. BiH*⁷⁶, kërkuari ankohej se vendosja e tij në një shtëpi të kujdesit social nuk ishte dhënë në përputhje me “procedurën e parashikuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 5 të Konventës, pasi ai ishte mbajtur në psikiatri pa një vendim të gjykatës kompetente civile. Gjykata Kushtetuese e BiH vendosi se kërkuarit i ishte shkelur e drejta për liri dhe siguri, thjesht duke konstatuar shkeljen ndaj tij, por pa i akorduar një shpërblim të drejtë.

Gjykata përsëriti se neni 5 i Konventës është në rang të parë të të drejtave themelore që mbrojnë sigurinë fizike të një individi dhe si e tillë, rëndësia e tij në një shoqëri demokratike është parakusht. Ai gjithashtu rikujtoi se në një çështje tjetër⁷⁷ kundër BiH, Gjykata gjeti shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës në rrethana shumë të ngjashme me ato të rastit dhe konstatoi të njëjtat shkelje në rastin në fjalë.

Vendime mbi pranueshmërinë

Kërkuari në rastin *Smajić k. BiH*⁷⁸, parashtroi dy kërkesa sipas nenit 6 § 1 dhe 3 (c) (e drejta për një proces të rregullt dhe e drejta të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij). Së pari, ai pretendoi se i ishte mohuar e drejta për të pasur një avokat pas arrestimit të tij dhe gjatë marrjes në pyetje në vitin 2010. Ai deklaroi se avokati i tij i kishte telefonuar rajonit të policisë ku po mbahej kërkuari, por avokatit i ishte thënë se i ndaluar nuk ishte aty. Së dyti, ai ankohej se gjykatat vendase kishin zbatuar në mënyrë arbitrare ligjin përkatës vendas. Më tej, ai u ankua se ishte dënuar për shprehjen e mendimit të tij lidhur me një çështje të interesit publik, çka përbënte shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes). Gjithashtu, ai ngriti pretendime lidhur me nenet 9 dhe 14 të Konventës.

Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata mbështeti gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të BiH dhe konstatoi se të dyja kërkesat lidhur me procesin e rregullt ishin haptazi të pabazuara dhe u hodhën poshtë si të papranueshme. Më tej, konstatoi se gjykatat e brendshme kishin shqyrtuar me kujdes rastin në fjalë, lidhur me kërkesën e tij për shkeljen e lirisë së shprehjes. Ai deklaroi se vendimet e brendshme ishin në përputhje me parimet e nenit 10, duke dhënë arsye të mjaftueshme dhe të vlefshme lidhur me dënimin

73 *Josić k. BiH*, vendim i 25 shtatorit 2018.

74 *Kaltak k. BiH*, vendim i 25 shtatorit 2018.

75 *Zahirović dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 16 tetorit 2018.

76 *Salihović k. BiH*, vendim i 6 shkurtit 2018.

77 *Hadžimejlić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 3 nëntorit 2015.

78 *Smajić k. BiH*, vendim i 8 shkurtit 2018.

e tij dhe gjithashtu vuri në dukje se përmbajtja e postimeve të kërkuesit në internet prekte një çështje shumë të ndjeshme të marrëdhënieve etnike në shoqërinë boshnjake pas luftës. Për më tepër, ndëshkimet e dhëna ndaj tij nuk kishin qenë të tepërta.

Në rastin *Rekić k. BiH*⁷⁹, kërkuesi u ankua për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës se atij i ishte mohuar aksesit efektiv në gjykatë si rezultat i pushimit të procesit penal ndaj palëve të treta. Gjykata vuri në dukje se kërkuesi kishte në dispozicion dy rrugë për të marrë një vendim nga gjykata lidhur me kërkesën civile për dëmet. Një rrugë ishte të ngrinte një padi civile në kontekstin e procesit penal që ai kishte iniciuar, dhe rruga tjetër ishte nisja e një procesi civil për kërkimin e dëmit para gjykatave civile. Megjithatë, meqenëse nuk arriti të përdorë asnjërën prej tyre, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa ishte haptazi e pabazuar dhe prandaj u hodh poshtë si e papranueshme.

Në rastin *Škandro k. BiH*⁸⁰ dhe *Karašin k. BiH*⁸¹ kërkuesi ankohej për moszekutimin e vendimit të brendshëm të formës së prerë sipas nenit 6. Në të dyja rastet, kërkuesit dhe përfaqësuesit e tyre nuk arritën të zbulonin informacione të rëndësishme dhe për më tepër, nuk ofruan asnjë shpjegim për mosveprimin e tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se kërkesat përbënin abuzim të së drejtës së kërkesës individuale dhe për këtë u hodhën poshtë si të papranueshme.

Një rast tjetër në të cilin Gjykata vlerësoi se kërkesat përbënin abuzim të së drejtës së kërkesës individuale në kuptim të nenit 35 § 3 (a) *in fine* të Konventës ishte rasti *Čalukand dhe të Tjerët k. BiH*⁸². Ajo ka të bëjë me një kërkesë sipas nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me moszekutimin e vendimit të formës së prerë nga ana e autoriteteve, të dhënë në favor të kërkuesve. Megjithatë, u konstatua se pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, vendimet e formës së prerë të dhëna në favor të kërkuesve u ekzekutuan plotësisht midis 16 korrikut 2015 dhe 25 korrikut 2016. Megjithatë, kërkuesit nuk e njoftuan Gjykatën lidhur me këto zhvillime.

Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesat në rastin *Muminović dhe të Tjerët. k. BiH*⁸³ për mos shtetërimin e mjeteve ligjore të brendshme. Ky rast ka të bëjë me kompanitë shtetërore dhe kompanitë me statut të bazuar në Federatën e BiH. Kërkuesit u ankuan për moszekutim të vendimeve të gjykatave vendase, por në veçanti theksuan se Federata e BiH, kantoni i Tuzlës dhe qyteti i Mostarit, si pronarët e vetëm ose në shumicë të kompanive Krivaja, TTU dhe Sigurnost, duhet të paguanin detyrimin e këtyre kompanive. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit kërkonin që pronarët e kompanive në fjalë duhet të mbanin përgjegjësi për detyrimet e vendosura në vendimin e dhënë në favor të tyre dhe duke kërkuar para Gjykatës heqjen e personalitetit juridik të korporatave në lidhje me ato kompani. Lidhur me këtë, *inter alia*, kërkuesit pretenduan se autoritetet në fjalë kishin abuzuar me formën e korporatës dhe kishin keqpërdorur asetet e kompanive. Gjykata vuri në dukje se kërkuesit nuk arritën të shtetëronin mjetet ligjore të brendshme, si një veprim civil që mund të kishte sjellë heqjen e personalitetit juridik të korporatave në rrethana të tilla. Në këtë mënyrë, ekzistonte dyshimi i arsyeshëm lidhur me efektshmërinë e mjetit ligjor, fakt që nuk linte dyshime për mospërdorimin e tij.

79 *Rekić k. BiH*, vendim i 29 marsit 2018.

80 *Škandro k. BiH*, vendim i 18 tetorit 2018.

81 *Karašin k. BiH*, vendim i 18 tetorit 2018.

82 *Čaluk dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 18 tetorit 2018.

83 *Muminović dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 20 dhjetorit 2018.

REPUBLIKA E KROACISË

Vështrim i përgjithshëm

Republika e Kroacisë nënshkroi dhe ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më poshtë: Konventa) në 5 nëntor 1997 dhe që prej atëherë ka qenë palë e procedurave para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të njeriut (më poshtë: Gjykata).

Gjykata deri më 31 dhjetor 2018 ka dhënë 400 vendime në lidhje me Kroacinë, duke gjetur shkelje të të paktën 1 neni të Konventës, në 317 vendime. Kroacia ka përmbyllur rreth 30 zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve në 21 vitet e fundit.

Dhoma e Madhe ka vendosur për 8 çështje kundër Kroacisë. *Blečić k. Kroacisë*⁸⁴ ishte çështja e parë kundër Kroacisë për të cilën ka dhënë vendim Dhoma e Madhe. *Marguš k. Kroacisë*⁸⁵, për të cilën gjithashtu ka dhënë vendim Dhoma e Madhe, duhet cilësuar si çështja në të cilën gjykata u përball për herë të parë me aplikimin e parimit *ne bis in idem* për krimet e luftës ose shkelje të tjera të së drejtës ndërkombëtare dhe humanitare, jo vetëm ndaj Kroacisë, por në përgjithësi. Së fundi, vendimi relativisht i ri i Dhomës së Madhe në çështjen *Muršić k. Kroacisë*⁸⁶, në një mënyrë përmbledh dhe riafirmon standardet e Gjykatës lidhur me kushtet e burgimit dhe zbatueshmërinë e ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, sipas nenit 3 të Konventës.

Dy vendimet më të fundit të Dhomës së Madhe në lidhje me Kroacinë, të dhëna në 2018, janë gjithashtu tepër relevante. Çështja *Zubac k. Kroacisë*⁸⁷ lidhej me të drejtën për akses në Gjykatën e Lartë ndërsa çështja *Radomilja dhe të Tjerët k. Kroacisë*⁸⁸ lidhej me të drejtën për gëzim të qetë të pasurisë, lidhur me pronën e shtetëzuar. Të dy këto vendime do të jepen me detaje më poshtë.

Një ndarje e vendimeve kundër Kroacisë sipas neneve, tregon se shumica e tyre lidhen me nenin 6 të Konventës (e drejta për proces të rregullt ligjor). Prej 249 vendimesh mbi nenin 6, 76 lidhen me të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pjesë e së drejtës për një proces të rregullt, mishëruar në nenin 6 të Konventës. Çështjet e tjera lidhen me të drejta të tjera sipas nenit 6 të Konventës si p.sh.: e drejta për një proces të rregullt ligjor, barazia e armëve, shkelja e të drejtës së prezumimit të pafajësisë ose të drejtës për t'u mbrojtur në procedura penale. Vendimet më të rëndësishme mbi nenin 6 përfshijnë padyshim vendimin e Dhomës së Madhe në çështjen *Dvorski k. Kroacisë*⁸⁹ (e drejta e të dyshuarit kriminal për t'u mbrojtur me avokat të zgjedhur nga vetë ai), si dhe në vendimin e Dhomës së Madhe për çështjet *Ajdarić k. Kroacisë*⁹⁰ (vlerësimi i provave dhe arsyetimi i pamjaftueshëm i dënimit penal), *Šikić k. Kroacisë*⁹¹ (përkufizimi dhe zbatimi i aspektit civil të nenit 6 të Konventës), *Klauz k.*

84 *Blečić k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 marsit 2006.

85 *Marguš k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 majit 2014.

86 *Muršić k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 tetorit 2016.

87 *Zubac k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 prillit 2018.

88 *Radomilja dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 marsit 2018.

89 *Dvorski k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 tetorit 2015.

90 *Ajdarić k. Kroacisë*, vendim i 13 dhjetorit 2011.

91 *Šikić k. Kroacisë*, vendim i 15 korrikut 2010.

*Kroacisë*⁹² (e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe kostot civile të procedurave). Në 2018, Gjykata dha vendim në çështjen *Goran Kovačević k. Kroacisë*⁹³ lidhur me aspekte shumë të ngjashme faktike dhe ligjore me çështjen *Dvorski*, por siç u kundërshtua në vendimin e mëvonshëm, nuk u gjet shkelje e Konventës në çështjen *Kovačević*.

Vendimet e mësipërme janë shumë të lidhura me vendimet e Gjykatës për të drejtën për zgjidhje efektive ligjore sipas nenit 13 të Konventës. Gjykata ka dhënë 66 vendime të tilla deri më sot. Sërish, shumica e tyre lidheshin me mungesën e një mjetei efektiv ligjor për mbrojtjen e të drejtës për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme.

Gjykata ka dhënë 57 vendime lidhur me Kroacinë, gjatë së cilave vendosi mbi të drejtat e nenit 8. Gjykata u mor me të drejtën për jetë private dhe familjare, të drejtën për banesë dhe privatësi të korrespondencës. Vendimet e saj më të rëndësishme mbi nenin 8 të Konventës në lidhje me Kroacinë përfshijnë ato të dhëna në çështjet *Karadžić k. Kroacisë*⁹⁴ (aspektet civile të rrëmbimit të fëmijës), *Gluhaković k. Kroacisë*⁹⁵ (e drejta e prindërve që nuk jetojnë me fëmijën për të mbajtur kontakt me të), *X k. Kroacisë*⁹⁶ (përfshirja e kërkuarës, së cilës i ishte hequr e drejta për të vepruar, gjatë procedurave për birësimin e vajzës së saj), *Ćosić k. Kroacisë*⁹⁷ (e drejta për banesë) dhe *Dragojević k. Kroacisë*⁹⁸ (shkelja e të drejtës për privatësi për shkak të urdhrave të paarsyetuara mjaftueshëm të gjykatës për përgjim dhe mbikëqyrje të fshehtë të kërkuarës). Vendimi i Gjykatës i vitit 2018 në çështjen *Pojatina k. Kroacisë*⁹⁹, lidhur me lindjet në shtëpi, ishte gjithashtu tepër i rëndësishëm. Gjykata konstatoi se legjislacioni lidhur me lindjet në shtëpi nuk përbënte shkelje të Konventës.

Gjykata ka dhënë 52 vendime ndaj Kroacisë lidhur me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës). Përveç vendimit të sipërpërmendur të Dhomës së Madhe në çështjen *Blečić k. Kroacisë*¹⁰⁰, vendimet më të rëndësishme të Gjykatës mbi këtë nen të Konventës përfshijnë ato në çështjet *Stlileo k. Kroacisë*¹⁰¹, (të drejtat e qiradhënësve nën legjislacionin e qiramarrjes së mbrojtur), *Vajagić k. Kroacisë*¹⁰², (e drejta e kompensimit për tokën e shpronësuar) dhe *Radanović k. Kroacisë*¹⁰³ (kthimi i pronës që është marrë dhe përdorur përkohësisht).

Gjykata ka dhënë 26 vendime për të drejtën për liri dhe siguri të personit, mbrojtur nga neni 5 i Konventës. Shumica e tyre kishin të bënin me privimin e lirisë, duke urdhëruar dhe zgjatur periudhën e dënimit me paraburgim dhe kohëzgjatjen totale të dënimit me burg.

92 *Klauz k. Kroacisë*, vendim i 18 korrikut 2013.

93 *Goran Kovačević k. Kroacisë*, vendim i 12 prillit 2018.

94 *Karadžić k. Kroacisë*, vendim i 15 dhjetorit 2005

95 *Gluhaković k. Kroacisë*, vendim i 12 prillit 2011.

96 *X k. Kroacisë*, vendim i 17 korrikut 2008.

97 *Ćosić k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2009.

98 *Dragojević k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2015.

99 *Pojatina k. Kroacisë*, vendim i 4 tetorit 2018.

100 *Blečić k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 marsit 2006.

101 *Stlileo k. Kroacisë*, vendim i 10 korrikut 2014.

102 *Vajagić k. Kroacisë*, vendim i 20 qershorit 2006.

103 *Radanović k. Kroacisë*, vendim i 21 dhjetorit 2006.

19 nga 23 vendime të Gjykatës mbi nenin 2 të Konventës (e drejta e jetës) në lidhje me Kroacinë, kishin të bënin me aspektin procedural të së drejtës së jetës, më konkretisht, zbatimin e hetimeve efektive dhe prezantimin e mekanizmave për mbrojtjen e së drejtës së jetës në sistemin e brendshëm. *Marta Jularić k. Kroacisë*¹⁰⁴ ishte vendimi i parë i këtij lloji. Vetëm 2 vendime të tjera janë marrë me aspektin e pavarur të së drejtës së jetës; i pari ishte *Branko Tomašić dhe të Tjerët k. Kroacisë*¹⁰⁵, i cili kishte të bënte me dhunën në familje.

Vendime 2018

Në 2018, Gjykata dha në total 24 vendime dhe 28 vendime për pranueshmërinë ose jo të çështjeve. Gjykata konstatoi se Kroacia kishte shkelur të paktën një nen të Konventës në 16 prej 24 vendimeve, dhe nuk kishte shkelje të Konventës në 8 vendime të dhëna në vitin 2018. Gjykata gjithashtu dha një vendim (çështja *Mindek k. Kroacisë*)¹⁰⁶ në të cilën u vendos pro kërkesës së Shtetit për të rishikuar vendimin e vitit 2016 mbi të njëjtën çështje.

Gjatë vitit 2018, Gjykata shqyrtoi një total prej 531 kërkesash kundër Kroacisë dhe i komunikoi 49 çështje të reja Zyrës së Agjentit Kroat para Gjykatës. 85 kërkesa (16%) iu caktuan gjyqtarëve të vetëm ose Komiteteve me tre gjyqtarë për të vendosur mbi pranueshmërinë. Pjesa tjetër iu caktuan një Komiteti ose Dhome për të shqyrtuar cilësitë e çështjes.

Nga vendimet e dhëna në vitin 2018, çështjet e mëposhtme u gjykuan nga një Dhomë e Madhe me 17 gjyqtarë: *Zubac k. Kroacisë* dhe *Radomilja dhe të Tjerët k. Kroacisë*¹⁰⁷. 11 çështjet e mëposhtme u gjykuan nga një Dhomë me 7 gjyqtarë: *V.D k. Kroacisë*, *Narodni List D.D k. Kroacisë*, *Pojatina k. Kroacisë*, *Mindek k. Kroacisë*, *S.M. k. Kroacisë*, *Bikić k. Kroacisë*, *Jureša k. Kroacisë*, *Čakarević k. Kroacisë*, *Hoti k. Kroacisë*, *Goran Kovačević k. Kroacisë* dhe *Milić dhe të Tjerët k. Kroacisë*¹⁰⁸.

11 çështjet e mbetura – *Vuković k. Kroacisë*, *Kobaš k. Kroacisë*, *Vojnović k. Kroacisë*, *Buvač k. Kroacisë*, *Štitić k. Kroacisë*, *Mateljan k. Kroacisë*, *Tilocca k. Kroacisë*, *Smolić k. Kroacisë*, *Gregurić k. Kroacisë*, *Prazajder k. Kroacisë* dhe *Slava Jurišić k. Kroacisë* – u gjykuan nga një Komitet prej 3 gjyqtarësh¹⁰⁹.

Gjykata nuk gjeti shkelje të KEDNJ në 8 çështje kundër Kroacisë në vitin 2018 – *Milić dhe të Tjerët k. Kroacisë*, *Radomilja dhe të Tjerët k. Kroacisë*, *Zubac k. Kroacisë*, *Goran Kovačević k. Kroacisë*, *Jureša k.*

104 *Marta Jularić k. Kroacisë*, vendim i 20 janarit 2011.

105 *Branko Tomašić k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2009.

106 *Mindek k. Kroacisë*, vendim i 11 shtatorit 2018.

107 *Zubac k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 prillit 2018; *Radomilja dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 marsit 2018.

108 *V.D k. Kroacisë*, vendim i 15 nëntorit 2018; *Narodni List D.D. k. Kroacisë*, vendim i 08 nëntorit 2018; *Pojatina k. Kroacisë*, vendim i 04 tetorit 2018; *Mindek k. Kroacisë*, vendim i 11 shtatorit 2018; *S.M. k. Kroacisë*, vendim i 19 korrikut 2018; *Bikić k. Kroacisë*, vendim i 29 majit 2018; *Jureša k. Kroacisë*, vendim i 22 majit 2018; *Čakarević k. Kroacisë*, vendim i 26 prillit 2018, *Hoti k. Kroacisë*, vendim i 26 prillit 2018; *Goran Kovačević k. Kroacisë*, vendim i 12 prillit 2018; dhe *Milić dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i 25 janarit 2018.

109 *Vuković k. Kroacisë*, vendim i 15 nëntorit 2018; *Kobaš k. Kroacisë*, vendim i 04 tetorit 2018; *Vojnović k. Kroacisë*, vendim i 04 tetorit 2018; *Buvač k. Kroacisë*, vendim i 06 shtatorit 2018; *Štitić k. Kroacisë*, vendim i 06 shtatorit 2018; *Mateljan k. Kroacisë*, vendim i 12 korrikut 2018; *Tilocca k. Kroacisë*, vendim i 05 prillit 2018; *Smolić k. Kroacisë*, vendim i 15 marsit 2018; *Gregurić k. Kroacisë*, vendim i 15 marsit 2018; *Parazajder k. Kroacisë*, vendim i 01 marsit 2018; dhe *Slava Jurišić k. Kroacisë*, vendim i 08 shkurtit 2018.

*Kroacisë, Bikić k. Kroacisë, Pojatina k. Kroacisë dhe V.D. k. Kroacisë.*¹¹⁰

Gjatë vitit 2018, Gjykata mori 25 vendime papranueshmërie në kërkesat kundër Kroacisë. 3 vendime të tilla – që u morën për çështjet *Seražin k. Kroacisë, Majcan k. Kroacisë dhe Mladost Turist A.D. k. Kroacisë*, u gjykuan nga Dhoma me 7 gjyqtarë, ndërsa 22 vendimet e tjera – që u morën për çështjet *Bjelik dhe të Tjerët k. Kroacisë, Vrbanić k. Kroacisë, Krstanović k. Kroacisë, Nijemčević k. Kroacisë, Turković dhe të Tjerët k. Kroacisë, Jurić k. Kroacisë, Prgić k. Kroacisë, D.K. k. Kroacisë, Todorović k. Kroacisë, Stojaković k. Kroacisë, Lambaša k. Kroacisë, Grizelj k. Kroacisë, Bojić k. Kroacisë, Spreicer k. Kroacisë, Trbojević k. Kroacisë, Godler k. Kroacisë, Leštek k. Kroacisë, Petek k. Kroacisë, Bosanac k. Kroacisë, Gradinščak k. Kroacisë, Mise k. Kroacisë, Miščević k. Kroacisë dhe Miščević k. Kroacisë* – u miratuan nga një Komitet prej 3 gjyqtarësh. Disa nga këto çështje do të shihen më me detaje më poshtë.

Neni 2 i Konventës - E drejta e jetës

Në vitin 2018, Gjykata dha një vendim dhe një vendim pranueshmërie lidhur me të drejtën e jetës, e sanksionuar në nenin 2 të Konventës. Të dyja çështjet kishin të bënin me detyrimin pozitiv të Shtetit për të kryer hetime efektive për pretendimet mbi vdekjet e dhunshme të viktimave. Të dyja çështjet kishin të bënin me hetimet e krimeve të kryera në Luftën Atdhetare, në të cilën të afërmit e kërkuesve kishin humbur jetën.

Në vendimin e saj në çështjen *Milić k. Kroacisë*¹¹¹, Gjykata përsëriti qëndrimin e saj se procedurat civile nuk ishin relevante për detyrimin procedural të Shtetit sipas nenit 2 të Konventës dhe nuk mund të ndikojnë në zbatimin e afatit gjashtë mujor, në çështjen lidhur me pretendimin për hetim joefektiv të krimit. Gjykata hodhi poshtë pjesën e kërkesës lidhur me hetimin e kryer para 11 gushtit 2015, sepse kërkuesit duhet të kishin pasur dijeni për joefektivitetin e hetimit kohë më parë se të dorëzonin kërkesën e tyre në Gjykatë. Sa i takon veprimeve nga autoritetet vendase pas 11 gushtit 2015, Gjykata konstatoi se policia kishte kontrolluar gjithë informacionin e raportit anonim, por nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim konkret; se kishin marrë në pyetje dëshmitarët, ndjekur gjithë pistat dhe rrugët e hetimit penal dhe si përfundim, të gjithë autoritetet kombëtare kishin qenë në përputhje me detyrimet procedurale që rrjedhin nga neni 2 i Konventës.

Neni 3 i Konventës – Ndalimi i torturës, dënimit dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues

Në vitin 2018, Gjykata dha 2 vendime dhe një vendim pranueshmërie lidhur me kërkesat mbi nenin 3, për Kroacinë. Ajo konstatoi se në një çështje, Kroacia kishte shkelur nenin 3 të Konventës dhe në një çështje tjetër nuk kishte shkelur aspektin procedural të nenit 3 të Konventës. Ajo dha një vendim në të cilin shpallte papranueshmërinë e një kërkesë që pretendonte joefektivitetin e një hetimi mbi keqtrajtimin.

¹¹⁰ *Milić dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i 25 janarit 2018; *Radomilja dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 marsit 2018; *Zubac k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 prillit 2018; *Goran Kovačević k. Kroacisë*, vendim i 12 prillit 2018; *Jureša k. Kroacisë*, vendim i 22 majit 2018; *Bikić k. Kroacisë*, vendim i 29 majit 2018; *Pojatina k. Kroacisë*, vendim i 4 tetorit 2018; dhe *V.D. k. Kroacisë*, vendim i 15 nëntorit 2018.

¹¹¹ *Milić dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i 25 janarit 2018.

Vendimi i Gjykatës në çështjen *V.D. k. Kroacisë* (nr. 2)¹¹² duhet të veçohet për shkak të rëndësisë si në jurisprudencën e Gjykatës, ashtu edhe në procedurën e ekzekutimit të vendimeve para Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Konkretisht, Gjykata në këtë çështje rishikoi efektivitetin e hetimit (të rihapur) të kryer nga autoritetet përkatëse pasi Gjykata dha vendimin e saj në çështjen V.D k. Kroacisë¹¹³, me një qëndrim për të rihapur vendimin e saj. Në vendimin e saj V.D. k. Kroacisë (nr. 2)¹¹⁴, Gjykata konstatoi se hetimi i kryer pas dhënies së vendimit të saj të parë kishte qenë efektiv, se autoritetet përkatëse kishin ndërmarrë të gjitha hapat për të vërtetuar se çfarë kishte ndodhur me kërkuesin dhe nëse policia kishte tejkaluar autoritetin e vet dhe kishte kryer një krim ndaj tij. Gjykata nuk gjeti shkelje të aspektit procedural të nenit 3 në këtë rast.

Në vendimin e çështjes *Štitić k. Kroacisë*¹¹⁵, Gjykata u shpreh se kishte gjetur shkelje të nenit 3 të Konventës, kryesisht sepse Kroacia nuk kishte përmbushur detyrimin e saj për të kryer një hetim efektiv dhe ky vendim ishte gjithashtu i rëndësishëm për t'u theksuar. Kërkuesi kishte bërë kërcënime serioze dhe kishte paraqitur një padi kundër oficerëve të policisë, duke pretenduar se ai ishte keqtrajtuar gjatë arrestimit të tij dhe mbajtjes nën vëzhgim nga policia. Autoritetet përkatëse hodhën poshtë kërkesën e tij, rrjedhimisht askush nuk mbajti përgjegjësi për dëmtimet që ai kishte pësuar. Gjykata u shpreh se prokurori kompetent kishte kërkuar hetimin sipas pretendimeve që kërkuesi kishte paraqitur në padi, në të njëjtin komisarjat policie në të cilin punonin oficerët e policisë që ai kishte paditur, gjë që vuri në dyshim pavarësinë dhe paanshmërinë e hetimit. Më tej, prokurorët kishin hedhur poshtë raportin bazuar vetëm në dëshmitë dhe raportet e vetë policëve, gjë që tregonte se hetimi nuk kishte qenë tërësisht i plotë dhe efektiv. Pasi kërkuesi filloi një ndjekje penale, gjykatat vendase hodhën poshtë kërkesën e tij për të nisur një hetim, pa shpjeguar pse provat që ai paraqiti ishin pa vend. Specifikisht, autoritetet e ndjekjes penale sërish nuk bënë përpjekje serioze në vlerësimin e aspektit më të rëndësishëm të çështjes – nëse forca e ushtruar nga oficerët e policisë ishte e nevojshme dhe/ose e tepruar në situatën e dhënë. Në vend të kësaj, autoritetet vendase limituan vlerësimet e tyre vetëm në leximin e raportit mjekësor të kërkuesit dhe dëshmitë e dhëna nga oficerët e policisë që ishin përfshirë në çështje, të cilët sigurisht nuk shpjeguan të gjitha rrethanat përkatëse të keqtrajtimit të kërkuesit. Rrjedhimisht, Gjykata përmbylli se Shteti kishte shkelur nenin 3 të Konventës sepse nuk kishte përmbushur detyrimin procedural sipas atij neni.

Neni 4 i Konventës – Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar

Në vitin 2018, Gjykata dha vendimin e saj të parë ndaj Kroacisë, në të cilin kishte konstatuar shkelje të nenit 4 të Konventës. Megjithatë, vendimi në çështjen *S.M. k. Kroacisë*¹¹⁶ nuk është ende përfundimtar, duke qenë se Gjykata pranoi kërkesën për t'ia dërguar çështjen Dhomës së Madhe.

Kërkuesja paraqiti një padi kundër T.M., duke pretenduar se ai e kishte detyruar fizikisht dhe psikologjikisht atë të prostitutohej, në periudhën e verës 2011 deri më shtator të të njëjtit vit. Prokuroria ngarkoi T.M. me akuzat se kishte detyruar dikë të kryente prostitucion. T.M. u lirua për shkak të mungesës së provave. Kërkuesja u ankua para Gjykatës se Kroacia nuk kishte një kuadër legjislativ të

112 *V.D. k. Kroacisë* (nr. 2), vendim i 15 nëntorit 2018

113 *V.D. k. Kroacisë*, vendim i 8 nëntorit 2011.

114 *V.D. k. Kroacisë* (nr. 2), vendim i 15 nëntorit 2018.

115 *Štitić k. Kroacisë*, vendim i 6 shtatorit 2018.

116 *S.M. k. Kroacisë*, vendim i 19 korrikut 2018.

përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave të saj sipas nenit 4 të Konventës, se ajo nuk ishte pajisur me asistencën dhe suportin e nevojshëm për të lehtësuar frikën dhe presionin që kishte ndjerë teksa dëshmonte ndaj T.M. dhe se autoritetet vendase nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre procedurale sipas Konventës. Gjykata u shpreh se kuadri ligjor kroat mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe detyrimin e prostitucionit ishte i përshtatshëm dhe se kërkueses i ishte ofruar ndihmesë dhe mbështetje, prandaj kishte tërhequr dy kërkesat e mëparshme. Gjykata konstatoi se policia dhe prokuroria ishin përgjigjur me shpejtësi, kishin kryer hetime dhe kishin pyetur kërkuesen dhe shoqen e saj gjatë procedurave penale. Megjithatë, Gjykata u shpreh se autoritetet vendase nuk kishin marrë një sërë hapash të tjerë (p.sh., nuk kishin bërë përpjekje për të identifikuar klientët e kërkueses dhe t'i intervistonin, gjithashtu nuk kishin marrë prova nga mamaja e shoqes së kërkueses ose i dashuri i saj, ose nga qiradhënësi i kërkueses ose fqinjët), duke konstatuar kështu për shkelje të Konventës.

Neni 6 i Konventës – E drejta për proces të rregullt ligjor

Gjatë vitit 2018, Gjykata dha 7 vendime dhe 14 vendime mbi pranueshmërinë/rrëzimin e kërkesave që pretendonin shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 6 nga ana e Kroacisë në 3 nga 7 vendimet dhe gjeti shkelje të të paktën një aspekti të së drejtës për proces të rregullt ligjor në 4 të tjera.

Vendimi i Dhomës së Madhe në çështjen *Zubac k. Kroacisë*¹¹⁷, që lidhje me të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, është padyshim vendimi më i përshtatshëm kundër Kroacisë në lidhje me nenin 6, gjatë vitit 2018. Vjehri i kërkueses kishte nënshkruar një kontratë për shkëmbimin e shtëpisë së tij në Dubrovnik me një shtëpi në Trebinjë në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 1992. Pas vdekjes së tij, kërkuesja dhe bashkëshorti i saj nisën procedurat për të shpallur të pavlefshme kontratën për shkëmbimin e shtëpisë dhe për të marrë në posedim shtëpinë në Dubrovnik. Bashkëshorti i kërkueses tregoi se subjekti i mosmarrëveshjes kishte vlerën 10,000 kuna. Kërkuesja ndoqi procedurat pas vdekjes së bashkëshortit të saj. Gjatë procedurave, kërkuesja u shpreh se vlera e subjektit ishte 105,000 kuna. Pala tjetër kundërshtoi rritjen e vlerës së subjektit, duke arsyetuar se vlera e subjektit ishte shfaqur më e lartë vetëm që kërkuesja të mund të kundërshtonte kontratën në bazë të ligjit. Pas paraqitjes së provave dhe dëgjësës së të dyja palëve, Gjykata e Rrethit të Dubrovnikut hodhi poshtë mocionin e kërkueses për pavlefshmërinë e kontratës. Gjithashtu, kjo gjykatë llogariti tarifat gjyqësore duke iu referuar vlerës më të lartë të subjektit, 105,000 kuna. Gjykata e Dubrovnikut mbështeti të njëjtin vendim në Apel. Kërkuesja apeloj vendimin në Gjykatën e Lartë sipas ligjit, duke kontestuar për vendimet e gjykatave më të ulëta. Gjykata e Lartë kroate rrëzoi padinë si të papranueshme *ratione valoris*, sepse vlera e objektit të mosmarrëveshjes nuk arrinte të kalonte pragun ligjor prej 100,000 kuna. Kërkuesja dorëzoi një padi pranë Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar për shkelje të së drejtës së saj për akses në Gjykatë. Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën si të papranueshme me arsyetimin se çështja nuk ngrinte probleme kushtetutshmërie.

Dhoma e Madhe si fillim u shpreh se çështja nuk kishte të bënte me pyetjen nëse, pranohej që sistemi i brendshëm, brenda nenit 6 të Konventës, të vendoste kufizime në aksesin në Gjykatën e Lartë, as me shtrirjen e marrëveshjeve të mundshme që parashikonin kufizime të tilla. Përkundrazi, çështja në fjalë kishte të bënte me pyetjen nëse, në rrethana të veçanta të çështjes, Gjykata e Lartë, duke deklaruar ankesën e kërkueses si të papranueshme nga ligji, aplikoi formalizëm të tepruar dhe

¹¹⁷ *Zubac k. Kroacisë*, vendim i 5 prillit 2018.

ndikoi në mënyrë joproportionale mundësinë e saj për të marrë një vendim përfundimtar për pronën e saj nga ajo gjykatë, siç garantohet ndryshe sipas ligjit vendas. Dhoma e Madhe njohu më tej faktin se kërkesa e një pragu ligjor *ratione valoris* për ankesat në Gjykatën e Lartë ishte një kërkesë procedurale e arsyeshme, duke pasur parasysh thelbin e rolit të Gjykatës së Lartë, për t'u marrë vetëm me çështje të një rëndësie të lartë.

Gjykata theksoi se natyra e kufizimit në fjalë, e cila u pasua nga legjislacioni dhe praktika e brendshme e Gjykatës së Lartë, nuk duket në vetvete rezultat i rregullave të pandershme procedurale. Dhoma e Madhe arriti në përfundimin se nuk mund të thuhet se vendimi i Gjykatës së Lartë përbënte një pengesë joproportionale që dëmtonte thelbin e së drejtës së kërkujes për akses në gjykatë, të garantuar sipas nenit 6 (1) të Konventës ose shkeli kufirin kombëtar të vlerësimit.

Neni 8 i Konventës – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

Gjatë 2018, Gjykata dha pesë vendime themeli dhe tre vendime pranueshmërie në lidhje me shkelje të nenit 8 nga Kroacia.

Çështja *Vojnović k. Kroacisë*¹¹⁸ vlen të përmendet. Kërkuësja zuri një banesë të vendosur në një ndërtesë të shkatërruar në qendër të Zagrebit në 2004. Në vitin 2005, në kontekstin e procesit të denacionalizimit, një individ tjetër u bë pronar i ndërtesës. Pronari planifikoi ta shiste ndërtesën tek investitorët e pasurive të patundshme të interesuar për këtë zonë e cila ndodhej në zemër të qytetit. Kërkuësja denoncoi një sërë incidentesh në polici për periudhën nga dhjetori 2005 deri në mars 2011, kur ajo u largua nga banesa; ajo raportoi se një plumb ishte qëlluar në banesën e saj, kishte vërejtur zhurma të pazakonta në banesën fqinje ku nuk jetonte njeri, kishte marrë kërcënime nga një individ i cili pretendonte se përfaqësonte investitorin dhe i ofroi para e kërkujes për t'u zhvendosur, si edhe dy raste ku në ndërtesë kishte rënë zjarr.

Gjithashtu, kërkuësja raportoi se ajo ishte kërcënuar nga pronari i ri i ndërtesës, si dhe faktin se vazhduan të ndodhnin incidente edhe pasi kishte nënshkruar një kontratë me pronarin e ri, sipas së cilës ajo do të largohej nga banesa në këmbim të një shume parash, duke pretenduar se e kishte nënshkruar kontratën si rezultat i kërcënimeve. Policia vendase ka vepruar për çdo ankesë, por nuk ka iniciuar ndjekje penale kundër askujt. Gjykata theksoi se, kur një individ bën një pohim të besueshëm se ka qenë subjekt i akteve të përsëritura të ngacmimit, sado të parëndësishme apo të izoluara të jenë incidentet është detyrë e autoriteteve vendase për të vlerësuar situatën në tërësi, duke përfshirë këtu rrezikun, që incidente të ngjashme mund të vazhdojnë.

Gjykata vërejt se ky vlerësim duhet, mbi të gjitha, të marrë në konsideratë efektin psikologjik që rreziku i ngacmimeve, kërcënimeve dhe dhunës së përsëritur mund të ketë në jetën e përditshme të viktimës, si edhe se aty ku është vërtetuar se një individ i caktuar është synuar në mënyrë sistematike dhe abuzimi i ardhshëm ka të ngjarë të vazhdojë, përveç përgjigjeve ndaj incidenteve specifike, autoritetet mund ndërmarrin një veprim të përshtatshëm të natyrës së përgjithshme për të luftuar problemin kryesor. Në kontekstin e çështjes në fjalë, Gjykata vuri në dukje se kërkuësja kishte pohuar se i ishte nënshtruar rasteve të përsëritura të kërcënimeve dhe ngacmimeve, si edhe se në dy raste kishte pasur zjarrvënje në ndërtesë, të cilat kishin vënë në rrezik integritetin fizik dhe mendor dhe pasurinë e

118 *Vojnović v. Kroacisë*, vendim i 4 tetorit 2018.

kërkueses dhe qiramarrësve e tjerë, - kishin pasur për qëllim frikësimin e saj dhe fqinjëve të tjerë për t'u larguar nga banesat. Gjykata vlerësoi se aktet e supozuara të dhunës si ato, kërkonin që Shteti të merrte masa adekuate pozitive në sferën e mbrojtjes penale.

Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet vendase kishin dështuar në përmbushjen e detyrimit të tyre për t'ju përgjigjur në mënyrë efektive dhe të shpejtë pretendimeve të kërkueses për ngacmime, zjarrvënie dhe kërcënime. Gjithashtu, Gjykata arriti në përfundimin se mënyra se si u zbatuan mjetet penale në dispozicion, në kuadër të rrethanave të rastit aktual, ishte e mangët deri në pikën që përbënte shkelje të detyrimeve procedurale të shtetit të paditur, në kuadër të nenit 8 të Konventës.

Një tjetër vendim i trajtuar në kuadër të nenit 8, që vlen të përmendet është çështja *Turković dhe të Tjerë k. Kroacisë*¹¹⁹, e cila u deklarua e papranueshme nga Gjykata. Kërkuesit jetonin në të njëjtën shtëpi në afërsi të land-fillit kryesor të Zagrebit, Jakuševac-Prudinec. Ky vend i asgjësimit të mbeturinave u krijua në vitet 1960, kur ata që jetonin në zonat e afërta filluan të hidhnin në mënyrë të paligjshme mbeturinat e tyre atje. Kërkuesit në mënyrë të përsëritur u ankuan në polici për zjarret që viheshin në vendin e asgjësimit dhe erërat që vinin prej tij. Në maj të vitit 2014, njëri nga kërkuesit paraqiti një padi penale kundër zyrtarëve të pidentifikuar të Bashkisë së Zagrebit, duke pretenduar se, për shkak të hedhjes së mbeturinave në mënyrë ilegale në raste të ndryshme, vendi i asgjësimit ishte zgjeruar në zonën pranë shtëpisë së tij dhe përbënte një kërcënim për jetën dhe mirëqenien e të gjithë individëve që jetojnë në afërsi të asaj zone.

Pas një hetimi gjithëpërfshirës të akuzave të tij, Prokuroria e Zagrebit e hodhi poshtë padinë e tij duke gjetur, në bazë të inspektiveve të shumta të kryera në terren dhe intervistave me të gjithë të interesuarit, se zyrtarët përkatës të qytetit të Zagrebit kishin ndërmarrë gjithmonë masat e nevojshme për të kontrolluar veprimtarinë dhe menaxhimin e vendit të asgjësimit të mbeturinave, si edhe faktin se agjencitë përkatëse që vazhdimisht mbikëqyrnin vendin nuk kishin vërejtur hedhje mbeturinash ose parregullsi të tjera të afta për të shkaktuar dëme afatgjata dhe të rënda në mjedis ose rrezikimin e jetës apo shëndetit të njerëzve. Në parashtrësat e tyre në Gjykatë, kërkuesit u ankuan, në kuadër të neneve 8 dhe 13 të Konventës, me argumentin se shteti kishte dështuar për t'i mbrojtur ata nga kërcënimi i katastrofës ekologjike të paraqitur nga vendi i asgjësimit të mbetjeve.

Duke shqyrtuar shterimin e mjeteve juridike të brendshme, si një nga kërkesat thelbësore të pranueshmërisë, Gjykata theksoi se në disa raste ajo ka konsideruar se një kërkues nuk mund të shmanget nga detyrimi për të përdorur një mjet juridik të vlerësuar nga Gjykata si rruga më e përshtatshme për adresimin e një ankese të veçantë të Konventës, pavarësisht nga rregullimi i veçantë i mjeteve ligjore vendase vënë në dispozicion për të adresuar thelbin e ankesës së tij. Prandaj, në kontekste të ndryshme, duke përfshirë edhe mbrojtjen e mjedisit, kur nga këndvështrimi i jurisprudencës së Gjykatës, kërkuesit nuk kanë përdorur mjetin e duhur dhe në vend, kanë përdorur një mjet tjetër juridik, Gjykata ka deklaruar ankesat e tyre të papranueshme në kuadër të mosshterimit të mjeteve juridike të brendshme. Në rastin në fjalë, kërkuesit paraqitën një padi penale kundër zyrtarëve të Bashkisë së Zagrebit, duke pretenduar keqmenaxhim dhe rreziqe mjedisore lidhur me funksionimin e vendit të asgjësimit të mbeturinave. Kjo padi penale u refuzua sepse u konsiderua se elementet e përgjegjësisë penale në lidhje me zyrtarët e bashkisë nuk ishin plotësuar. Kërkuesit nuk arritën të shteronin mjetet e tjera juridike në dispozicion.

119 *Turković dhe të Tjerë k. Kroacisë*, vendim i 10 korrikut 2018.

Gjykata vërejt se nuk e konsideronte zgjidhjen e vështirësive të kërkuesve sa i takon shqetësimeve që rridhnin nga vendi i asgjësimit të mbetjeve për llogari të ndjekjes penale të gënjeshtërt, pasi ekzistonin dhe mjetet përkatëse civile.¹²⁰ Duke pasur parasysh se kërkuesit nuk kishin shteruar asnjë nga mjetet juridike të listuara, Gjykata e deklaroi kërkesën e tyre në kuadër të nenit 8 të Konventës si të papranueshme.

Neni 10 – Liria e shprehjes

Gjatë 2018 Gjykata dha dy vendime në lidhje me lirinë e shprehjes, konkretisht në çështjet *Slava Jurišić k. Kroacisë*¹²¹ dhe *Narodni List k. Kroacisë*.¹²² Vendimi i fundit është i rëndësishëm sepse Gjykata ka vendosur se, kur gjyqtarët veprojnë në kapacitetin e tyre zyrtar, mund të jenë subjekt i kufijve më të gjerë të kritikave të pranueshme, nëse këto kritika janë në interes të publikut dhe liria e shtypit në këto raste tejkalon të drejtën e gjyqtarëve një jetë të qetë private¹²³. Konkretisht, e përjavshmja Narodni kishte publikuar në tetor 2008 një artikull të titulluar “Gjyqtari B. duhet të ndëshkohet publikisht”, në të cilin ajo kritikoi një gjyqtar vendas. E përjavshmja refuzoi të publikonte një falje publike e cila u kërkua nga gjyqtari. Gjyqtari ngriti një padi civile për shpifje kundër gazetës duke kërkuar dhe shpërbllim dëmi për cenim të privatësisë së tij. Gjatë këtij procesi, gazeta pretendoi në mënyrë eksplicite se liria e shprehjes lejonte përdorimin e një gjuhe më të ashpër. Gjykata e shkallës së parë vendase i akordoi gjyqtarit një dëmshpërbllim prej HRK 50,000 (afërsisht €7,500) dhe i ngarkoi kërkuesit dhe shpenzimet gjyqësore.

Gjykata kualifikoi dëmin e pësuar nga kompania përkuese si një ndërhyrje në të drejtën e saj për t`u shprehur lirisht, por vërejt se masa e ndërmarrë ishte e ligjshme dhe ndiqte një qëllim legjitim, konkretisht për të mbrojtur reputacionin e gjyqtarit B. Megjithatë, Gjykata vërejt se kjo masë nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, duke theksuar kështu se shtypi gëzon një shkallë tepër të lartë mbrojtjeje sa i takon lirisë së shprehjes. Gjykata vërejt se artikulli kishte të bënte me një çështje në interes të publikut dhe nuk ofertonte gjyqtarin, por ishte kritik ndaj tij dhe në titullin e artikullit pavarësisht se ishte përdorur një metaforë e ekzagjeruar dhe e rëndë në dukje, nuk ishte në parim në mospërputhje me nenin 10 të Konventës. Në vështrim të gjithë gjetjeve të mësipërme, Gjykata vlerësoi se dëmi që i ishte shkaktuar reputacionit të gjyqtarit B. në çështjen konkrete nuk ishte i një niveli të tillë për të justifikuar një penaltet kaq të madh, si ai që ju vendos gazetës. Për rrjedhojë, Gjykata vërejt se Kroacia kishte shkelur lirinë e shprehjes së kërkuesit.

Neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës – Mbrojtja e pronës

Gjatë vitit 2018 Gjykata dha pesë vendime themeli dhe tetë vendime mbi pranueshmërinë/nxjerrje jashtë nga lista e gjykimeve në lidhje me kërkesat që pretendonin se Kroacia kishte shkelur të drejtën e gëzimit paqësor të pronave sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

120 Në mënyrë të veçantë, në vendimin e saj të mëparshëm në çështjen *Cokarić k. Kroacisë*, Gjykata vuri në dukje se ligji kroat siguroi dy mjete juridike adekuate për ankesat mjedisore: kërkesat për eliminimin e rrezikut të dëmit dhe kompensimin për dëmet që tejkalojnë kufijtë e zakonshëm që kanë ndodhur gjatë kryerjes të veprimtarive në interes të përgjithshëm, për të cilat është marrë një leje e autoritetit kompetent (paragrafët 1 dhe 3 të nenit 1047 të Ligjit mbi Detyrimet Civile). Ajo vuri në dukje se mbrojtja shtesë ishte dhënë nga Neni 167 i Ligjit të Pronës, duke lejuar palët të paraqesin kërkesa për dëmet që kërkojnë mbrojtje nga emetimet e dëmshme.

121 *Slava Jurišić k. Kroacisë*, vendim i 8 shkurtit 2018.

122 *Narodni List D.D. k. Kroacisë*, vendim i 8 nëntorit 2018.

123 Ky vendim nuk është bërë ende përfundimtar në kohën e përgatitjes të këtij materiali.

Më i rëndësishmi ndër to ishte vendimi i Dhomës së Madhe në çështjen *Radomilja dhe të Tjerët k. Kroacisë*¹²⁴, në të cilën Gjykata konstatoi se Kroacia nuk i kishte shkelur të drejtat e kërkuësve sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Në këtë çështje kërkuësit pretenduan se ishte shkelur e drejta e tyre për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre, sepse gjykatat vendase kishin refuzuar t'i njihnin atyre pronësinë e fituar me posedim të pandërprerë. Prona në fjalë përbënte parcela toke që kishin qenë në posedimin e tyre të pandërprerë për më shumë se 100 vjet.

Së pari, Dhoma e Madhe vuri në dukje se Dhoma nuk kishte shqyrtuar çështjen nëse posedimi i vazhdueshëm mund të konsiderohej “pronë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, në vështrim të së drejtës së brendshme, sipas së cilës toka në fjalë ishte shtetëzuar midis 6 prill 1941 deri më 8 tetor 1991, si edhe vendimeve që gjykatat vendase kishin dhënë për çështjen. Përkatesisht, legjislacioni i ish-Jugosllavisë ndalonte blerjen e pronës shtetërore me posedim të pandërprerë. Dhoma e Madhe vuri në dukje se kërkuësit në pretendimet e tyre nuk ishin referuar aspak në këtë periudhë, duke e përjashtuar këtë periudhë edhe në ankimin e tyre kushtetues.

Prandaj, Dhoma e Madhe arriti në përfundimin se Dhoma kishte vepruar përtej fushëveprimit të çështjes siç kufizohej nga kërkuësit kur ishte përfshirë ajo periudhë në shqyrtimin e së drejtës së tyre. Dhoma e Gjykatës konstatoi se ankimet e kërkuësve lidhur me periudhën ndërmjet 6 prillit 1941 dhe 8 tetor 1991 ishin të papranueshme, pasi kjo do të përbënte një “ankim të ri” në Dhomën e Madhe (vis-à-vis me vendimin e Dhomës) dhe se ky ankim nuk përmbushte rregullin 6 mujor të paraqitjes së kërkesës sipas nenit 35 të Konventës.

Në lidhje me pjesën tjetër të ankimit, Dhoma e Madhe tha se çështja kishte të bënte me interpretimin dhe zbatimin e ligjit të brendshëm nga gjykatat vendase, të cilat refuzuan të njohin pronësinë e kërkuësve nga posedimi i pandërprerë. Gjykata vërejti se në radhë të parë ishte detyrë e autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave vendase, për të interpretuar dhe zbatuar ligjin e brendshëm, posaçërisht kur çështjet kanë të bëjnë me pyetje të vështira të lidhura me interpretimin e së drejtës vendase, siç është posedimi kundërt në këtë rast.

Dhoma e Madhe përsëriti se, në parim, nuk mund të thuhet se një kërkuës kishte një kërkesë të mjaftueshme të ngritur një pretendim mbi “pasuri” për qëllimet e nenit 1 të Protokollit Nr. 1, në rastet kur ekzistonte një mosmarrëveshje për interpretimin e saktë dhe zbatimin e së drejtës së brendshme; si edhe nëse pyetja nëse ai ose ajo nuk ishte në pajtim me kërkesat ligjore duhet të përcaktohej në proceset gjyqësore para gjykatave vendase. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se pretendimet e kërkuësve për t'u deklaruar pronarë të tokës në fjalë nuk kishin bazë të mjaftueshme në ligjin kombëtar për t'u kualifikuar si “posedime” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Në përfundim Dhoma e Madhe vendosi se Kroacia nuk kishte shkelur të drejtat e kërkuësve.

*Mladost Turist AD k. Kroacisë*¹²⁵ është një çështje tjetër lidhur me të drejtat e garantuara nga Konventa që kërkon vëmendjen tonë. Kompania kërkuëse u themelua në Beograd në vitin 1978 si një “organizatë e bashkuar”. Më 30 prill 1991, ajo u transformua sipas legjislacionit serb në një shoqëri tregtare (aksionare) aksionarët e së cilës ishin të gjithë individë privatë. Kompania kërkuëse pretendoi se gjatë periudhës socialiste kishte mbajtur të drejtën kuazi-pronësore mbi njëmbëdhjetë parcela toke në

124 *Radomilja dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 20 marsit 2018.

125 *Mladost Turist AD k. Kroacisë*, vendim i 22 shkurtit 2018.

pronësi të përbashkët të vendosura në Tisno (Kroaci), konkretisht të drejtën e përdorimit të asaj toke. Në atë kohë, parcelat në fjalë kishin formuar resortin e Fëmijëve dhe Rinisë “Beogradi”, të drejtuar nga kompania e kërkuesve.

Me një numër dekretesh të miratuara në periudhën prej 17 korrikut deri më 1 tetor 1991, qeveria e Kroacisë i ndaloi kompanitë ose personat e tjerë juridikë me seli në republikat e tjera të ish-Jugosllavisë-së të ndërmermin çfarëdo transaksioni që përfshinte pasuritë (përfshirë pronën e paluajtshme) që ndodheshin në Kroaci. Me dekretin e qeverisë kroate të datës 26 qershor 1992, i cili hyri në fuqi në të njëjtën ditë, të gjitha pasuritë e tilla në pronësi të personave juridikë me vendndodhje në Serbi apo Malin e Zi iu transferuan Shtetit. Më 8 qershor 1994, Gjykata Komunale në Šibenik regjistroi në regjistrin e tokës shtetin si pronar të parcelave të tokës objekt gjykimi. Me hyrjen në fuqi më 1 janar të vitit 1997 të Ligjit të Pronës, mbartësit e të drejtave kuazi-pronësore ekzistuese mbi pronën kolektive (të drejtat për administrimin, përdorimin dhe tjetërsimin e saj) u bënë pronarë të saj. Kjo nuk vlente për të drejtat të cilat ishin shuar përpara kësaj date, kryesisht në bazë të akteve të mëparshme legjislative, ku pronësia kolektive e disa llojeve të pronave (si banesa, toka bujqësore dhe objektet sportive) u transformua në pronësi private. Me një kontratë dhurimi të datës 18 prill 2001, shteti transferoi pronësinë e tokës në fjalë tek një shkollë fillore.

Më 2 qershor 2004, hyri në fuqi Marrëveshja mbi çështjet e trashëgimisë midis shteteve pasardhëse në RSFJ. Aneksi G i Marrëveshjes rregullonte çështje të pronës private dhe të drejtave të fituara. Neni 2 (1) i Aneksit G parashikonte se Shtetet Pasuese do të njihnin, mbronin dhe rivendosin të drejtat mbi pronën e paluajtshme të ndodhur në territorin e tyre, në të cilën qytetarët ose personat e tjerë juridikë të RSFJ kishin të drejta deri më 31 dhjetor 1990 dhe se kushdo që nuk është në gjendje për të gëzuar të drejtat e tilla, do të gëzonte të drejtën e kompensimit. Në vitin 2007, shoqëria kërkuese paraqiti një padi civile kundër shtetit dhe shkollës fillore në Gjykatën Komunale në Šibenik, duke kërkuar kthimin e tokës në fjalë. Ajo i referohej nenit 2 (1) të Aneksit G të Marrëveshjes. Pasi kërkesa u hodh poshtë nga gjykatat vendase në të gjitha nivelet, shoqëria kërkuese u ankua në GJEDNJ.

Gjykata vërejtí se Kroacia nuk kishte përfunduar asnjë marrëveshje dypalëshe ose nuk kishte miratuar asnjë legjislacion zbatues për të zbatuar nenin 2 të Aneksit G të Marrëveshjes së Suksesionit. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se as kërkesa e shoqërisë kërkuese për t’u deklaruar si pronare e tokës në fjalë dhe as kërkesa e saj për kompensim, nuk kishte bazë ligjore të mjaftueshme në të drejtën vendase, ose në marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e rendit të brendshëm ligjor, për tu konsideruar si një “pasuri” dhe për rrjedhojë “posedim” që mbrohet nga garancitë e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Gjykata pranoi kështu që kërkesa e shoqërisë ankuese nuk përputhej *ratione materiae* me dispozitat e Konventës, në kuptim të nenit 35.

Neni 4 i Protokollit Nr. 7 të Konventës – ne bis in idem

Gjatë vitit 2018 Gjykata dha gjashtë vendime të cilat deklaruan të pa papranueshme kërkesat kundër Kroacisë për shkelje të parimit *ne bis in idem*. Vendimi për çështjen *Seražin k. Kroacisë*¹²⁶ është pa dyshim më i rëndësishmi ndër to.

126 *Seražin k. Kroacisë*, vendim i 9 tetorit 2018.

Kërkesa u paraqit nga një mbështetës i Klubit të Futbollit “Dinamo i Zagrebit” dhe një anëtar i klubit tifoz “Bad Blue Boys”. Ishte konstatuar se, në raste të ndryshme, ai kishte qenë në shkelje të ligjit mbi Parandalimin e Trazirave Sportive. Më 8 gusht 2012, ai hodhi një kapsollë në stadiumin e Maksimir të Zagrebit gjatë ndeshjes Dinamo-Sheriff dhe e hodhi atë në fushë. Policia e dërgoi kërkuesin përpara gjykatës dhe paraqiti dy mocione kundër tij, një padi dhe një masë sigurie që e ndalonte kërkuesin të ndiqte të gjitha ndeshjet e futbollit. Po të njëjtën ditë, pas deklaratave të kërkuesit mbi kundërvajtjet, gjykata kompetente për shqyrtimin e kundravajtjeve dhe e dënoi atë me 25 ditë burgim i pezulluar për një vit. Për më tepër, në kuadrin e ligjit të posaçëm gjykata vendosi të ndalonte kërkuesin të ndiqte të gjitha ndeshjet e Dinamos në Kroaci dhe të gjitha ndeshjet që zhvilloheshin në stadiumin Maksimir për një periudhë njëvjeçare.

Kërkuesi u përfshi më pas në incidente të ngjashme dhe në konflikte me tifozët në Francë, Ukrainë dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Duke pasur parasysh incidentin e gushtit 2012, autoritetet përkatëse të policisë në prill 2013 kërkuan nga gjykata kompetente të vendoste një masë tjetër përjashtimi kundër kërkuesit. Ata shpjeguan se kërkuesi ishte regjistruar në bazën e të dhënave të huliganëve, si një huligan i kategorisë B në mbështetje ekstreme të Dinamos së Zagrebit dhe një anëtar i “Bad Blue Boys”, i cili ishte i prirur ndaj dhunës fizike, tashmë i ndjekur penalisht për prishje të qetësisë dhe rendit publik.

Më 3 prill 2014, gjykata vendase pranoi kërkesën e policisë dhe i ndaloi kërkuesit të mernte pjesë në të gjitha ndeshjet e futbollit të Dinamos së Zagrebit dhe të ekipit kombëtar kroat në Kroaci dhe jashtë vendit për një vit. Gjithashtu, ajo e urdhëroi që ai: 1) të raportojë në rajonin e policisë më të afërt vendbanimin e tij (ose kur ndodhet larg banesës së tij në rajonin më të afërt të policisë) dy orë para çdo ndeshjeje futbollit 2) të raportojë ku ndodhet kur zhvillohen ndeshjet e futbollit dhe dy orët pas përfundimit të tyre, dhe 3) të dorëzojë dokumentet e tij të udhëtimit në polici shtatë ditë përpara çdo kompecioni të rëndësishëm sportiv. Në apelimin e tij ndaj këtij vendimi dhe më pas në ankimin kushtetues, kërkuesi argumentoi në veçanti se dhënia e masës së dytë për vepra për të cilat ai ishte deklaruar një herë fajtor dhe dënuar, përbënin shkelje të parimit *ne bis in idem*. Pas rrëzimit të ankesave të tij nga gjykatat vendase, kërkuesi u ankua në GJEDNJ.

Gjykata konstatoi se veprat penale për të cilat kërkuesi ishte dënuar nga gjykatat vendase në bazë të ligjit të posaçëm, ishin vepra të vogla dhe për rrjedhojë, ishin nën fushëveprimin e një ndëshkimi penal në kuptim të Konventës.

Kur shqyrtoi karakterin e masave mbrojtëse dhe parandaluese të vendosura ndaj kërkuesit, Gjykata vuri në dukje se këto dy masa të veçanta nuk ishin drejtpërdrejt të varura nga njëra-tjetra. Më konkretisht, masa që ndalonte kërkuesin të ndiqte ndeshjet nuk ishte një pasojë e drejtpërdrejtë e dënimit të tij për një kundërvajtje. Masa parandaluese u imponua në procesin administrativ dhe kishte për qëllim kryesisht mbrojtjen e një numri më të madh të njerëzve, respektivisht spektatorëve dhe jo dënimin shtesë të kërkuesit. Duke qenë se qëllimi i masës parandaluese nuk është që të ndëshkojë personat për të cilët është dhënë, nuk mund të konsiderohet një ndëshkim me karakter penal. Kështu, Gjykata nuk konsideroi se aplikimi i masës së përjashtimit përfshinte përcaktimin e një “akuze penale” dhe arriti në përfundimin se neni 4 i Protokollit nr. 7 të Konventës nuk zbatohet në rastin në fjalë. Për rrjedhojë ankimi i kërkuesit ishte pa bazuar *ratione materiae* me dispozitat e Konventës.

MALI I ZI

Hyrje

Mali i Zi ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore (më poshtë e quajtur: “Konventa”) më 6 qershor 2006. Megjithatë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më poshtë e quajtur: “Gjykata”) gjeti në çështjen *Bijelić k. Malit të Zi dhe Serbisë*, se përgjegjësia që i takon Malit të Zi është e vlefshme duke filluar prej datës 3 mars 2004, datë e ratifikimit të Konventës nga ish-Federata Serbo-Malazeze.

Deri më 31 dhjetor 2018 Gjykata ka dhënë 50 vendime themeli dhe 60 vendime mbi pranueshmërinë në lidhje me Malin e Zi. Gjykata gjeti shkelje të së paku një neni të Konventës në 47 nga 50 vendimet e themelit. 34 nga këto çështje u gjykuan nga Dhoma prej 7 gjyqtarësh dhe 16 nga Komiteti me 3 gjyqtarë. Ndërkohë, 21 nga vendimet mbi pranueshmërinë u vendosën nga një Dhomë dhe pjesa tjetër nga Komiteti.

Një numër i madh vendimesh kundër Malit të Zi kanë përfshirë nenin 6, të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në vendimin e saj në çështjen *Tomić dhe të Tjerët k. Malit të Zi*¹²⁷, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 6, duke përmbyllur se nuk ishte roli i saj të vinte në dyshim interpretimin e ligjit të brendshëm nga gjykatat kombëtare, se në parim nuk ishte funksioni i saj të krahasonte vendime të gjykatave kombëtare, edhe pse ato mund të jepen në procedura dukshëm të ngjashme, dhe se duhet të respektonte pavarësinë e gjykatave. Gjithashtu, u shpreh se disa diferenca në interpretim mund të pranoheshin si një tipar i natyrshëm i çdo sistemi gjyqësor, por diferencat e thella dhe të qëndrueshme në praktikën e gjykatës më të lartë, mund të jenë të kundërta me parimin e sigurisë juridike, një parim që nënkuptohet nga Konventa dhe që përbën një nga elementët më bazikë të shtetit të së drejtës.

Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 6(1) të Konventës në çështjen *Vujović k. Malit të Zi*¹²⁸. Gjykata u shpreh se kërkuesi kishte kontribuar negativisht në kohëzgjatjen e procedurave për thujtse 7 muaj, duke mos u paraqitur në dy seancat kryesore. Gjykata rrjedhimisht përmbylli se pjesa e mbetur prej pothuajse 6 vitesh në 3 nivele të juridiksionit, nuk mund të konsiderohet si e tepruar ose e zgjatur në mënyrë të paarsyeshme.

Gjykata nuk gjeti shkelje të Konventës në çështjen *Petrović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*¹²⁹, duke përmbyllur se gjykatat kombëtare kishin dhënë në vendimet e tyre arsye specifike dhe të qarta për pushimin e pretendimit të kërkuesve dhe se Mali i Zi nuk kishte shkelur nenin 6(1) të Konventës.

Gjykata mori vendim për një çështje në të cilën pretendohesh shkelje e së drejtës së jetës, sipas nenit 2 të Konventës, nga ana e Malit të Zi. Në çështjen *Randelović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*¹³⁰, Gjykata theksoi se detyrimi që përmban neni 2 për të mbrojtur të drejtën e jetës imponon një detyrim procedural për Shtetin për të hetuar vdekjet, jo vetëm kur ndodhin për shkak të agjentëve të shtetit, por edhe për shkak të personave privatë ose të panjohur dhe se qëllimi kryesor i një hetimi ishte “të siguronte

127 *Tomić dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 17 prillit 2012.

128 *Vujović k. Malit të Zi*, vendim i 15 majit 2018.

129 *Petrović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 17 korrikut 2018.

130 *Randelović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 19 shtatorit 2017.

zbatimin efektiv të ligjeve vendase që mbrojnë të drejtën e jetës” dhe të siguronte llogaridhënien e personave përgjegjës.

Gjykata dha vendime për 3 çështjet e mëposhtme kundër Malit të Zi me pretendim shkelje të nenit 3 (ndalimi i torturës): *Bulatović k. Malit të Zi, Milić dhe Nikezić k. Malit të Zi dhe Siništaj dhe të Tjerët k. Malit të Zi*¹³¹.

Gjykata dha vendime mbi 2 çështjet e mëposhtme kundër Malit të Zi, në të cilat pretendohet për shkelje të nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri): *Bulatović k. Malit të Zi dhe Mugoša k. Malit të Zi*¹³².

Siç është përmendur më sipër, shumë gjykime lidhen me nenin 6 dhe Gjykata konstatoi se Mali i Zi kishte shkelur këtë nen në shumicën e vendimeve (34 nga 50)¹³³. Këto shkelje lidheshin me kohëzgjatjen e procedurave, zbatimin e vendimeve përfundimtare të gjykatave vendase dhe aksesin në gjykata.

Gjykata dha vendime në 4 çështjet e mëposhtme kundër Malit të Zi, në të cilat pretendohet për shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare): *Mijušković k. Malit të Zi, Antović dhe Mirković k. Malit të Zi, Alković k. Malit të Zi dhe Milićević k. Malit të Zi*¹³⁴.

Gjykata vendosi për 6 çështjet e mëposhtme kundër Malit të Zi, në të cilat pretendohet se Mali i Zi kishte shkelur nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës: *Mijanović k. Malit të Zi, A. dhe B. K. Malit të Zi, Bijelić k. Malit të Zi, Lakićević k. Malit të Zi, Kešelj dhe të Tjerët k. Malit të Zi dhe KIPS DOO dhe Drekalović k. Malit të Zi*¹³⁵.

Gjykata gjeti Malin e Zi në shkelje të nenit 10 të Konventës, i cili mbron lirinë e shprehjes në dy vendime: *Koprivica k. Malit të Zi dhe Šabanović k. Malit të Zi*.¹³⁶

131 *Bulatović k. Malit të Zi*, vendim i 22 korrikut 2014; *Milić dhe Nikezić k. Malit të Zi*, vendim i 28 prillit 2015; *Siništaj dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 24 nëntorit 2015.

132 *Mugoša k. Malit të Zi*, vendim i 21 qershorit 2016.

133 *Bijelić k. Malit të Zi dhe Serbisë*, vendim i, 28 prillit 2009; *Garzić k. Malit të Zi*, vendim i 21 shtatorit 2010; *Živaljević k. Malit të Zi*, vendim i 8 marsit 2011; *Barać dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 13 dhjetorit 2011; *Boucke k. Malit të Zi*, vendim i 21 shkurtit 2012; *Stakić k. Malit të Zi*, vendim i 2 tetorit 2012; *Novović k. Malit të Zi*, vendim i, 23 tetorit 2012; *Milić k. Malit të Zi dhe Serbisë*, vendim i 11 dhjetorit 2012; *Velimirović k. Malit të Zi*, vendim i 2 tetorit 2012; *Vukelić k. Malit të Zi*, vendim i 4 qershorit 2013; *Mijanović k. Malit të Zi*, vendim i 17 shtatorit 2013; *Bujković k. Malit të Zi*, vendim i 10 marsit 2015; *Mugoša k. Malit të Zi*, vendim i 21 qershorit 2016; *Radunović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 25 tetorit 2016; *Stanka Mirković dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 7 marsit 2017; *Đuković k. Malit të Zi*, vendim i 13 qershorit 2017; *Svorčan k. Malit të Zi*, vendim i 13 qershorit 2017; *Tomašević k. Malit të Zi*, vendim i 13 qershorit 2017; *Jovović k. Malit të Zi*, vendim i 18 korrikut 2017; *Sineks d.o.o k. Malit të Zi*, vendim i 5 shtatorit 2017; *Vučinić k. Malit të Zi*, vendim i 5 shtatorit 2017; *Nedić k. Malit të Zi*, vendim i 10 tetorit 2017; *Tripčević k. Malit të Zi*, vendim i 7 nëntorit 2017; *Dimitrijević k. Malit të Zi*, vendim i 12 dhjetorit 2017; *Brajović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 30 janarit 2018; *Kešelj dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 13 shkurtit 2018; *Vujović dhe Lipa D.O.O k. Malit të Zi*, vendim i 20 shkurtit 2018; *Rajak k. Malit të Zi*, vendim i 27 shkurtit 2018; *Montemlin Šajo k. Malit të Zi*, vendim i 20 marsit 2018; *Novaković k. Malit të Zi*, vendim i 20 marsit 2018; *Arčon dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 3 prillit 2018; *Jasavić k. Malit të Zi*, vendim i 19 qershorit 2018; *Kips DOO dhe Drekalović k. Malit të Zi*, vendim i 26 qershorit 2018; dhe *Lekić k. Malit të Zi*, vendim i 9 tetorit 2018.

134 *Mijušković k. Malit të Zi*, vendim i 21 shtatorit 2010; *Antović dhe Mirković k. Malit të Zi*, vendim i 28 nëntorit 2017; *Alković k. Malit të Zi*, vendim i 5 dhjetorit 2017; *Milićević k. Malit të Zi*, vendim i 6 nëntorit 2018.

135 *Mijanović k. Malit të Zi*, vendim i 17 shtatorit 2013; *A. dhe B. k. Malit të Zi*, vendim i 5 marsit 2013; *Bijelić k. Malit të Zi dhe Serbisë*, vendim i 28 prillit 2009; dhe *Lakićević dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 21 shtatorit 2010; *Kešelj dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 13 shkurtit 2018; dhe *Kips DOO dhe Drekalović k. Malit të Zi*, vendim i 26 qershorit 2018.

136 *Koprivica k. Malit të Zi*, vendim i 22 nëntorit 2011; *Šabanović k. Malit të Zi*, vendim i 31 majit 2011.

Gjithashtu, Gjykata gjeti Malin e Zi në shkelje të nenit 13 të Konventës (e drejta për një zgjidhje efektive) në 5 çështjet e mëposhtme: *Milić k. Malit të Zi dhe Serbisë*, *Stakić k. Malit të Zi*, *Mirković dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, *Đuković k. Malit të Zi dhe Sinex D.O.O. k. Malit të Zi*.¹³⁷

Gjykata gjeti Malin e Zi në shkelje të nenit 14 të Konventës (ndalimi i diskriminimit) në një rast: *Alković k. Malit të Zi*.¹³⁸

Vetëm në lidhje me një rast Mali i Zi ka pasur një vendim të veçantë sa i takon përcaktimit të shpërblimit të drejtë – *Koprivica k. Malit të Zi*.¹³⁹

Vendime 2018

Gjatë vitit 2018, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka dhënë 23 vendime ndaj Malit të Zi. Gjykata ka dhënë 13 vendime themeli dhe 10 vendime mbi pranueshmërinë.

Pesë vendimet në vijim janë gjykuar nga një Dhomë prej shtatë gjyqtarësh: *Brajović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, *Vujović dhe Lipa k. Malit të Zi*, *Petrović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, *Kips D.O.O. dhe Drekalović k. Malit të Zi dhe Milićević k. Malit të Zi*.¹⁴⁰

Tetë vendimet e tjera - *Kešelj dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, *Rajak k. Malit të Zi*, *Montemlin Šajo k. Malit të Zi*, *Novaković k. Malit të Zi*, *Arčon dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, *Vujović k. Malit të Zi*, *Jasavić k. Malit të Zi* dhe *Lekić k. Malit të Zi*.¹⁴¹ - janë gjykuar nga një Komitet prej tre gjyqtarësh.

Në 2018, Gjykata nuk gjeti shkelje të KEDNJ-së në dy raste kundër Malit të Zi - *Vujović k. Malit të Zi* dhe *Petrović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*.¹⁴²

Në 2018, Gjykata mori dhjetë vendime duke i shpallur kërkesat kundër Malit të Zi si të papranueshme. Një vendim i tillë në rastin e *Ivanović dhe Daily press k. Malit të Zi*, u gjykua nga një Dhomë e përbërë prej shtatë gjyqtarësh, ndërkohë që nëntë vendimet e tjera - në rastet e *Bulatović k. Malit të Zi*, *Srdanović k. Malit të Zi*, *Backović k. Malit të Zi*, *Zogović k. Malit të Zi*, *Šikmanović k. Malit të Zi*, *Bakić k. Malit të Zi*, *Vujisić k. Malit të Zi*, *Bogojević k. Malit të Zi* dhe *Romanjoli k. Malit të Zi* - u gjykuan nga një Komitet prej tre gjyqtarësh.

137 *Milić k. Malit të Zi dhe Serbisë*, vendim i 11 dhjetor 2012; *Stakić k. Malit të Zi*, vendim i 2 tetorit 2012; *Đuković k. Malit të Zi*, vendim i 13 qershorit 2017; *Stanka Mirković dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 7 marsit 2017; *Sineks D.O.O. k. Malit të Zi*, vendim i 5 shtatorit 2017.

138 *Alković k. Malit të Zi*, vendim i 5 dhjetorit 2017

139 *Koprivica k. Malit të Zi*, vendim i 23 qershorit 2015.

140 *Brajović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 30 janarit 2018; *Vujović dhe Lipa D.O.O. k. Malit të Zi*, vendim i 20 shkurtit 2018; *Kips D.O.O. dhe Drekalović k. Malit të Zi*, vendim i 26 qershorit 2018 dhe *Milićević k. Malit të Zi*, vendim i 6 nëntorit 2018.

141 *Kešelj dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 13 shkurtit 2018; *Rajak k. Malit të Zi*, vendim i 27 shkurtit 2018; *Montemlin Šajo k. Malit të Zi*, vendim i 20 marsit 2018; *Novaković k. Malit të Zi*, vendim i 20 marsit 2018; *Arčon dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 3 prillit 2018; *Jasavić k. Malit të Zi*, vendim i 19 qershorit 2018 dhe *Lekić k. Malit të Zi*, vendim i 9 tetorit 2018.

142 *Vujović k. Malit të Zi*, vendim i 15 majit 2018 dhe *Petrović dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 17 korrikut 2018.

Brajović dhe të Tjerët k. Malit të Zi, vendim i 30 janarit 2018, shkelje e nenit 6(1) (e drejta e aksesit në gjykatë)

Kërkuesit ishin shtetas malazezë, të cilët kishin ndërhyrë si palë e dëmtuar në procesin penal kundër X. Ata u ankuan se iu ishte mohuar e drejta e aksesit në gjykatë në kundërshtim me nenin 6 të Konventës, sepse Gjykata e Apelit nuk kishte vendosur mbi ankimin e tyre në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Gjykata solli në vëmendje parimin se neni 6(1) “i siguron të gjithëve të drejtën për të ngritur kërkesa në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile të sjella përpara një gjykate”. Gjithashtu, Gjykata vërejti se kjo “e drejtë për t`ju drejtuar gjykatës”, në të cilën e drejta e aksesit është një aspekt, mund të përdoret nga të gjithë ata që besojnë mbi bazë argumentesh se ka ndodhur një ndërhyrje e paligjshme në ushtrimin e të drejtave të tyre civile, dhe që nuk patën asnjë mundësi për ta paraqitur këtë kërkesë përballë një gjykate që plotëson kushtet e parashikuara në nenin 6 (1) të Konventës. Gjykata e Strasburgut theksoi se e drejta për t`ju drejtuar një gjykate përfshin jo vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të marrë një vendim gjyqësor mbi një mosmarrëveshje.

Në përfundim, Gjykata përsëriti, se megjithëse neni 6(1) nuk i detyron shtetet të ngrenë gjykata apeli apo kasacioni, ato shtete që kanë themeluar gjykata të tilla, janë të detyruara të sigurojnë që subjektet e legjitimuar sipas ligjit, të gëzojnë përpara tyre garancitë themelore që përmban neni 6 i Konventës.

Në këtë çështje Gjykata konsideroi se kërkuesve iu ishte mohuar efektivisht e drejta për të adresuar kërkesat e tyre civile nga një gjykatë në kuptim të nenit 6(1), duke gjetur kështu shkelje të këtij neni.

KIPS DOO dhe Drekalović k. Malit të Zi, vendim i 26 qershorit 2018, shkelje e nenit 6(1) (e drejta për një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm) dhe nenit 13 të Konventës (e drejta për një zgjidhje efektive) dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës (mbrojtja e pronës).

Aplikimi u paraqit nga KIPS DOO, një kompani me seli në Podgoricë dhe themeluesi i saj, Drejtori Ekzekutiv dhe pronari Risto Drekalović. Çështja ka të bëjë me refuzimin e autoriteteve për të lëshuar një leje ndërtimi për kërkuesit, me qëllim ndërtimin e një qendre tregtare. Gjithashtu, kërkuesit u ankuan për kohëzgjatjen e procedurave administrative lidhur me përfundimin e zonës urbane dhe kohëzgjatjen e procedurave të ekzekutimit të vendimit, si edhe mungesën e një mjeti efektiv të brendshëm në këtë drejtim.

Gjykata risolli në vëmendje parimin e saj se paraqitja e përsëritur e një tipologjie çështjeje mundet në vetvete të zbulojë një mangësi serioze në sistemin gjyqësor të një shteti.

Duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në jurisprudencën e saj dhe faktet relevante të çështjes në fjalë, Gjykata vërejti se kohëzgjatja e procedurave së ankimuara nuk përmbushte kërkesat e një afati të arsyeshëm kohor dhe në këtë mënyrë kishte shkelje të nenit 6(1) të Konventës. Procedimet në fjalë filluan më 15 gusht 2005, kur kërkuesit parashtruan ankimin e tyre administrativ dhe më 23 qershor 2017, kur kërkuesi i parë ngriti një padi administrative. Në dijeni të Gjykatës, ata ende ishin në pritje në kohën kur çështja gjykohej në Strasburg, duke rezultuar kështu se procesi kishte vazhduar për më shumë se 11 vjet e 10 muaj, periudhë gjatë së cilës organet vendase e kthyen çështjen shtatë herë.

Gjykata gjeti shkelje të nenit 13 të Konventës marrë së bashku me nenin 6(1), në lidhje me mungesën e një mjeti ligjor efektiv në të drejtën e brendshme për të adresuar ankimin e kërkuarve për kohëzgjatje të proceseve jashtë afatit të arsyeshëm sa i takon përfundimit të planifikimit urban.

Gjithashtu, Gjykata vërejti se Shtetet Palë duhet të gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me zhvillimet dhe planifikimin urban, me qëllim që të zbatojnë politikën e tyre të planifikimit urban në nivel qyteti dhe shteti.

Gjykata vazhdoi më tej duke theksuar se pasiguria – qoftë ajo legislative, administrative ose që rrjedh nga praktikën e zbatuar nga autoritetet vendase – është një faktor që duhet marrë parasysh gjatë vlerësimit të sjelljes së shtetit edhe kur një çështje në interes të publikut është duke u diskutuar. Është detyrë e autoriteteve publike të veprojnë në kohën e duhur, në një mënyrë të përshtatshme dhe konsistente dhe se hapësira e vlerësimit që autoritetet kanë nuk i shkarkon ata në asnjë mënyrë nga ato detyrime.

Në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata gjeti një ndërhyrje në të drejtën e kërkuarve për të gëzuar lirisht pronën e tyre, ndërhyrje kjo e cila nuk ishte proporcionale duke marrë në konsideratë faktin se shteti i paditur kish dështuar që të vepronte në një kohë dhe mënyrë të arsyeshme e konsistente, duke bërë të pamundur faktin që kërkuarët të plotësonin kushtet e kërkuara për të përfituar lejen e ndërtimit.

Gjykata u shpreh se kërkuarët ishin përballur me pasigurinë që rrodhi nga praktikën e zbatuar nga autoritetet, të pasqyruara në ndryshimin e vazhdueshëm të planeve urbanistike të hollësishme, duke futur kushte të reja, të tilla si blerja e një ngastre kadastrale shtesë të tokës me qëllim të “plotësohej” kuadri i ri urban i sapokrijuar, duke refuzuar në mënyrë të paligjshme për të llogaritur penalitetet përkatëse.

Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arriti në përfundimin se pavarësisht hapësirës së vlerësimit që gëzon shteti, në çështjen konkrete nuk ishte ruajtur balanca e drejtë dhe kërkuarët iu ishte ngarkuar një barrë individuale e tepruar, në shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

Milićević k. Malit të Zi, vendim i 6 nëntorit 2018, shkelje e nenit 8 të Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)

Kërkuarët u ankua në Gjykatë në lidhje me nenin 2 të Konventës se autoritetet shtetërore, pavarësisht se ishin në dijeni, kishin dështuar të merrnin masa parandaluese për ta mbrojtur atë nga sulmi i një personi me probleme të shëndetit mendor (X).

Gjykata theksoi edhe një herë se koncepti i jetës private në kuptim të nenit 8 të Konventës përfshin integritetin fizik dhe psikik të një personi. Më tej, ajo vërejti se objekti thelbësor i nenit 8 është mbrojtja e individit kundër ndërhyrjes arbitrare të autoriteteve publike. Gjithashtu, mund të lindin detyrime pozitive të qenësishme në lidhje me respektimin efektiv të jetës private të individëve, duke përfshirë këtu miratimin e masave në sferën e marrëdhënieve ndërmjet individëve privatë. Për këtë qëllim, shtetet duhet të mbajnë dhe zbatojnë në praktikë një kuadër ligjor adekuat, që ofron mbrojtje nga aktet e dhunës mes individëve privatë.

Gjykata përsëriti se detyra e saj nuk është të zëvendësojë autoritetet vendase në përcaktimin e metodave më të përshtatshme për mbrojtjen e individëve nga sulmet ndaj integritetit të tyre personal,

por për të shqyrtuar në kuadër të Konventës vendimet që këto autoritete kanë marrë gjatë ushtrimit të hapësirës së tyre të vlerësimit.

Gjykata konkludoi se mungesa e marrjes së masave të mjaftueshme nga autoritetet në reagim ndaj sjelljes së X, përbënte një shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit sipas nenit 8 të Konventës.

Vujović dhe Lipa DOO k. Malit të Zi, vendim i 20 shkurtit 2018, shkelje e nenit 6(1) (e drejta e aksesit në gjykatë)

Kjo çështje ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së kërkuesve për akses në gjykatë, për shkak se Gjykata e Apelit refuzoi të shqyrtojë themelin e ankimit që bëri kërkuesi i dytë për fillimin e procedurave të falimentit.

Gjykata vuri në dukje se dispozitat e Ligjit të Falimentimit, në fuqi në kohën kur ndodhën ngjarjet, parashikonin se sapo të hapeshin procedurat e falimentimit, të gjitha të drejtat në lidhje me përfaqësimin e kompanisë u transferuan tek administratori i falimentimit dhe ai përfaqësonte debitorin. Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit nuk mund të ishin ankuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë të pavarur kundër vendimit që i prekte ato drejtpërsëdrejti, por vetëm nëpërmjet administratorit të caktuar për procedurën e falimentimit, për rrjedhojë Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 (1) të Konventës.

Vendimet mbi pranueshmërinë

Ivanović dhe Daily Press k. Malit të Zi, vendim i 28 qershorit 2018, i deklaruar i papranueshëm

Kërkuesit pretendonin një shkelje të lirisë së tyre të shprehjes garantuar nga neni 10 si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë. Kërkuesit ishin urdhëruar të paguanin dëme për ish-kryeministrin Milo Đukanović për një seri artikujsh që ata kishin botuar, në përgjigje të një sulmi ndaj kërkuesit të parë, në të cilin ata e përshkruan Đukanović dhe familjen e tij si kriminelë. Gjykata arriti në përfundimin se këto vendime kishin ndërhyrë në lirinë e shprehjes së ankuesve dhe se duhej të shqyrtohej nëse “ndërhyrja” ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Pra, nëse vendimet ishin proporcionale dhe ndiqeshin nga një qëllim legjitim. Pretendimet e kërkuesve ishin shumë serioze dhe Gjykata u mbështet në parimin e përgjithshëm të shtjelluar në jurisprudencën e saj - se sa më serioze të jetë akuza, aq më e fortë duhet të jetë baza faktike. Megjithatë, Gjykata vërejtë se kërkuesit nuk kishin provuar vërtetësinë apo besueshmërinë e pretendimeve të tyre.

Gjykata theksoi se, fakti i akuzimit të drejtpërdrejtë të individëve të caktuar duke përmendur emrat dhe pozicionet e tyre, kishte vënë kërkuesit në një detyrim për të ofruar një bazë faktike të mjaftueshme për pohimet e tyre. Gjykata konstatoi se konkluzionet e arritura nga Gjykata e Lartë në bazë të testit të balancës nuk mund të konsideroheshin si të paarsyeshme dhe rrjedhimisht që, arsyet e paraqitura nga gjykatat vendase për urdhërimin e kërkuesve për të paguar dëmet ndaj paditësit ishin “relevante dhe të mjaftueshme” brenda kuptimit të jurisprudencës së saj. Për rrjedhojë, Gjykata nuk gjeti asnjë arsye për të zëvendësuar vendimin përfundimtar të Gjykatës së Lartë.

Gjykata konsideroi se dëmi nuk ishte i tepruar, se gjoba ishte dhënë kundër të dy kërkuesve së bashku dhe se gjykata e shkallës së parë kishte marrë parasysh se gazeta e përditshme botuar nga kërkuesi i dytë kishte një tirazh të lartë. Për këto arsye, Gjykata arriti në përfundimin se vendimet e

gjykatave të brendshme ishin në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, ku theksohet se në penaltetet që jepen në lidhje me shpifjen duhet të mbahet gjithmonë në vëmendje një raport i arsyeshëm proporcionaliteti me pasojën e ardhur. Gjykata konkludoi se ankimi i kërkuesve ishte qartazi i pabazuar dhe duhej rrëzuar në bazë të nenit 35 (3) (a) dhe 4) të Konventës.

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Hyrje

Që nga 10 prilli i vitit 1997, koha kur ky Shtet ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa” ose “KEDNJ”), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“Gjykata” ose “GJEDNJ”) ka dhënë 153 vendime themeli dhe 450 vendime pranueshmërie/nxjerrje jashtë nga lista e gjykimeve kundër Maqedonisë, prej të cilave 12 vendime themeli dhe 24 vendime pranueshmërie janë dhënë gjatë vitit 2018.¹⁴³ Nga këto vendime, 134 janë shqyrtuar nga Dhoma, 17 nga një Komitet të ashtuquajtura raste “të përsëritura” ose çështje të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës dhe 2 nga Dhoma e Madhe. Lidhur me vendimet e pranueshmërisë, për 186 raste u dhanë vendime nga një Dhomë dhe në 264 raste nga një Komitet.

Në lidhje me nenin 6 të Konventës, e drejta për një proces të rregullt, janë dhënë 108 vendime ku janë gjetur shkelje në 102 raste. Këto raste kishin të bënin kryesisht me kohëzgjatjen e proceseve dhe mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjykata vërejti se përpara se të çonin një çështje para saj, kërkesit fillimisht duhet të parashtronin kërkesën përpara Gjykatës së Lartë, e cila konsiderohej të ishte një mjet efektiv¹⁴⁴ edhe kur kompensimi ishte i papërshtatshëm.¹⁴⁵ Në mjaft raste civile janë ngritur në diskutim çështje që kanë pasur të bëjnë me paanësinë,¹⁴⁶ parimin e barazisë së armëve,¹⁴⁷ mungesën e sigurisë gjyqësore dhe përputhjen me jurisprudencën,¹⁴⁸ mungesën e arsytimit,¹⁴⁹ të drejtën për të aksesuar gjykatën,¹⁵⁰ dhe të drejtën për një seancë dëgjimore.¹⁵¹ Nga ana tjetër, prezumimi i pafajësisë,¹⁵² parimi i barazisë së armëve dhe përdorimi i provave të marra nga dëshmitarët e marrë në mbrojtje ose

143 Lista e vendimeve përfshin *Stavropegic Monastery of Saint John Chrysostom k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntor 2018; *Church of Real Orthodox Christians dhe Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntor 2018; *Makraduli k. Maqedonisë*, vendim i 19 korrikut 2018; *Smičkovski k. Maqedonisë*, vendim i 5 korrikut 2018; *Euromak Metal DOO k. Maqedonisë*, vendim i 14 qershorit 2018; *Sejdiji k. Maqedonisë*, vendim i 7 qershorit 2018; *Ljatifi k. Maqedonisë*, vendim i 17 majit 2018; *Bektashi Community dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 12 prillit 2018; *Selami dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 1 marsit 2018; *Ramkovski k. Maqedonisë*, vendim i 8 shkurtit 2018; *Asani k. Maqedonisë*, vendim i 1 shkurtit 2018; *Taseva Petrovska k. Maqedonisë*, vendim i 11 janarit 2018.

144 *Adži-Spirkoska dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës i 3 nëntor 2011.

145 *Petrović k. Maqedonisë*, vendim i 22 qershorit 2017.

146 *Mitrov k. Maqedonisë*, vendim i 2 qershorit 2016; *Mitrinovski k. Maqedonisë*, vendim i 30 prillit 2015; *Bajaldžiev k. Maqedonisë*, vendim i 25 tetorit 2011; *Nikolov k. Maqedonisë*, vendim i 20 dhjetorit 2007.

147 *Taseva Petrovska k. Maqedonisë*, vendim i 11 janarit 2018; *Naumoski k. Maqedonisë*, vendim i 27 nëntor 2012; *Grozdanovski k. Maqedonisë*, vendim i 31 majit 2007.

148 *Krstanovski dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017; *Stoilkovska k. Maqedonisë*, vendim i 18 korrikut 2013.

149 *Atanasovski k. Maqedonisë*, vendim i 14 janarit 2010.

150 *Centre for the Development of Analytical Psychology k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017; *Balažoski k. Maqedonisë*, vendim i 25 prillit 2013; *Spasovski k. Maqedonisë*, vendim i 10 qershorit 2010; *Demerdžieva dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 10 qershorit 2010; *Boris Stojanovski k. Maqedonisë*, vendim i 6 majit 2010; *Petkoski dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 8 janarit 2008; *Fetaovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 qershorit 2008. No violation in this regard was established only in *Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016.

151 *Selmani dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 9 shkurtit 2017; *Mitkova k. Maqedonisë*, vendim i 15 tetorit 2015.

152 No violations in this respect were found in *Ramkovski k. Maqedonisë*, vendim i 8 shkurtit 2018; *Poletan dhe Azirovik k. Maqedonisë*, vendim i 12 majit 2016; *Miladinov dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014.

anonim,¹⁵³ prania e të pandehurit në gjykim,¹⁵⁴ vlerësimi i opinioneve të ekspertit,¹⁵⁵ pranueshmëria e provave të marra në mënyrë të paligjshme,¹⁵⁶ përdorimi *agent provocateur*¹⁵⁷ dhe e drejta për përthyes¹⁵⁸ u shqyrtuan në mjaft çështje penale para GJEDNJ-së.

Nga 19 vendime të dhëna në lidhje me nenin 1 Protokollin nr. 1, mbrojtja e pronës, në 8 prej tyre u konstatua shkelje për sa i përket mohimit të së drejtës për rikthimin e pronës, një toke të konfiskuar, edhe pse ata përmbushnin kriteret ligjore,¹⁵⁹ shpërblim i pamjaftueshëm për shpronësimin e tokës së kërkuesve në favor të një kompanie private,¹⁶⁰ dhe konfiskimi i automjeteve që shërbyen si mjete për kryerjen e veprës penale.¹⁶¹ Prishja e jashtëzakonshme e vendimit përfundimtar të kthimit, e cila synonte të korrigjonte “qartazi mosveprimin” e organeve administrative, nuk përbënte shkelje në rastin në fjalë.¹⁶²

Gjykata dha 4 vendime në lidhje me nenin 2, të drejtën për jetën,¹⁶³ duke konstatuar shkelje edhe pse rasti në fjalë nuk kishte pasur si pasojë vdekjen, por vetëm dëmtime të shkaktuara nga ana e një oficeri policie.¹⁶⁴ Asnjë shkelje nuk u konstatua në rastin ku veprimet apo mosveprimet e atyre që dyshohej se ishin përfshirë në mosraportimin e një krimi, që rezultoi në vdekjen e djalit të kërkuesit, i cili u vra nga një pjesëtar i forcave speciale të policisë.¹⁶⁵ Vonesa prej 18 muajsh në ekzekutimin e dënimit me burgim të autorit të krimit, ishte konsideruar si pjesë përbërëse e detyrimit procedural të shtetit sipas nenit 2.¹⁶⁶

153 *Asani k. Maqedonisë*, vendim i 1 shkurtit 2018; *Dončev dhe Burgov k. Maqedonisë*, vendim i 12 qershorit 2014; *Iljazi k. Maqedonisë*, vendim i 3 tetorit 2013; *Papadakis k. Maqedonisë*, vendim i 26 shkurtit 2013; *Trampevski k. Maqedonisë*, vendim i 10 korrikut 2012; *Atanasov (II) k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2011; *Solakov k. Maqedonisë*, vendim i 31 tetorit 2001.

154 *Eftimov k. Maqedonisë*, vendim i 2 korrikut 2015; *Atanasov k. Maqedonisë*, vendim i 17 shkurtit 2011; *Nasteska k. Maqedonisë*, vendim i 27 majit 2010; *Mitrevski k. Maqedonisë*, vendim i 21 qershorit 2006.

155 *Duško Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014; *Stoimenov k. Maqedonisë*, vendim i 5 prillit 2007.

156 *Hajrulahu k. Maqedonisë*, vendim i 29 tetorit 2015.

157 *Gorgievski k. Maqedonisë*, vendim i 16 korrikut 2009.

158 Asnjë shkelje nuk u gjet në *Sandel k. Maqedonisë*, vendim i 27 majit 2010.

159 *Stojanovski dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 23 tetorit 2014.

160 *Arsovski k. Maqedonisë*, vendim i 15 janarit 2013.

161 *Vasilevski k. Maqedonisë*, vendim i 28 prillit 2016; *Andonoski k. Maqedonisë*, vendim i 17 shtatorit 2015. Asnjë shkelje nuk u gjet në *Sulejmani k. Maqedonisë*, vendim i 28 prillit 2016.

162 *Spiridonovska dhe Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 tetorit 2017; *Toleski k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017; *Vikentijević k. Maqedonisë*, vendim i 6 shkurtit 2014.

163 *Kitanovska Stanojković dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 13 tetorit 2016; *Neškoska k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016; *Kitanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 janarit 2015; *Sašo Gorgiev k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2012.

164 *Sašo Gorgiev k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2012.

165 *Neškoska k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016.

166 *Kitanovska Stanojković dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 13 tetorit 2016.

Në 11 nga 12 vendimet e nenit 3, ndalimi i torturës, Gjykata gjeti shkelje në aspektin procedural.¹⁶⁷ Përveç *El-Masri*, tek rasti *Hajrulahu*, Gjykata e cilësoi trajtimin në fjalë si torturë, për sa kohë që kërkuesi u kërcënua me qëllim dhënien e deklaratave, të cilat i shkaktuan atij dhimbje, vuajtje emocionale, psikologjike dhe fizike.¹⁶⁸ Në mjaft raste¹⁶⁹, Gjykata theksoi se ishte formaliteti i tepruar të kërkohet se viktimat që pretendonin shkeljet nuk ishin të detyruar të ndiqnin ecurinë e ndjekjes penale ndaj agjentëve shtetërorë, e cila është më tepër një detyrë e prokurorit, si edhe këmbëngulja e kërkuesit për të zbuluar identitetin e të gjithë oficerëve të policisë kundër të cilëve ai ngriti akuza penale, konsiderohej si formalizëm i tepruar.¹⁷⁰

Lënia e prangave një kërkueseje me aftësi të kufizuara mendore gjatë transferimit të saj në spital përbënte trajtim poshtërues që derivonte në shkelje të aspektit material të nenit 3.¹⁷¹

Shkelje u konstatuan po ashtu në 10 vendime lidhur me nenin 5, e drejta për liri dhe siguri.¹⁷² Vendimi i Dhomës së Madhe në rastin *El-Masri k. Maqedonisë*,¹⁷³ kishte të bënte me ndalimin *in communi-cado* të një shtetasi gjerman, “dorëzimin e jashtëzakonshëm” dhe transferimin e tij në Afganistan, ku më pas dhe u bë subjekt i keqtrajtimit. Përveç tejzgjatjes së paraburgimit, dhe mungesës së arsytimit të urdhrave për ndalimet kolektive,¹⁷⁴ GJEDNJ diskutoi të drejtën e të pandehurit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset në të cilat masa me arrest shtëpie u zëvendësua në arrest me burg,¹⁷⁵ mungesa e dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi kishte kryer një vepër penale,¹⁷⁶ arrestimi i paligjshëm lidhur me mosrespektimin e urdhrat të gjykatës për shlyerjen e një gjobe dhe mosinformimin e kërkuesit nga ana e autoriteteve lidhur me arsyet e arrestimit të tij,¹⁷⁷ mosveprimi për akordimin e shpërblimit të drejtë lidhur me burgimin e paligjshëm,¹⁷⁸ si dhe mbajtja e pajustificuar dhe e vazhdueshme në një institucion psikiatrik.¹⁷⁹

167 *Selami dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 1 marsit 2018; *Asllani k. Maqedonisë*, vendim i 10 dhjetorit 2015; *Hajrulahu k. Maqedonisë*, vendim i 29 tetorit 2015; *Andonovski k. Maqedonisë*, vendim i 23 korrikut 2015; *Kitanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 janarit 2015; *El-Masri k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012; *Gorgiev k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2012; *Sulejmanov k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2008; *Dželadinov dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 10 prillit 2008; *Trajkoski k. Maqedonisë*, vendim i 7 shkurtit 2008; *Jašar k. Maqedonisë*, vendim i 15 shkurtit 2007.

168 *Hajrulahu k. Maqedonisë*, vendim i 29 tetorit 2015.

169 *Asllani k. Maqedonisë*, vendim i 10 dhjetorit 2015; *Andonovski k. Maqedonisë*, vendim i 23 korrikut 2015; *Kitanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 janarit 2015; *Gorgiev k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2012.

170 *Trajkoski k. Maqedonisë*, vendim i 7 shkurtit 2008.

171 *Ilievka k. Maqedonisë*, vendim i 7 majit 2015.

172 *Sejdiji k. Maqedonisë*, vendim i 7 qershorit 2018; *Selami dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 1 marsit 2018; *Ramkovski k. Maqedonisë*, vendim i 8 shkurtit 2018; *Miladinov dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014; *Velinov k. Maqedonisë*, vendim i 19 shtatorit 2013; *El-Masri k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012; *Vasilkoski dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 28 tetorit 2010; *Mitreski k. Maqedonisë*, vendim i 25 marsit 2010; *Trajče Stojanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 tetorit 2009; *Lazoroski k. Maqedonisë*, vendim i 8 tetorit 2009.

173 *El-Masri k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012.

174 *Sejdiji k. Maqedonisë*, vendim i 7 qershorit 2018; *Ramkovski k. Maqedonisë*, vendim i 8 shkurtit 2018; *Miladinov dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014; *Vasilkoski dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 28 tetorit 2010.

175 *Mitreski k. Maqedonisë*, vendim i 25 marsit 2010.

176 *Lazoroski k. Maqedonisë*, vendim i 8 tetorit 2009.

177 *Velinov k. Maqedonisë*, vendim i 19 shtatorit 2013.

178 *Selami dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 1 marsit 2018; *Velinov k. Maqedonisë*, vendim i 19 shtatorit 2013.

179 *Trajče Stojanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 tetorit 2009.

Gjykata konstatoi shkelje në 5 nga 6 vendimet që kanë të bëjnë me kërkesat në bazë të nenit 8, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, të cilat përfshijnë të drejtën për respektimin e reputacionit,¹⁸⁰ mungesën e ekzekutimit të urdhrave për mbajtjen e kontakteve mes prindërve dhe fëmijëve,¹⁸¹ dhe integritetin moral dhe fizik të personit.¹⁸² Largimi i detyrueshëm i gazetarëve nga salla e Parlamentit ndërkohë që ata ishin duke raportuar lidhur me një debat që po zhvillohej për miratimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013, përbënte shkelje të nenit 10, liria e shprehjes.¹⁸³ Ka pasur vetëm një rast lidhur me nenin 11, liria e tubimit dhe organizimit, e cila kishte të bënte me shpërndarjen e një organizate të shoqërisë civile¹⁸⁴, ndërsa 4 raste të tjera përfshinin ndalimin e regjistrimit të komuniteteve fetare (shkelje e nenit 11 marrë së bashku me nenin 9).¹⁸⁵

Vendime 2018

Nga 12 vendimet e dhëna në 2018, 7 vendime¹⁸⁶ u dhanë nga Dhoma e përbërë nga 7 gjyqtarë dhe 5 të tjerat¹⁸⁷ nga Komitetet prej 3 gjyqtarësh. Në një nga rastet, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 1 Protokollit nr.1,¹⁸⁸ nenit 10,¹⁸⁹ si dhe shkelje të nenit 3, marrë së bashku me nenin 5 § 5.¹⁹⁰ Shkelje në lidhje me nenin 5 § 3 u konstatuan në 2 raste,¹⁹¹ ndërsa 3 raste përbëjnë shkelje të nenit 11 marrë së bashku me nenin 9¹⁹² dhe në tre raste të tjera ka pasur shkelje të nenit 6.¹⁹³

Deri tani, vetëm në një vendim, *Ljatifi k. Maqedonisë*,¹⁹⁴ Gjykata ka trajtuar ankesat lidhur me lirinë e lëvizjes, duke konstatuar shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 7 të Konventës. Kërkuesja, një shtetase serbe, e cila u largua nga Kosova drejt Maqedonisë në 1999, iu kërkua të largohet nga vendi pasi ajo paraqiste “rrezik për sigurinë kombëtare” për arsye se statusi i saj si azilante ishte ndërprerë. Gjykatat administrative vendase kishin mbështetur vendimin e Ministrisë së Brendshme, duke vënë në dukje

180 *Karajanov k. Maqedonisë*, vendim i 6 prillit 2017; *Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016; *Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 31 tetorit 2013.

181 *Mitovi k. Maqedonisë*, vendim i 16 prillit 2015. Përkundrazi, asnjë shkelje nuk u gjet në këtë drejtim në *Mitrova dhe Savić k. Maqedonisë*, vendim i 11 shkurtit 2016.

182 *El-Masri k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012.

183 *Selmani dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 9 shkurtit 2017.

184 *Association of Citizens Radko dhe Paunkovski k. Maqedonisë*, vendim i 15 janarit 2009.

185 *Stavropegic Monastery of Saint John Chrysostom k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018; *Church of Real Orthodox Christians dhe Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018; *Bektashi Community dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 12 prillit 2018; “*Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit në Patrikanën e Peç) k. Maqedonisë*, vendim i 16 nëntorit 2017.

186 *Makraduli k. Maqedonisë*, vendim i 19 korrikut 2018; *Euromak Metal DOO k. Maqedonisë*, vendim i 14 qershorit 2018; *Ljatifi k. Maqedonisë*, vendim i 17 majit 2018; *Bektashi Community dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 12 prillit 2018; *Selami dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 1 marsit 2018; *Ramkovski k. Maqedonisë*, vendim i 8 shkurtit 2018; *Asani k. Maqedonisë*, vendim i 1 shkurtit 2018.

187 *Stavropegic Monastery of Saint John Chrysostom k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018; *Church of Real Orthodox Christians dhe Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018; *Smičkovski k. Maqedonisë*, vendim i 5 korrikut 2018; *Sejdiji k. Maqedonisë*, vendim i 7 qershorit 2018; *Taseva Petrovska k. Maqedonisë*, vendim i 11 janarit 2018.

188 *Euromak Metal DOO k. Maqedonisë*, vendim i 14 qershorit 2018.

189 *Makraduli k. Maqedonisë*, vendim i 19 korrikut 2018.

190 *Selami dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 1 marsit 2018.

191 *Sejdiji k. Maqedonisë*, vendim i 7 qershorit 2018; *Ramkovski k. Maqedonisë*, vendim i 8 shkurtit 2018.

192 *Stavropegic Monastery of Saint John Chrysostom k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018; *Church of Real Orthodox Christians dhe Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018; *Bektashi Community dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 12 prillit 2018.

193 *Smičkovski k. Maqedonisë*, vendim i 5 korrikut 2018; *Asani k. Maqedonisë*, vendim i 1 shkurtit 2018; *Taseva Petrovska k. Maqedonisë*, vendim i 11 janarit 2018.

194 *Ljatifi k. Maqedonisë*, vendim i 17 majit 2018.

se vendimi ishte bazuar në një dokument të klasifikuar i marrë nga Agjencia e Inteligjencës. Gjykata i referohej vetëm dyshimeve të kërkueses dhe mbështetjes së personave të tjerë të përfshirë në kryerjen e shkeljeve të shumta, pa ndonjë tregues konkret lidhur me identitetin e tyre apo marrëdhënien e tyre me kërkuesen. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, kërkuesja nuk kishte mundur ta paraqiste rastin e saj në mënyrë adekuate gjatë proceseve të mëvonshme të shqyrtimit gjyqësor, pasi dokumenti i klasifikuar nuk i ishte treguar asnjëherë dhe vendimi i Ministrisë nuk i kishte siguruar asaj as treguesin më të vogël të bazës faktike që e konsideronte atë rrezik për sigurinë.

Përveç kësaj, gjykatave nuk u ishte siguruar dokumenti i kundërshtuar ose ndonjë detaj tjetër faktik me qëllim verifikimin e pohimit të ekzekutivit se kërkuesja përbënte rrezik për sigurinë kombëtare. Për këtë ata u kufizuan thjesht në një ekzaminim formal të çështjes, pa dhënë asnjë shpjegim për rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit të atij dokumenti. Në këtë kontekst, Gjykata theksoi se edhe kur siguria kombëtare është në rrezik, konceptet e ligjshmërisë dhe shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike kërkojnë që masat e deportimit që prekin të drejtat themelore të njeriut t'i nënshtrohen një procesi me palë kundërshtare pranë një autoriteti të pavarur ose një gjykatë kompetente për të shqyrtuar në mënyrë efektive arsyet e tyre dhe provat relevante, nëse ka nevojë edhe me kufizime procedurale të përshtatshme lidhur me përdorimin e informacionit të klasifikuar. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi shkelje të paragrafit 1 (a) dhe (b) të nenit 1 të Protokollit nr. 7.

Lidhur me lirinë e shprehjes politike, *Makraduli k. Maqedonisë*¹⁹⁵ kishte të bënte me dënimin penal të kërkuesit, nënkryetarit të partisë opozitare dhe një deputeti, për shpifje ndaj kushëririt të Kryeministrit, i cili në atë kohë ishte anëtar i lartë i partisë në pushtet dhe kreu i Agjencisë së Sigurisë dhe Kundërsbulimit. Gjykata theksoi nivelin e lartë të mbrojtjes së fjalimit politik, i cili vlen për përfaqësuesit e zgjedhur, duke i lënë autoriteteve pasur kështu një hapësirë të ngushtë vlerësimi. Ajo përsëriti se kufijtë e lejueshëm të kritikës janë më të gjera për zyrtarët shtetërorë sesa për individët privatë dhe se një politikan në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije ka prishmëri për shqyrtim kritik nga gazetarët dhe publiku në përgjithësi dhe se ai duhet të shfaqë një shkallë më të lartë tolerance dhe të kufizojë hapjen e proceseve penale. Megjithëse gjykatat vendase kishin pranuar statusin e paditësit si zyrtar shtetëror, ata nuk kishin pranuar tejkalimin e gjerë të kritikës së lejueshme që ju ishte bërë këtyre zyrtarëve. Ata i konsideruan pretendimet mbi keqpërdorimin e pajisjeve/kompetencave të përgjimit të policisë për të përfituar në tregun e aksioneve dhe kryerjen e praktikave korruptive në shitjen publike të tokës shtetërore, të bëra nga kërkuesi në konferencat e shtypit që mbaheshin në selinë e partisë së tij, më tepër si deklarata faktike sesa gjykime të vlefshme. GJEDNJ kritikoi faktin që gjykatat e brendshme i kërkuan kërkuesit përmbushjen e një standardi më tepër sesa faktin për tu treguar kujdesi i duhur, duke kërkuar që ai të demonstronte të vërtetën e pohimeve të tij dhe se një qasje e tillë u pasua edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila i kategorizoi deklaratat e kontestuara si “opinione”.

Sipas pikëpamjes së Gjykatës, pavarësisht nga fakti se gjoba e dhënë nuk mund të ekzekutohej, duke pasur parasysh ndryshimet legjislative të nëntorit të vitit 2012, të cilat kishin dekriminalizuar shpifjen, dënimi i kërkuesit kishte efekt zbutës në debatin politik që ngrinte çështje të interesit të përgjithshëm, siç janë transparenca dhe parandalimi i shpërdorimit të pushtetit nga nëpunësit publikë, detyrë e politikanëve dhe deputetëve si përfaqësues të elektoratit. Për më tepër, standardet e zbatuara në proceset me palë kundërshtare nuk ishin në përputhje me parimet e mishëruara në nenin 10 dhe

195 *Makraduli k. Maqedonisë*, vendim i 19 korrikut 2018.

gjykatat vendase nuk arritën të gjenin një balancë të drejtë midis interesave konkurrues në fjalë. Rrjedhimisht, ndërhyrja ishte jo proporcionale në qëllimin e ndjekur dhe jo “e domosdoshme në një shoqëri demokratike” brenda kuptimit të nenit 10 § 2.

Në rastin *Euromak Metal DOO k. Maqedonisë*,¹⁹⁶ Gjykata gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 pasi shoqëria kërkuese ishte privuar nga e drejta e saj për të zbritur tatimin mbi vlerën e shtuar (“TVSH”) që kishte paguar për mallrat e marra, pavarësisht përputhshmërisë së plotë me detyrimet e saj për TVSH dhe ishte urdhëruar në mënyrë të pajustificuar të paguante TVSH-në, të cilën e kishte zbritur më parë në mënyrë të ligjshme, së bashku me interesin. Kjo ishte bërë për shkak se furnizuesit e saj nuk kishin arritur të përmbushnin detyrimet e tyre për raportimin e TVSH-së. Fakti që shoqëria kërkuese nuk i kishte shlyer detyrimet ndaj shtetit që kishin ardhur si pasojë e urdhrave të lëshuara nga autoritetet tatimore, të cilat ishin mbështetur edhe nga gjykatat administrative, duke pasur parasysh që llogaria bankare e saj ishte bllokuar sipas këtyre urdhrave dhe kompania kishte pushuar së ekzistuari, nuk kishte pasur ndonjë ndikim në konstatimet e shkeljes nga ana e Gjykatës se vlerësimi tatimor kishte ndikuar në të drejtat pronësore të shoqërisë kërkuese.

Shkelje të parimit të barazisë së armëve në kundërshtim me nenin 6 § 1 dhe 3 (d) u konstatuan në 2 vendime të dala në 2018.¹⁹⁷

Në rastin *Asani k. Maqedonisë*,¹⁹⁸ Gjykata u shpreh se e drejta e kërkuesve për t’u mbrojtur ishte kufizuar së tepërmi, pasi ishin zbatuar parimet relevante të trajtuara në vendimin e Dhomës së Madhe në rastin *Al-Khawaja*¹⁹⁹ dhe *Schatschaschwili*,²⁰⁰ të cilat kanë të bëjnë me përputhshmërinë me nenin 6 § 1 dhe 3 (d) të proceseve në të cilat deklaratat e bëra nga një dëshmitar, i cili nuk ishte prezent dhe nuk u pyet në gjyq, u përdorën si prova. Dëshmia e dhënë nga dëshmitarët anonimë u konsiderua si vendimtare në rastin në fjalë, pasi pa të, mundësia që kërkuesit të akuzoheshin për vrasje dhe dënoheshin me burgim të përjetshëm do të ishte ulur ndjeshëm. Duke marrë parasysh përjashtimin e kërkuesve dhe avokatëve të tyre për të marrë pjesë në rastin e shqyrtimit të çështjes së tyre para gjyqtarit hetues dhe gjyqtarit të çështjes, ndryshe nga prokurori publik, i cili mori pjesë në të dyja ekzaminimet, Gjykata vlerësoi se mundësia që u ofrohet parashtresve për t’i parashtuar pyetje me shkrim dëshmitarëve anonim nuk mund të konsiderohej si një mbrojtje e mjaftueshme procedurale për të balancuar kufizimet me të cilat ishin ballafaquar në ushtrimin e të drejtës së tyre për t’u mbrojtur.

Për më tepër, përpjekjet nuk ishin të mjaftueshme për të siguruar pjesëmarrjen në gjykim të një dëshmitari të tretë, deklarata paraprake e të cilit kishte pasur peshë të konsiderueshme në vendimin e gjykatave vendase lidhur me fajësinë e kërkuesve, për shkak se ai nuk mund të gjurmohej pasi ishte larguar nga shteti dhe një urdhër arresti ndërkombëtar ishte lëshuar kundër tij. Për më tepër, referuar deklaratave të bëra më vonë se ai kishte qenë në Maqedoni, gjykatat vendase nuk kishin dhënë arsye të vlefshme lidhur me mosparaqitjen e tij në gjykim. Gjithashtu, GJEDNJ vuri në dukje se gjyqtari i çështjes nuk e kishte marrë kurrë në shqyrtim atë, në mënyrë që të bënte vlerësimin lidhur me llogaridhënien mbi vërtetësinë e deklaratave të tij. Qartazi, mungesa e kundërshtimit nga ana e kërkuesve lidhur me deklaratën paraprake

196 *Euromak Metal DOO k. Maqedonisë*, vendim i 14 qershorit 2018.

197 *Asani k. Maqedonisë*, vendim i 1 shkurtit 2018; *Smičkovski k. Maqedonisë*, vendim i 5 korrikut 2018.

198 *Asani k. Maqedonisë*, vendim i 1 shkurtit 2018.

199 *Al-Khawaja dhe Tahery k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 15 dhjetorit 2011.

200 *Schatschaschwili k. Gjermanisë*, vendim i 15 dhjetorit 2015.

të lexuar në gjykim, nuk mund të interpretohej nga ana e tyre si heqje dorë nga e drejta e tyre për ta shqyrtuar atë, veçanërisht nisur nga fakti që as kërkuesit, as avokatët e tyre nuk kishin pasur mundësi në asnjë fazë të procesit për t'u ballafaquar dhe për të pyetur me gojë dëshmitarin në praninë e tyre.

*Smičkovski k. Maqedonisë*²⁰¹ kishte të bënte me proceset penale në të cilat kërkuesi ishte shpallur fajtor dhe i ishte dhënë dënim me kusht për një vit për shkak të lëndimeve të rënda trupore. Gjykata konkludoi se duke hedhur poshtë të gjitha kërkesat e mbrojtjes, dhe në veçanti kërkesën për të marrë në pyetje një dëshmitar okular vendimtar, pa dhënë arsyet përkatëse, dhe në të njëjtën kohë duke pranuar të gjitha argumentet dhe provat e prokurorisë, gjykimi i kësaj gjykate kishte krijuar një avantazh të padrejtë në favor të prokurorisë dhe i kishte privuar kërkuesit mundësinë praktike për të kundërshtuar në mënyrë efektive akuzat e ngritura kundër tij. Hedhja poshtë e një kërkesë të tillë, e cila mund të kishte fuqizuar pozicionin e mbrojtjes ose madje të kishte çuar në lirimin e kërkuesit, ishte bazuar në një arsyetim që sipas Gjykatës konsiderohej të ishte në kundërshtim me faktet në dispozicion të rastit dhe për rrjedhojë, nuk mund të pranoheshin si të rëndësishme dhe të vlefshme.

Në rastin *Taseva Petrovska k. Maqedonisë*²⁰² kërkuesja, një profesore e së drejtës në një universitet privat, u ankua për mungesën e respektimit të gjykimin me palë kundërshtare në proceset para Gjykatës së Lartë Administrative, në të cilën ajo kishte kundërshtuar vendimin e dhënë nga Ministria e Drejtësisë e cila kishte refuzuar kërkesën e saj për t'i njohur të njëjtin status, si një person që kishte kaluar provimin e avokatisë. GJEDNJ konstatoi se fakti që asaj nuk i ishte lejuar të komentonte mbi vërejtjet e Ministrisë të prapësuar në përgjigje të ankesës së saj, për sa kohë që ato nuk i ishin dërguar asaj, përbënin shkelje të nenit 6 § 1. Ajo gjithashtu ju referua vendimeve të saj të mëparshme *Grozdanoski*²⁰³ dhe *Naumoski*,²⁰⁴ të cilat kishin të bënin me rrethana të ngjashme.

Në rastin *Selami dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*²⁰⁵ kërkuesi u arrestua pasi dyshohej se ishte përfshirë në vrasjen e dy policëve dhe më pas u padit për anëtarësim në një grup terrorist, por procesi penal u pushua. Rasti kishte të bënte me ankesën e familjarëve të z. Selami lidhur me kompensimin e akorduar ndaj tij në proceset e brendshme, i cili sipas tyre kishte qenë tepër i ulët, duke marrë parasysh paraburgimin e tij të pajustificuar dhe dëmtimet serioze që kishte pësuar. Nisur nga rrethanat e rastit, Gjykata vuri në dukje se kërkuesi ishte keqtrajtuar nga policia në kohën e arrestimit dhe marrjes në pyetje dhe kishte qenë viktimë e torturës. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 3 në aspektin e tij procedural dhe shkelje të nenit 5 § 5 (e drejta për dëmshpërblim), pasi shuma prej 9,800 euro që ishte akorduar nga gjykatat vendase nuk mund të konsiderohej si një dëmshpërblim i drejtë. Përveç kësaj, Gjykata vuri në dukje se gjykatat vendase nuk kishin pranuar, shprehimisht ose në thelb, se keqtrajtimi që i ishte bërë kërkuesit klasifikohet si “torturë”. Gjykata në veçanti e trajtoi çështjen nëse kërkuesit ishin “viktima indirekte” të shkeljeve të dyshuara. Gjykata u shpreh se ndërsa tre prej tyre (ish bashkëshortja dhe fëmijët e tij) nuk mund të paraqisnin kërkesë në emër të z. Selami, kërkuesi i katërt, djali i z. Selami dhe trashëgimtari i vetëm, mund të kualifikohej si “viktimë indirekte” sepse në rastin në fjalë ai kishte një interes moral të fortë dhe pretendimet ishin të transferueshme për të, pasi ai kishte vijuar kërkesën për kompensim në emër të tij, pas vdekjes së të atit dhe kishte trashëguar akordimin e shpërblimit lidhur me dëmet.

201 *Smičkovski k. Maqedonisë*, vendim i 5 korrikut 2018.

202 *Taseva Petrovska k. Maqedonisë*, vendim i 11 janarit 2018.

203 *Grozdanoski k. Maqedonisë*, vendim i 31 majit 2007.

204 *Naumoski k. Maqedonisë*, vendim i 27 nëntorit 2012.

205 *Selami dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 1 marsit 2018.

*Ramkovski k. Maqedonisë*²⁰⁶ dhe *Sejdiji k. Maqedonisë*²⁰⁷ kishte të bënte me ndalimin e tejzgjatur të kërkuesve, të cilët ishin dënuar për një sërë veprash penale, si akuzat për krimin e organizuar përfshirë dhe komplotin kriminal. Gjykata vuri në dukje praktikën që ishte ndjekur për rastet e lëshimit të urdhrave të ndalimit kolektiv, në të cilat në vetvete ishte konstatuar papërputhshmëri sipas nenit 5 § 3 të Konventës. E njëjta formulë përmbledhëse ishte përdorur vazhdimisht në të gjitha urdhrat për zgjatje dhe vendimet mbi ankesat e kërkuesve, ku gjykatat nuk kishin bërë një vlerësim individual të rasteve për shkaqet e ndalimit për secilin anëtar të grupit. GJEDNJ më tej konkludoi se duke mos trajtuar fakte konkrete ose duke mos marrë në konsideratë masat alternative parandaluese dhe duke u mbështetur kryesisht në akuzat e rënda dhe ashpërsinë e dënimit me të cilin ata ishin duke u përballur, autoritetet kishin tejzgjatur ndalimin e kërkuesve për arsye të cilat nuk mund të konsideroheshin si “relevante dhe të mjaftueshme”, duke vijuar kështu sipas jurisprudencës së mëparshme tek *Vasilkoski dhe Të Tjerët*²⁰⁸ dhe *Miladinov dhe Të Tjerët*.²⁰⁹

Në *Ramkovski k. Maqedonisë*, Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje të prezumimit të pafajësisë sipas nenit 6 § 2 të Konventës në lidhje me formulimin e urdhrave të përdorur për të justifikuar zgjatjen e paraburgimit të kërkuesve, për sa kohë që ata i ishin referuar vetëm dyshimit të arsyeshëm që i akuzuari kishte kryer krime sipas akuzave me shkrim që ata kishin paraqitur kundër tij, të cilat nuk përfshinin një deklaratë të hollësishme dhe të shprehur qartë që do të përcaktonte fajësinë e kërkuesve para se të ishte vërtetuar fajësia e tyre sipas ligjit.

Shkelje e nenit 11 në dritën e nenit 9 u konstatua në 3 raste²¹⁰ të cilat kishin të bënin me refuzimin e autoriteteve për të regjistruar shoqatat e kërkuesve si persona juridik. Për sa kohë ndërhyrje të tilla ishin “të parashikuara në ligj” dhe për sa kohë që shoqatat në fjalë nuk kishin përbushur kërkesat formale të Statusit Ligjor të Kishave, Komuniteteve Fetare dhe Grupeve Fetare të ligjit të vitit 2007 ata kishin ndjekur një “qëllim legjitim” të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Megjithatë, arsyet e parashtruara nga gjykatat kombëtare, kryesisht në lidhje me mangësitë formale për regjistrim, nuk ishin “relevante dhe të mjaftueshme” për të justifikuar ndërhyrjet. Për më tepër, në rastet e *Stavropegic Monastery of Saint John Chrysostom*²¹¹ dhe *Church of Real Orthodox Christians dhe Ivanovski*,²¹² Gjykata vlerësoi se gjetjet e gjykatave vendase se regjistrimi përbënte shkelje të lirisë së besimit të besimtarëve që ishin të lidhur me entitete të tjera të regjistruara fetare ishin të një natyre të përgjithshme dhe nuk ishin mbështetur nga ndonjë arsyetim bindës.

Në të dyja rastet, Gjykata përsëriti parimet e përmbledhura në rastin *Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit*,²¹³ duke njohur margjinën e gjerë të vlerësimit të Shteteve dhe barazinë e të gjitha organizatave fetare përpara ligjit. Vlen për t’u theksuar se roli i autoriteteve në një situatë konflikti midis ose brenda grupeve fetare nuk është që të heqë shkakun e tensionit duke eliminuar pluralizmin, por të sigurojë to-

206 *Ramkovski k. Maqedonisë*, vendim i 8 shkurtit 2018.

207 *Sejdiji k. Maqedonisë*, vendim i 7 qershorit 2018.

208 *Vasilkoski dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 28 tetorit 2010.

209 *Miladinov dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014.

210 *Stavropegic Monastery of Saint John Chrysostom k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018; *Church of Real Orthodox Christians dhe Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018; *Bektashi Community dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 12 prillit 2018.

211 *Stavropegic Monastery of Saint John Chrysostom k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018.

212 *Church of Real Orthodox Christians dhe Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 29 nëntorit 2018.

213 “*Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit në Patrikanën e Peć)*” k. *Maqedonisë*, vendim i 16 nëntorit 2017.

lerancën mes grupeve konkurruese. Meqë në çështjen e *Stavropegic Monastery*, ankesa kushtetuese e shoqatës kërkuese ishte refuzuar për shkak të mungesës së juridiksionit të pretenduar, Gjykata hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë për mosshkrim të rastit *Church of Real Orthodox Christians*, duke marrë parasysh praktikën e Gjykatës Kushtetuese për përjashtim nga juridiksioni lidhur me kërkesat e shoqatave ose organizatave, dhe refuzimin e apelimeve të individëve të paraqitur në emër të tyre dhe në emër të shoqatave fetare të paregjistruara, me të cilat ata ishin të lidhur.

Kërkesa e parë për njohjen e shoqatës së kërkuesit në *Bektashi Community dhe Tërë të Maqedonisë*²¹⁴ u refuzua thjesht mbi baza formale, që do të thotë se ajo nuk ishte regjistruar para vitit 1998, por vetëm në vitin 2000. Për rrjedhojë Gjykata u shpreh se autoritetet vendase nuk kishin identifikuar asnjë “nevojë urgjente sociale” dhe, ndërhyrja nuk ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Në të vërtetë, gjykatat vendase refuzuan të njohin statusin e vazhdueshëm ligjor të shoqatës kërkuese sipas legjislacionit të ri, i cili hyri në fuqi në vitin 2007, megjithëse organizata fetare ishte e njohur zyrtarisht që nga viti 1993, kryesisht sepse emri i saj dhe burimet doktrinale ishin identike me ato të “Bektashi”, i cili përdorej tashmë nga një entitet fetar i regjistruar dhe që burimet doktrinale të të cilit ishin identike me entitetin e regjistruar tashmë “Komuniteti Fetar Myslyman”, duke krijuar kështu mundësinë e konfuzionit mes besimtarëve. Një vlerësim i tillë ishte i papajtueshëm me rolin e Shtetit si një organizator neutral dhe i paanshëm i ushtrimit të besimeve dhe bindjeve të ndryshme fetare, të cilat përjashtojnë çdo diskrecion nga ana e Shtetit për të vlerësuar legjitimitetin e besimeve fetare ose mënyrat në të cilat ato shprehen. Gjithashtu, Gjykata kritikoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese për mosregjistrimin e shoqatës kërkuese pasi regjistrimi i saj do të kishte qenë i nevojshëm “për të parandaluar konfliktet fetare”, sepse nuk kishte asnjë provë që të përbënte ndonjë rrezik në një shoqëri demokratike. Ndonëse ndërhyrja ishte e ligjshme dhe kishte për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, arsyet për refuzimin e regjistrimit nuk ishin veçanërisht serioze dhe bindëse, duke çuar për rrjedhojë në shkelje të nenit 11, të marrë së bashku me neni 9.

Në 4 nga 17 vendimet kundër Maqedonisë në 2018, Gjykata i hyri në shqyrtim themelit të çështjeve. 2 nga të cilat trajtonin rastin e të drejtës që çështja të dëgjohej nga një gjykatë e paanshme, sipas nenit 6 § 1 të Konventës.²¹⁵

*Hasani k. Maqedonisë*²¹⁶ kishte të bënte me proceset në të cilat kërkuesja, e cila ishte larguar nga Kosova në vitin 1999, kundërshtoi vendimin përfundimtar të Ministrisë së Brendshme për ndërprerjen e statusit të saj si azilante dhe urdhërimin e saj për të lënë Maqedoninë, e cila konsiderohej si masë e dëbimit të marrë kundër saj. Megjithatë, GJEDNJ konsideroi se gjatë procedurave të azilit kërkuesja nuk kishte siguruar barrën e provës në lidhje me ekzistencën e një rreziku real individual që mund të ishte subjekt i keqtrajtimit sipas nenit 3, nëse masa e ankimuar do ishte zbatuar. Për sa i përket kërkesave të saj lidhur me nenin 8, Gjykata pranoi se kishte një jetë familjare midis kërkueses, partnerit me të cilin bashkëjetonte dhe katër fëmijëve të tyre të mitur (të gjithë shtetas maqedonas), por Gjykata ju referua faktit që kërkuesja nuk kishte ngritur kërkesë mbi ndikimin që do të kishte largimi i saj në jetën familjare. Gjykata theksoi detyrimin pozitiv të autoriteteve për ta lejuar atë që të banonte në Maqedoni, ku ajo kishte jetuar për një periudhë të konsiderueshme që nga moshja 13 vjeçare, për të mbajtur dhe zhvilluar më tej jetën e saj familjare. Në të njëjtën kohë, ajo vuri në dukje se kërkuesja nuk kishte marrë

214 *Bektashi Community dhe Tërë të Maqedonisë*, vendim i 12 prillit 2018.

215 *Andonov k. Maqedonisë*, vendim i Komitetit i 11 shtatorit 2018; *Bajramovski k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës i 26 qershorit 2018.

216 *Hasani k. Maqedonisë*, vendim i Komitetit i 26 qershorit 2018.

asnjë masë për marrjen e dokumenteve personale të identifikimit nga Kosova, pavarësisht se kishin kaluar më shumë se nëntë vjet që nga urdhri i Ministrisë dhe se ajo nuk kishte paraqitur asgjë për të argumentuar se situata e saj ishte ndryshe nga ajo e prindërve dhe vëllezërve e motrave të saj, të cilët i kishin marrë dokumente të tilla. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesja nuk kishte asnjë “pretendim të diskutueshëm” dhe kërkesa e saj u rrëzua si haptazi e pabazuar.

Në rastin *Maliki k. Maqedonisë*,²¹⁷ kërkuesi, i cili ishte dënuar *in absentia* për vrasjen e bashkëshortes së tij dhe ishte dënuar me pesëmbëdhjetë vite burg, ankohej në lidhje me rihapjen e procesit penal (pas kthimit të tij në Maqedoni). Zbatimi i kritereve të vendosura në *Schatschaschwili* dhe *Al-Khawaja dhe Tahery*, GJEDNJ-ja vuri në dukje se përveç faktit se gjykata nuk kishte dhënë një arsye të bazuar për mosparaqitjen e dy dëshmitarëve, dëshmitë e tyre nuk kanë qenë dëshmia “e vetme” ose “vendimtare” për dhënien e dënimit, për sa kohë që rrethanat e rastit të kërkuetit ishin siguruar në bazë të provave të nxjerra nga dëshmitarë të tjerë, ose të vërtetuara prej tyre. Për më tepër, kërkuesi nuk ishte ballafaquar me një nga dëshmitarët, dhe ai nuk kishte kundërshtuar besueshmërinë e provave të tjera materiale të parashtruara kundër tij dhe nuk kishte shtuar ndonjë arsye sesi shqyrtimi i tyre do të kishte forcuar pozitën e tij. Në këtë kontekst, GJEDNJ konkludoi se e drejta për t’u mbrojtur nuk ishte kufizuar në një shkallë të papërshtatshme lidhur me garancitë e parashikuara në nenin 6 § 1 dhe 3 (d) dhe për rrjedhojë e rrëzoi këtë kërkesë si haptazi të pabazuar.

Në *Bajramovski k. Maqedonisë*,²¹⁸ kërkuesi pretendonte mungesën e paanshmërisë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse i pandehuri në çështjen civile të parashtruar prej tij ka qenë gjyqtar i kësaj gjykate në periudhën në fjalë. Kërkesa e tij u shpall e papranueshme për mosshkrimin e mjetëve të brendshme ligjore, duke qenë se dështimi i kërkuetit për të parashtruar kërkesat e tij në çdo fazë të procesit dhe fakti që ai nuk kishte ezauruar mundësinë që t’i kërkonte Gjykatës së Lartë t’ia kalonte çështjen një gjykate tjetër kompetente. Gjithashtu, e njëjta kërkesë në lidhje me Gjykatën e Apelit u hodh poshtë pasi kërkuesi nuk paraqiti ndonjë provë për të vërtetuar dyshimet e tij lidhur me anshmërinë personale të dy gjyqtarëve, të cilët kishin qenë ish-kolegë të oponentit të kërkuetit në gjykatën e shkallës së parë dhe të cilët ndërkohë ishin bërë gjyqtarë të Gjykatës së Apelit. Për më tepër, dyshime të tilla nuk mund të konsideroheshin si objektivist të justifikuara, pasi asnjëri prej tyre nuk ishte ulur në panelin që vendosi lidhur me kërkesën e tij.

Në rastin *Andonov k. Maqedonisë*,²¹⁹ Gjykata vuri në dukje se pretendimet e kërkuetit se kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës së Apelit, i cili kishte shqyrtuar kërkesën e tij të parashtruar gjatë procesit civil të rihapur, kishte pasur mungesë të anshmërisë pasi në të ishte i përfshirë një gjyqtar me të cilin dyshohej se kishte marrëdhënie personale të vështirë me një natyrë mjaft të përgjithshme, pa ndonjë detaj të veçantë lidhur me natyrën dhe arsyet e konfliktit të dyshuar. Për më tepër, kërkesa e kërkuetit për përjashtimin e këtij gjyqtari ishte marrë në shqyrtim në mënyrën e duhur dhe në përputhje me procedurën përkatëse. Për sa kohë që kërkuesi nuk arriti të paraqiste ndonjë provë për të treguar anshmërinë personale të gjyqtarit, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e tij si haptazi të pabazuar.

217 *Maliki k. Maqedonisë*, vendim i Komitetit i 11 shtatorit 2018.

218 *Bajramovski k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës i 26 qershorit 2018.

219 *Andonov k. Maqedonisë*, vendim i Komitetit i 11 shtatorit 2018.

REPUBLIKA E SERBISË

Hyrje

Republika e Serbisë e ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('Konventën') më 3 mars 2004.

Në 31 dhjetor 2018, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ('GJEDNJ' ose 'Gjykata') ka marrë 192 vendime themeli²²⁰ dhe 556 vendime pranueshmërie kundër Serbisë. Gjykata ka gjetur shkelje në 179 raste²²¹. Nga këto vendime, në 75 raste vendimi është marrë nga një Komitet i përbërë prej 3 gjyqtarësh në ato të ashtuquajtura raste "të përsëritura" ose "çështje të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës", 115 raste janë gjykuar nga një Dhomë dhe 2 raste të tjera nga Dhoma e Madhe. Për vendimet e pranueshmërisë, 430 janë gjykuar nga një Komitet dhe 126 raste janë gjykuar nga një Dhomë.

Në lidhje me nenin 6 të Konventës, e drejta për proces të rregullt, janë dhënë 147 vendime. Gjykata ka gjetur shkelje në 140 raste. Kryesisht, rastet kishin të bënin me kohëzgjatjen e proceseve ligjore dhe mungesën e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave vendase. Gjithashtu, rastet ngrenë problematika lidhur me përdorimin e dëshmimeve në një gjykim,²²² përkufizimin e paanësisë në gjykata,²²³ proceset e rregullta në gjykimet penale,²²⁴ nevojën për sigurinë juridike dhe besimi i publikut në gjyqësor,²²⁵ e drejta për një seancë publike dhe kuptimi i saj,²²⁶ prezumimi i pafajësisë²²⁷, përbërja e gjykatës,²²⁸ proceset lidhur me zotësinë juridike²²⁹ dhe e drejta për akses në gjykatë kur ekzistojnë përjashtime procedurale sipas legjislacionit të brendshëm²³⁰.

Lidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, e drejta e pronës, janë dhënë 75 vendime, nga të cilat është konstatuar shkelje në 74 prej tyre.²³¹

Pjesa më e madhe e rasteve kishin të bënin me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore vendase kundrejt kompanive me pronësi kolektive. Rasti i parë i parashtruar ishte *Kačapor dhe Të Tjerët k.*

220 Numri i vendimeve në këtë material përfshin vendime të dhëna nga një Komitet prej tre gjyqtarësh në ato të ashtuquajturat "të përsëritura" ose çështje të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës", një Dhomë me 7 gjyqtarë dhe Dhoma e Madhe me 17 gjyqtarë.

221 Vendimet ku nuk ka pasur shkelje janë: *Damjanović k. Serbisë*, vendim i 18 nëntorit 2008; *Molnar Gabor k. Serbisë*, vendim i 8 dhjetorit 2009; *Juhas Đurić k. Serbisë*, vendim i 7 qershorit 2011; *Dobrić k. Serbisë*, vendim i 21 qershorit 2011; *Mitić k. Serbisë*, vendim i 22 janarit 2013; *Luković k. Serbisë*, vendim i 26 marsit 2013; *Đekić dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 29 prillit 2014; *Stanković dhe Trajković k. Serbisë*, vendim i 22 dhjetorit 2015; *Cupara k. Serbisë*, vendim i 12 korrikut 2016; *Zdravković k. Serbisë*, vendim i 20 shtatorit 2016; *Cvetković k. Serbisë*, vendim i 7 shkurtit 2017 dhe *Grujić k. Serbisë*, vendim i 28 gushtit 2018.

222 *Hajnal k. Serbisë*, vendim i 19 qershorit 2012 dhe *Dimović dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 11 dhjetorit 2018.

223 *Šorgić k. Serbisë*, vendim i 3 nëntorit 2011.

224 *Stanimirović k. Serbisë*, vendim i 18 tetorit 2011.

225 *Vinčić dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 1 dhjetorit 2009; *Rakić dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 5 tetorit 2010; *Živić k. Serbisë*, vendim i 13 dhjetorit 2011, *Mirković dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 26 qershorit 2018.

226 *Motion Pictures Guarantors Ltd k. Serbisë*, vendim i 8 qershorit 2010.

227 *Matijašević k. Serbisë*, vendim i 19 shtatorit 2006.

228 *Momčilović k. Serbisë*, vendim i 2 prillit 2013.

229 *Salontaji Drobñjak k. Serbisë*, vendim i 13 tetorit 2009.

230 *Maširević k. Serbisë*, vendim i 11 shkurtit 2014.

231 Asnjë shkelje nuk u gjet në *Molnar Gabor k. Serbisë*, vendim i 8 dhjetorit 2009.

Serbisë.²³² Pas këtij rasti Gjykata ka gjykuar 63 raste të ngjashme, shumica e të cilave janë gjykuar nga një Komitet prej tre gjyqtarësh, të cilat konsiderohen si “çështje të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës”.²³³ Gjykata gjeti shkelje të së drejtës së pronës në dy raste, të cilat lidheshin me të drejtat e pensionit²³⁴ dhe në rastin tjetër me ndërtimin pa leje.²³⁵

Në vendimin pilot të Dhomës së Madhe *Ališić dhe Tërjet*²³⁶, GJEDNJ konstatoi shkelje të së drejtës së gëzimit të pronës që erdhi si rezultat i pamundësisë së kërkuesve për të përdorur depozitat e tyre për më tepër se njëzet vjet, duke e detyruar Slloveninë dhe Serbinë të ndërmarrin masa të përgjithshme sipas nenit 46 të Konventës²³⁷.

Në vendimin *Grudić*²³⁸, Gjykata gjeti shkelje të së drejtës së pronës për sa kohë që ndërhyrja në “posedimet” e kërkuesit (pezullimi i pagesës së pensioneve ndaj individëve që ju ishin dhënë këto pensione) nuk kishte qenë në përputhje me ligjin përkatës vendas (pezullimi ishte bazuar në Opinionin e Ministrisë)²³⁹.

Në vendimin *Iseni*, GJEDNJ gjeti shkelje të së drejtës së pronës, ku që nga dhënia e vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shpronësimin e banesës së kërkuesit, akordimi i shumës nuk ishte ekzekutuar për më tepër se shtatë vjet²⁴⁰.

Lidhur me nenin 3, ndalimi i keqtrajtimit, janë dhënë nëntë vendime, ku në gjashtë prej tyre është gjetur shkelje²⁴¹. Rastet përfshijnë çështje të detyrimit për të hetuar,²⁴² dhe gjithashtu të testit nëse autoritetet duhet të kishin ditur për rrezikun që i kanosej një individ dhe nëse ata nuk vepruan ashtu si duhet.²⁴³ Tek *Habimi*, ndërsa u gjet një shkelje lidhur me aspektin procedural të nenit 3, nuk u konstatua shkelje e aspektit material edhe pse kjo ishte kryesisht për shkak të mungesës së fakteve, rezultat ky i hetimit të pamjaftueshëm nga ana e autoriteteve.²⁴⁴ Tek *Hajnal*, Gjykata gjeti shkelje të aspektit

232 *Kačapor dhe të Tërjet k. Serbisë*, vendim i 15 janarit 2008.

233 42 vendime themeli janë dhënë nga një Komitet sipas çështjeve të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës në lidhje me mosekzekutimin ndaj kompanive me pronësi kolektive. Në një sërë rastesh të ngjashme zgjidhja u arrit përmes zgjidhjeve me pajtim.

234 *Pejić k. Serbisë*, vendim i 8 tetorit 2013 dhe *Krstić k. Serbisë*, vendim i 10 dhjetorit 2013.

235 *Kostić k. Serbisë*, vendim i 25 nëntorit 2008.

236 *Ališić dhe Tërjet k. Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Maqedonisë*, vendim i 14 korrikut 2014.

237 Në 28 dhjetor 2016, Parlamenti Serb miratoi ligjin mbi ekzekutimin e vendimit të *Ališić*. Në rastin *Muratović*, të 21 marsit 2017, Gjykata konstatoi se ligji serb plotësonte kriteret e përcaktuara në vendimin *Ališić dhe Tërjet*.

238 *Grudić k. Serbisë*, vendim i 27 prillit 2012.

239 Tek vendimi *Skenderi dhe Tërjet* GJEDNJ shqyrtoi raste të ngjashme. Megjithatë, tek *Skenderi dhe Tërjet*, Gjykata shpalli si të papranueshme kërkesat e kërkuesit të parë pasi konstatoi se periudha e parashkrimit tre vjeçar, çështje që nuk ngrihej tek *Grudić*, ishte e ligjshme, ndiqte një qëllim legjitim dhe ishte proporcionale. Gjithashtu, Gjykata hodhi poshtë kërkesat e tjera pasi kërkuesit nuk paraqitën ankesa kushtetuese - mjet ligjor i brendshëm efektiv.

240 *Iseni k. Serbisë*, vendim i 9 tetorit 2018.

241 Asnjë shkelje e nenit 3 nuk u gjet tek *Đermanović k. Serbisë*, vendim i 23 shkurtit 2010; *Otašević k. Serbisë*, vendim i 5 shkurtit 2013 dhe *Đekić dhe Tërjet k. Serbisë*, vendim i 29 prillit 2014.

242 *Krsmanović k. Serbisë*, vendim i 19 dhjetorit 2017; *Habimi dhe Tërjet k. Serbisë*, vendim i 3 qershorit 2014; *Lakatoš dhe Tërjet k. Serbisë*, vendim i 7 janarit 2014; *Hajnal k. Serbisë*, vendim i 19 qershorit 2012; *Stanimirović k. Serbisë*, vendim i 18 tetorit 2011.

243 *Milanović k. Serbisë*, vendim i 14 dhjetorit 2010.

244 *Habimi dhe Tërjet k. Serbisë*, vendim i 3 qershorit 2014.

procedural dhe material të nenit 3.²⁴⁵ Tek rasti i *Milanović*²⁴⁶ kërkuesi ishte anëtar i lëvizjes Hare Krishna, ku Gjykata gjeti shkelje të nenit 3 dhe nenit 14 marrë së bashku me nenin 3 të Konventës, në lidhje me sulmet ndaj tij.

Lidhur me nenin 2 të Konventës, e drejta e jetës, janë dhënë 4 vendime ku në tre prej tyre është gjetur shkelje²⁴⁷. *Mučibabić* kishte të bënte me humbjen e jetës nga aktivitetet e rrezikshme nën kontrollin e autoritetit shtetëror, si dhe shkelje të aspektit procedural për të hetuar.²⁴⁸ *Mladenović*²⁴⁹ kishte të bënte me detyrimin procedural për të hetuar dhe kërkesat ndaj këtij detyrimi. *Gjithashtu, rasti Petrović*²⁵⁰ kishte të bënte me detyrat hetimore dhe faktin se autoritetet shtetërore ishin kritikuar për mungesën e tyre të pavarësisë, shpejtësisë dhe përpikmërisë së hetimit të provave në dispozicion.

Gjykata dha shtatë vendime lidhur me nenin 5, e drejta për liri dhe siguri, ku në gjashtë prej këtyre rasteve gjeti shkelje.²⁵¹ Gjykata shqyrtoi çështje të tilla si, nëse ndalimi ishte i domosdoshëm ose nëse mjetet e tjera mund të përdoren për të parandaluar arratisjen e një personi,²⁵² kërkesa për të sjellë një person të ndaluar para një gjyqtari ose zyrtari tjetër të autorizuar me ligj,²⁵³ ndalimi në bazë të një vendimi që nuk u njoh në nivel të brendshëm²⁵⁴ dhe prezumimi i pafajësisë.²⁵⁵

16 vendime u dhanë në lidhje me nenin 8, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Shkelje u gjetën në 12 prej këtyre rasteve²⁵⁶. Këto raste ngrenë çështje të detyrimeve pozitive të Shtetit për ribashkimin e prindërve me fëmijët,²⁵⁷ rëndësinë e vlerësimit të duhur të zotësisë juridike,²⁵⁸ ndërhyrjen në korrespondencën personale të burgosurve,²⁵⁹ rëndësinë e përcaktimit të atësisë,²⁶⁰ nevoja për të përdorur mjetet procedurale për t'i ardhur në ndihmë të paditurve²⁶¹, dhe rëndësinë e marrjes së miratimit të një prindi lidhur me fatin e fëmijës së tij.²⁶² Gjithashtu, subjekt shqyrtimi i një vendimi ka qenë dhe rasti i miratimit të masave në sferën e marrëdhënies midis individëve privatë, për të ruajtur

245 *Hajnal k. Serbisë*, vendim i 19 qershorit 2012.

246 *Milanović k. Serbisë*, vendim i 14 dhjetorit 2010.

247 *Mitić*, ku nuk u konstatua shkelje, rast që kishte të bënte me vetvrasjen e një të burgosuri dhe që përfshinte shqyrtimin e të dyja detyrimeve sipas nenit 2, vendim i 22 janarit 2013.

248 *Mučibabić k. Serbisë*, vendim i 12 korrikut 2016.

249 *Mladenović k. Serbisë*, vendim i 22 majit 2012.

250 *Petrović k. Serbisë*, vendim i 15 korrikut 2014.

251 Asnjë shkelje nuk u gjet në *Luković k. Serbisë*, vendim i 26 marsit 2013, rasti ka të bëjë me faktin nëse ndalimi i të burgosurit ishte tejjgatur.

252 *Lakatoš dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 7 janarit 2014 dhe *Đermanović k. Serbisë*, vendim i 23 shkurtit 2010.

253 *Milošević k. Serbisë*, vendim i 28 prillit 2009.

254 *Mitrović k. Serbisë*, vendim i 21 marsit 2017.

255 *Vrenčev k. Serbisë*, vendim i 23 shtatorit 2008.

256 Gjykata nuk gjeti shkelje tek *Damnjanovic k. Serbisë*, vendim i 18 nëntorit 2008; *Zdravković k. Serbisë*, vendim i 20 shtatorit 2016; *Cvetković k. Serbisë*, vendim i 7 shkurtit 2017 dhe *Grujić k. Serbisë*, vendim i 28 gushtit 2018.

257 *Zdravković k. Serbisë*, vendim i 20 shtatorit 2016; *Krivošej k. Serbisë*, vendim i 13 prillit 2010; *Tomić k. Serbisë*, vendim i 26 qershorit 2007 dhe *Grujić k. Serbisë*, vendim i 28 gushtit 2018.

258 *Salontaji-Drobnjak k. Serbisë*, vendim i 13 tetorit 2009.

259 *Stojanović k. Serbisë*, vendim i 19 majit 2009.

260 *Jevremović k. Serbisë*, vendim i 17 korrikut 2007.

261 *VAM k. Serbisë*, vendim i 13 marsit 2007.

262 *Zorica Jovanović k. Serbisë*, vendim i 26 marsit 2013.

integritetin fizik dhe moral.²⁶³ Tek *Zorica Jovanovic*²⁶⁴ Gjykata gjeti shkelje të nenit 8 pasi shteti nuk u kishte garantuar prindërve fatin e fëmijës së tyre, ku pas lindjes së tij ai ishte shpallur i vdekur. Gjykata e detyroi Serbinë për të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda një viti, mundësisht përmes *lex specialis*, për të siguruar krijimin e një mekanizmi që synon të garantojë dëmshpërblimin për të gjithë prindërit në një situatë të tillë ose mjaftueshmërisht të ngjashme me atë të kërkuarit. Në tetor 2016, Ministria e Drejtësisë përgatiti një projektligj. Për sa kohë që projektligji nuk është miratuar ende, në shtator 2017 dhe dhjetor 2018, Komiteti i Ministrave miratoi rezolutat e përkohshme. Në vendimin më të fundit të dhjetorit 2018, Komiteti i Ministrave i kërkoi në mënyrë urgjente autoriteteve serbe për të marrë të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar që ky proces legjislativ të trajtohej si një çështje me prioritet të lartë.

Lidhur me nenin 10, lirinë e shprehjes, Gjykata dha shtatë vendime, ku shkelje u konstatua për secilin prej tyre. Rastet kishin të bënin me të drejtën e privatësisë në sferën private dhe publike,²⁶⁵ rëndësinë e rolit mbikëqyrës së gazetarëve,²⁶⁶ fakti që neni 10 mbron informacionin dhe idetë që fyejnë, tronditin dhe shqetësojnë,²⁶⁷ se natyra dhe ashpërsia e sanksioneve të dhëna janë të përshtatshme,²⁶⁸ rëndësia e veçantë e së drejtës për t'u shprehur për partitë politike dhe anëtarët aktivë, veçanërisht gjatë fushatës elektorale,²⁶⁹ një kërkesë për informacion lidhur me operacionet e mbikëqyrjes elektronike,²⁷⁰ dhe nëse masa e sanksioneve të dhëna kundër kërkuarit që vinin si pasojë e shpifjes së avokatit të tij ishin të nevojshme dhe proporcionale.²⁷¹

Gjykata ka dhënë vendime në dy raste sipas nenit 14, ndalimin e diskriminimit. Tek *Milanović*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 marrë së bashku me nenin 3 të Konventës.²⁷² Vendimi i dytë në bazë të nenit 14 ishte për rastin *Vučković k. Serbisë*, megjithatë vendimi i ndjekur nga një vendim i Dhomës së Madhe, e cila konstatoi se kërkuari nuk i kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore.²⁷³ Tek *Paunović dhe Milivojević*,²⁷⁴ Gjykata gjeti shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1, e drejta për zgjedhje të lira, për sa kohë që përfundimi i mandatit të kërkuarit ishte jashtë kuadrit ligjor të zbatueshëm. Një shkelje e nenit 4 të Protokollit nr. 7, e drejta për të mos u gjykuar apo dënuar dy herë, u gjet në rastin *Milenković*,²⁷⁵ për sa kohë që kishte një mbivendosje procesesh.

263 *Isaković Vidović k. Serbisë*, vendim i 1 korrikut 2014.

264 *Zorica Jovanović k. Serbisë*, vendim i 26 marsit 2013.

265 *Bodrožić dhe Vujin k. Serbisë*, vendim i 20 nëntorit 2007 dhe *Milislavjević k. Serbisë*, vendim i 4 prillit 2017.

266 *Ibid.*

267 *Bodrožić k. Serbisë*, vendim i 23 qershorit 2009.

268 *Filipović k. Serbisë*, vendim i 20 nëntorit 2007.

269 *Lepojić k. Serbisë*, vendim i 6 nëntorit 2007.

270 *Youth Initiative for Human Rights k. Serbisë*, vendim i 25 janarit 2013.

271 *Tešić k. Serbisë*, vendim i 11 shkurtit 2014.

272 *Milanović k. Serbisë*, vendim i 14 dhjetorit 2010.

273 *Vučković k. Serbisë*, vendim i 28 gushtit 2012 dhe vendim i 25 marsit 2014 (DHM).

274 Vendim i 24 majit 2016.

275 Vendim i 1 marsit 2016.

Vendime 2018

Vendime themeli

Në 2018, Gjykata dha 13 vendime kundër Serbisë. GJEDNJ gjeti shkelje në 12 nga këto raste²⁷⁶. Nga 13 vendime, dhjetë u dhanë nga Komiteti lidhur me raste të ashtuquajtura të “përsëritura” ose çështje të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës dhe në tre raste vendimi u dha nga Dhoma²⁷⁷.

Gjykata shqyrtoi njëmbëdhjetë raste lidhur me nenin 6 të Konventës²⁷⁸. Gjykata shqyrtoi një rast lidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës²⁷⁹ dhe në një rast tjetër lidhur me nenin 8 të Konventës²⁸⁰.

Në një rast Gjykata gjeti shkelje të të drejtës së procesit të rregullt lidhur me afatin e arsyeshëm (neni 6 i Konventës), për shkak të mosekzekutimeve të vendimeve të brendshme kundër kompanive me pronësi kolektive²⁸¹. Ky rast u gjykua nga Komiteti si çështje që i përket jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës. Ajo është vazhdim i jurisprudencës, të iniciuar në rastin *Kačapor dhe të Tjerët k. Serbisë*²⁸² dhe ka vazhduar me një sërë vendimesh pranueshmërie dhe vendimesh të zgjidhura me marrëveshje. Në këtë rast, GJEDNJ konstatoi se shteti ka ushtruar kontroll efektiv mbi kompanitë me pronësi kolektive dhe se, në përputhje me rrethanat, ai duhej të mbante përgjegjësinë për borxhet e tyre. Në të njëjtën linjë me jurisprudencën e mëparshme të GJEDNJ-së, Serbia u urdhërua që të paguante dëmshpërblimin me asetet e veta për dëmet materiale të kërkuarit në shumën e përcaktuar nga vendimi i brendshëm i cili nuk ishte ekzekutuar dhe duke shkaktuar fillimin e procesit, por duke reduktuar shumat të cilat tashmë ishin paguar për të njëjtën arsye në nivel kombëtar. Përveç kësaj, kërkuarit ju akordua një shumë prej 2.000 euro si dëmshpërblim për dëmet jomateriale dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me procesin.

Në 2018, Gjykata dha gjashtë vendime lidhur me nenin 6 § 1 të Konventës²⁸³, duke vazhduar sipas jurisprudencës së *Savić k. Serbisë*²⁸⁴ dhe duke përcaktuar një shkelje të procesit të rregullt brenda afatit të arsyeshëm për shkak të shumave të pamjaftueshme të kompensimit të akorduara nga Gjykata Kushtetuese si një formë e shpërblimit të drejtë për shkeljen e afatit të arsyeshëm në procesin e regu-

276 Nuk u gjet asnjë shkelje në lidhje me nenin 8 të Konventës tek *Grujić k. Serbisë*, vendim i 28 gushtit 2018.

277 Rastet e dhëna nga Dhoma janë *Mirković dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 26 qershorit 2018; *Grujić k. Serbisë*, vendim i 28 gushtit 2018 dhe *Dimović dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 11 dhjetorit 2018.

278 *Hrustić dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 9 janarit 2018; *Šačirović dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 20 shkurtit 2018; *Mirković dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 26 qershorit 2018; *Čorić dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 25 shtatorit 2018; *Knežević dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 9 tetorit 2018; *Grbić k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018; *Mijatović dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018; *Ilić k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018; *Ljajić k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018; *Stanivuković dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 27 nëntorit 2018 dhe *Dimović dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 11 dhjetorit 2018.

279 *Iseni k. Serbisë*, vendim i 9 tetorit 2018.

280 *Grujić k. Serbisë*, vendim i 28 gushtit 2018.

281 *Ljajić k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018.

282 *Kačapor dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 15 janarit 2008.

283 *Hrustić dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 9 janarit 2018; *Šačirović dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 20 shkurtit 2018; *Čorić dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 25 shtatorit 2018; *Mijatović dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018; *Ilić k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018 dhe *Stanivuković dhe të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 27 nëntorit 2018.

284 *Savić k. Serbisë*, vendim i 5 prillit 2016.

llt²⁸⁵ ose dështimi i Gjykatës Kushtetuese për të dhënë një vendim që konstatonte shkeljen e së drejtës së afatit të arsyeshëm në një gjykim²⁸⁶. Të gjitha vendimet u dhanë nga Komiteti i përbërë prej tre gjyqtarësh, pasi ato konsiderohen si “çështje të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës”. Për secilin rast është konstatuar shkelje e nenit 6 dhe për këtë janë akorduar shpërblime për dëmet jomateriale. Përpara paraqitjes së kërkesave të tyre në Gjykatë, të gjithë kërkuessit paraqitën kërkesa kushtetuese dhe u ankuan lidhur me shkeljen e afatit të arsyeshëm në procesin e rregullt.

Në disa raste²⁸⁷, Gjykata Kushtetuese dha vendime duke konstatuar se kërkuessve ju ishte shkelur e drejta e tyre për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, duke iu akorduar atyre shpërblim lidhur me dëmet jo materiale. Ashtu si në rastin *Savić dhe Të Tjerët*, shteti kundërshtoi pranueshmërinë e kërkesave, duke deklaruar se kërkuessit nuk mund të ankoheshin më se ata ishin viktimat të një shkelje të së drejtës, për sa kohë që konstatimi i shkeljes nga Gjykata Kushtetuese dhe përcaktimi i dëmshpërblimit për dëmin jomaterial paraqet shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për shkeljen e së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Ashtu si në rastin *Savić*, Gjykata vlerësoi se ky kundërshtim ishte i lidhur ngushtë me thelbin e kërkesave të kërkuessve dhe për këtë duhet t’i bashkohet themelit. Duke vendosur mbi themelin e çështjes, Gjykata përsëriti parimet tek *Savić*, duke vënë në dukje se statusi i viktimës së kërkuessit varej nëse zgjidhja e dhënë nga Gjykata Kushtetuese ishte adekuate dhe e mjaftueshme, duke pasur parasysh shpërblimin e drejtë. Gjykata vlerësoi se shumica e vendosur nga Gjykata Kushtetuese për shpërblimin e dëmeve ishte haptazi më e ulët sesa shumatat e dhëna për raste të ngjashme në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Përsëri, u theksua se arsyetimi mbi akordimin e shumave të dhëna u vlerësua në kontekstin e të gjitha rrethanave që lidhen me rastin. Këto përfshinin jo vetëm kohëzgjatjen e proceseve në lidhje me këtë rast të veçantë, por edhe vlerën e akorduar në kontekstin e standardit të jetesës në Shtetin në fjalë dhe faktin se përgjithësisht shpërblimi sipas sistemeve kombëtare jepet dhe paguhet shumë më shpejt sesa në rastin e vendimeve të GJEDNJ-së. Duke pasur parasysh thelbin e çështjes dhe rrethanat e veçanta të procesit në fjalë, Gjykata vlerësoi se shumatat që iu janë akorduar kërkuessve nuk mund të konsideroheshin të mjaftueshme dhe nuk përbënin shpërblim të drejtë për shkeljet pësuar. GJEDNJ konkludoi se kërkuessit nuk e humbën statusin e viktimave, se proceset ishin tejzgjatur dhe se nuk plotësonin kërkesat e “afatit të arsyeshëm”.

Në disa raste²⁸⁸ Gjykata Kushtetuese nuk gjeti shkelje të së drejtës së kërkuessve për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm dhe hodhi poshtë kërkesat kushtetuese. Shteti kundërshtoi pranueshmërinë e kërkesave, duke prapësuar se kërkuessit nuk kishin shteruar siç duhet mjetet e brendshme ligjore për sa kohë që ata nuk kishin parashtruar siç duhet ankesat lidhur me kohëzgjatjen në kërkesat kushtetuese. Gjykata shqyrtoi me kujdes kërkesat kushtetuese të kërkuessve dhe arriti në përfundimin se kërkuessit ose kishin treguar zhvillimet kryesore dhe vendimet e marra gjatë proceseve të tyre ose kishin përdorur fraza të tilla si “siç është e qartë se i padituri e zgjat procesin përmes akteve të ndryshme”, “një mosmarrëveshje pune e cila zgjat që nga viti 2006, që përbën shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm”, “zgjatja e procesit dhe mungesa e përgjegjësisë”, “duke shkelur nenin 10 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata shkeli të drejtën e gjykimit brenda një afati

285 *Ćorić dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 25 shtatorit 2018; *Mijatović dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018 dhe *Ilić k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018.

286 *Hrustić dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 9 janarit 2018; *Šaćirović dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 20 shkurtit 2018 dhe *Stanivuković dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 27 nëntorit 2018.

287 *Ćorić dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 25 shtatorit 2018; *Mijatović dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018 dhe *Ilić k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018.

288 *Hrustić dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 9 janarit 2018; *Šaćirović dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 20 shkurtit 2018 dhe *Stanivuković dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 27 nëntorit 2018.

të arsyeshëm”, “procesi zgjati më tepër se shtatë vjet”, “kërkuesi e parashtrori kërkesën e tij thua jse njëmbëdhjetë vite më parë”, “brenda afatit të arsyeshëm”, “procesi zgjati më tepër se dhjetë vjet”, “tej zgjatja”, në lidhje me proceset në një sërë rastesh në kërkesat e tyre kushtetuese. Gjithashtu, haptazi ata ishin mbështetur në nenin 32 të Kushtetutës së Serbisë, që korrespondon me nenin 6 të Konventës. Gjykata theksoi se ankesat lidhur me zgjatjen e procesit, ndryshe nga disa ankesa të tjera sipas Konventës, nuk kërkonin shumë shtjellim. Nëse, në mënyrë përjashtimore, Gjykata Kushtetuese ka nevojë për ndonjë informacion shtesë ose dokumente, ajo mund t’i kërkojë kërkuesve që t’ia vendosin në dispozicion. GJEDNJ konkludoi se kërkuesit u ofruan autoriteteve kombëtare mundësinë për të shqyrtuar ankesat lidhur me zgjatjen e procesit dhe se kërkuesit kishin shteruar mjetet ligjore vendase. Duke vendosur mbi themelin, GJEDNJ përsëriti se kohëzgjatja e arsyeshme e procesit duhet të vlerësohej në dritën e rrethanave të rastit dhe duke iu referuar kriterëve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, sjelljen e kërkuesve dhe autoriteteve dhe se çfarë ishte në rrezik për mosmarrëveshjen e kërkuesve. Duke pasur parasysh thelbin e çështjes dhe rrethanat e veçanta të procesit në fjalë, GJEDNJ vlerësoi se në rastet urgjente kohëzgjatja e proceseve nuk arriti të përmbushë kërkesat e “afatit të arsyeshëm”.

Në një rast, *Knežević dhe Tërët k. Serbisë*²⁸⁹ Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës së procesit të rregullt brenda afatit të arsyeshëm për shkak të mosakordimit të shpërblimit të mjaftueshëm nga gjykatat e rregullta në përputhje me amendamentet e Ligjit të Organizimit të Gjykatave (Zakon o izmenamaj dopunama Zakona o uređenjusudova). Ky rast u gjykua nga një Komitet si një çështje e jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës. GJEDNJ-ja zbatoi të njëjtat parime si tek vendimi i *Savić*.

Gjithashtu, në vendimin e dhënë nga Gjykata për rastin *Grbić k. Serbisë*²⁹⁰, u konstatua shkelje lidhur me nenin 6 § 1 të Konventës e drejta për një proces të rregullt. Vendimi u dha nga një Komitet duke ju referuar çështjeve të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, e cila përfaqëson një vazhdimësi të jurisprudencës së cituar tek *Milojević dhe Tërët k. Serbisë*²⁹¹, në të cilën Gjykata shqyrtoi kualifikimin e dispozitës ligjore sipas së cilës kërkuesi u shkarkua nga detyra dhe sjellja e gjykatave vendase lidhur me aplikimin e kësaj dispozite ligjore.

Tek *Mirković dhe Tërët k. Serbisë*²⁹², GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës. Vendimi lidhur me këtë rast u dha nga Dhoma. Duke pretenduar rrëzimin e kërkesave të tyre civile nga gjykatat e brendshme dhe njëherësh pranimin e kërkesave të njëjta të parashtruara nga kërkues të tjerë, kërkuesit ankoheshin se ka pasur shkelje të së drejtës së tyre për siguri juridike. Gjykata pranoi kundërshtimet e Shtetit në lidhje me mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore dhe hodhi poshtë katër kërkesa (kërkesa e tretë, e katërt, e pestë dhe e dymbëdhjetë). Në lidhje me themelin, Gjykata ripërsëriti parimet tek *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin k. Turqisë* vendim i [DHM]²⁹³ dhe vendimin e *Stanković dhe Trajković k. Serbisë*²⁹⁴. Gjykata vuri në dukje se në rastin në fjalë, palët nuk e kishin kundërshtuar faktin se ka pasur mospërputhje në gjykimin e kërkesave civile të paraqitura nga individë të shumtë që ishin në situata të njëjta ose të ngjashme me ato të kërkuesve. Gjithashtu, Gjykata vërejti se sipas jurisprudencës përkatëse të parashikuar nga palët, këto mospërputhje vazhduan për katër vite – ndër-

289 *Knežević dhe Tërët k. Serbisë*, vendim i 9 tetorit 2018.

290 *Grbić k. Serbisë*, vendim i 23 tetorit 2018.

291 Vendim i 12 janarit 2018.

292 Vendim i 26 qershorit 2018.

293 *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 tetorit 2011.

294 *Stanković dhe Trajković k. Serbisë*, vendim i 22 dhjetorit 2015.

mjet viteve 2012 dhe 2016. Gjithashtu, GJEDNJ vuri në dukje se gjatë asaj periudhe mospërputhjet me jurisprudencën nuk kishin qenë të njëjta – ku mund të dallohen dy periudha të veçanta. Gjykata vuri në dukje se situata e kërkuësve kishte të bënte me të dyja periudhat dhe përjashtohej nga kjo kërkuesi i trembëdhjetë, ku të gjitha vendimet e tyre ishin dhënë nga Gjykata e Apelit të Beogradit. Vendimi mbi apelimin nga kërkuesi i trembëdhjetë ishte dhënë nga Gjykata e Apelit të Kragujevacit. Megjithëse ligji i brendshëm në Serbi ka ofruar një mekanizëm gjyqësor në gjendje për të zgjidhur mospërputhjet në gjykim, Gjykata vuri në dukje se praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë të Kasacionit në lidhje me këtë çështje, si dhe përpjekjet e kësaj gjykate për të harmonizuar praktikën gjyqësore nuk patën asnjë efekt deri nga fundi i vitit 2016. Përveç kësaj, edhe pse në sistemin juridik serb Gjykata Kushtetuese luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtës së individit mbi sigurinë juridike, Gjykata vuri në dukje se mospërputhjet në gjykimin në fjalë kanë ekzistuar edhe brenda kësaj gjykate. Në këto rrethana, Gjykata gjeti se në gjykimin e kërkesave civile mospërputhjet ishin të pakundërshtueshme gjatë periudhës në fjalë dhe për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si të zgjidhura institucionalisht. Këto mospërputhje krijuan një gjendje të vazhdueshme pasigurie, e cila nga ana tjetër duhet të ketë ulur besimin e publikut në gjyqësor, besim i cili përbën një nga komponentët thelbësorë të një vendi që bazohet në shtetin e së drejtës. Këto mospërputhje nuk u eliminuan deri në korrik 2016, në bazë të procedurave të parashikuara sipas Ligjit të Organizimit të Gjykatave dhe Rregulloreve të Gjykatës dhe dispozitave të tjera që parashikojnë mekanizmat e duhur për të shmangur vendimet kontradiktore brenda gjykatave në nivel vendas. Gjykata, nuk e konsideroi të përshtatshme të shprehej se cili duhej të kishte qenë vendimi konkret i padisë së kërkuësve, duke konkluduar se katër vitet lidhur me pasigurinë gjyqësore në fjalë i privuan kërkuësit ndaj procesit të rregullt gjyqësor, pasiguri kjo e ardhur si pasojë e moszgjidhjes së rastit përmes vendimeve të Gjykatës Supreme të Kasacionit ose Gjykatës Kushtetuese. Duke pasur parasysh karakterin “e thellë dhe të gjatë” të ndryshimeve në gjykim, GJEDNJ-ja deklaroi se në lidhje me kërkuësit e tjerë ka pasur shkelje të së drejtës së tyre për siguri juridike të sanksionuar në nenin 6 § 1 të Konventës.

Tek *Dimović dhe Të Tjerët k. Serbisë*²⁹⁵, pas marrjes në shqyrtim të kërkesave sipas nenit 6 § 1 të Konventës marrë së bashku me nenin 6 § 3 (d), GJEDNJ gjeti shkelje. Vendimi u dha nga një Dhomë. Kërkuësit u ankuan për shkelje të procesit të rregullt. Ata ankoheshin veçanërisht për faktin se ndalimi i tyre ishte dhënë bazuar vetëm ose kryesisht në deklaratat e R.K., të cilin nuk kishin pasur mundësi për ta pyetur. Në të njëjtën kohë, kërkuësit pretendonin se masat kundërbalancuese të marra ishin të pamjaftueshme për të vlerësuar drejt dhe në mënyrën e duhur besueshmërinë lidhur me provat e pavërtetuara. Duke vendosur mbi themelin, Gjykata ripërsëriti parimet tek *Al-Khawaja dhe Tahery k. Mbretërisë së Bashkuar*²⁹⁶ dhe *Seton k. Mbretërisë së Bashkuar*²⁹⁷. Gjykata theksoi se dëshmitari i kontestuar ishte marrë në pyetje gjatë gjykimin të parë dhe kishte vdekur shumë pak përpara rigjykimin të çështjes. Për sa i përket hapit të dytë të testit Al-Khawaja, Gjykata mori në shqyrtim edhe pjesët e tjera të provave për të cilat Gjykata e Shkallës së Parë i kishte konsideruar si të parëndësishme për ngritjen e akuzave penale kundër kërkuësve. Pas analizimit të provave mbi të cilat mbështetej Gjykata e Apelit, Gjykata konstatoi se deklarata e 4 prillit 2008 e R.K. nuk ishte “vendimtare” në lidhje me kërkuësin e tretë, por ishte “vendimtare” në lidhje me dy kërkuësit e tjerë. Për sa i përket hapit të tretë të testit Al-Khawaja, GJEDNJ-ja vërejti se R.K. u sëmur rëndë pas përfundimit të hetimit paraprak dhe lëshimit të akuzës. Për rrjedhojë autoritetet hetimore nuk mund të bënin vërejtje për moskryerjen e një ballafaqimi

295 Vendim i 11 dhjetorit 2018.

296 *Al-Khawaja dhe Tahery k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i DHM i 15 dhejtorit 2011.

297 *Seton k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 31 marsit 2016.

midis tij dhe kërkuesve gjatë fazës së hetimit. Në atë moment, thjesht nuk ishte parashikuar që R.K. nuk do të merrte pjesë në gjykimin e mëtejshëm. Për të njëjtën arsye, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit nuk mund të qortoheshin për mos kërkimin e një ballafaqimi me R.K. gjatë asaj faze, megjithëse sipas legjislacionit vendas ata kishin të drejtë ta bënin këtë gjë. Fakti që deklarata e kundërshtuar e R.K., u mor në praninë dhe nën mbikëqyrjen e gjyqtarit hetues nuk mund të konsiderohej në vetvete si zëvendësim i së drejtës së kërkuesve për ta shqyrtuar atë, por përbënte një nga garancitë procedurale të së drejtës së procesit të rregullt. Gjykata përsëriti se një mbrojtje shitesë në këtë kontekst mund të ishte shfaqja e videos së regjistruar të marrjes në pyetje të dëshmitarit i cili ishte në mungesë në fazën e hetimit, në mënyrë që gjykata, prokuroria dhe mbrojtja, të mund të vëzhgonin sjelljen e dëshmitarit në kohën e marrjes në pyetje dhe krijimin e bindjes së brendshme lidhur me besueshmërinë ose jo të tij ose saj. Megjithatë, kur R.K. bëri deklaratën kundërshtuese, ligji i brendshëm nuk parashikonte mundësinë e regjistrimit me video gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të bashkë-akuzuarve në fazën e hetimit. Në përfundim, GJEDNJ-ja theksoi se në vendimet e gjykatave të brendshme nuk kishte asnjë argumentim mbi seriozitetin dhe pasojat që kishte sjellë deklarata e R.K. bërë më 4 prill 2008. Veçanërisht, gjykatat kombëtare nuk morën parasysh faktin se deklarata në fjalë ishte tërhequr më vonë, dhe se as nuk kishte ndonjë tregues që gjykatat kombëtare ishin të vetëdijshme se deklarata e dëshmitarit në mungesë, R.K. të kishte më pak peshë. GJEDNJ konkludoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës marrë së bashku me nenin 6 § 3 (d) në lidhje me kërkuesin e tretë dhe se ka pasur shkelje të këtij neni në lidhje me kërkuesin e parë dhe kërkuesin e dytë.

Në rastin *Iseni k. Serbisë*²⁹⁸, Gjykata gjeti shkelje në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, mbrojtja e pronës. Vendimi u dha nga një Komitet. GJEDNJ-ja gjeti shkelje të së drejtës së pronës për sa kohë që vendimi i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me shpronësimin e apartamentit të kërkuesit nuk ishte ekzekutuar për më tepër se shtatë vjet.

Në lidhje me nenin 8, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare Gjykata nuk gjeti shkelje në rastin *Gruić k. Serbisë*²⁹⁹. Vendimi u dha nga një Dhomë. Kërkuesi ankohej për mosekzekutimin e dy vendimeve që i garantonin atij të drejtën për të pasur kontakt me fëmijën e tij. Pas analizimit të fakteve të rastit në fjalë dhe zbatimit të parimeve të Gjykatës, GJEDNJ-ja konkludoi se autoritetet kombëtare kishin marrë të gjitha hapat e nevojshme, të cilat mund të kërkoheshin në mënyrë të arsyeshme prej tyre me qëllim ekzekutimin e së drejtës së kërkuesit për të pasur kontakt me fëmijën e tij.

Vendime mbi pranueshmërinë

Në 2018, GJEDNJ-ja dha 38 vendime në lidhje me Republikën e Serbisë. Gjykata përjashtoi nga lista 29 kërkesa për shkak të zgjidhjes së tyre me marrëveshje. Në nëntë raste kërkesat u shpallën të papranueshme³⁰⁰. Gjashtë nga vendimet u morën nga një Komitet, ndërkohë që Dhoma dha vendime lidhur me tre raste³⁰¹.

298 Vendim i 9 tetorit 2018.

299 Vendim i 28 gushtit 2018.

300 *Eliseev dhe Ruski Elitni Klub k. Serbisë*, vendim i 10 korrikut 2018; *Bistrović-Nastić k. Serbisë*, vendim i 11 shtatorit 2018; *Nišević Tadić k. Serbisë*, vendim i 25 shtatorit 2018; *Matović k. Serbisë*, vendim i 25 shtatorit 2018; *Bogićević-Ristić k. Serbisë*, vendim i 2 tetorit 2018; *JKP Vodovod Kraljevo k. Serbisë*, vendim i 16 tetorit 2018 dhe *Bihorac Hajdragić k. Serbisë*, vendim i 6 nëntorit 2018.

301 *Eliseev dhe Ruski Elitni Klub k. Serbisë*, vendim i 10 korrikut 2018; *Bistrović-Nastić k. Serbisë*, vendim i 11 shtatorit 2018 dhe *JKP Vodovod Kraljevo k. Serbisë*, vendim i 16 tetorit 2018.

Tek vendimet *Bihorac Hajdragić*³⁰², *Bogićević-Ristić*³⁰³, *Matović*³⁰⁴ dhe *Nišević Tadić*³⁰⁵ GJEDNJ-ja i hodhi poshtë kërkesat si një abuzim me të drejtën e peticionit.

Në vendimin e *Eliseev dhe Ruski Elitniklub k. Serbisë*,³⁰⁶ Gjykata konstatoi se kërkesa në lidhje me kërkuesin e parë ishte e papranueshme pasi ai nuk gëzonte statusin e viktimës. Në lidhje me kërkuesin e dytë, GJEDNJ-ja konstatoi se kërkesa e ngritur sipas nenit 1 Protokollit nr. 1 duhej të hidhej poshtë për shkak mosshterimit të mjeteve të brendshme ligjore dhe se kërkesa në bazë të nenit 6 nuk përputhej me parimin *ratione materiae* sipas dispozitave të Konventës.

Tek vendimi i *Bistrović Nastić*³⁰⁷ kërkesa e kërkuesit lidhur me aksesin fizik në ndërtesën e gjykatës penale që kishte trajtuar rastin e saj civil u hodh poshtë për sa kohë që kërkuesja nuk kishte shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore.

Së fundmi, tek vendimi *JKP Vodovod Kraljevo*³⁰⁸, GJEDNJ-ja konstatoi se kompania e kërkuesit nuk mund të konsiderohej si “organizatë joqeveritare” brenda kuptimit të nenit 34 të Konventës, për sa kohë që ai nuk gëzoi pavarësinë e mjaftueshme nga autoritetet politike. Për rrjedhojë, kërkesat nuk ishin në përputhje me parimin *ratione personae* të dispozitave të Konventës.

302 Vendim i 6 nëntorit 2018.

303 Vendim i 2 tetorit 2018.

304 Vendim i 25 shtatorit 2018.

305 Vendim i 25 shtatorit 2018.

306 Vendim i 10 korrikut 2018.

307 Vendim i 11 shtatorit 2018.

308 Vendim i 16 tetorit 2018.

AIRE Centre

AIRE Centre është një organizatë joqeveritare që përhap njohjen e të drejtës evropiane dhe u ofron ndihmë viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut. Ekipi i juristëve ndërkombëtarë ofron informacione, përkrahje dhe këshilla për standardet juridike të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Eksperiencë të veçantë ka në çështjet gjyqësore para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe ka marrë pjesë në më shumë se 150 çështje. Gjatë 20 viteve të kaluara, AIRE Centre ka mbajtur dhe ka marrë pjesë në seminare të ndryshme në Evropën Qëndrore e Lindore, në favor të avokatëve, gjyqtarëve, zyrtarëve të qeverisë dhe organizatave joqeveritare.

AIRE Centre vëmendje të veçantë i kushton vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku është e pranishme prej mbi një dekade e gjysmë, duke realizuar një sërë programesh për sundimin e ligjit në partneritet me institucionet dhe gjykatat vendore. Synimi ynë nëpër të gjitha këto programe është të çojmë përpara zbatimin vendor të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të ndihmojmë procesin e integritimeve evropiane nëpërmjet forcimit të sundimit të ligjit dhe respektimit të plotë të të drejtave të njeriut, si dhe me nxitjen e bashkëpunimit rajonal ndërmjet gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të profesionit juridik.



Foreign &
Commonwealth
Office

Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht qendrimin zyrtar të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.